



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në

“Financë - Kontabilitet”

Kolegji Universitar “Bedër”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Dr. Valentina SINAJ

2. Prof. Asoc. Dr. Lorena BEZO

Qershor, 2025

Tabela përmbledhëse për programin e studimit Bachelor në
“Financë - Kontabilitet”

1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar "Bedër"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Financë - Kontabilitet”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MAS nr. 458, datë 27.07.2022
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Akreditim për here të parë
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike / 6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 kredite
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Anglisht
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6(gjashtë) i kornizës kombëtare
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	v.a 2022-2023- 8 PAE / 2 PAK 80%/20% v.a 2023-2024 13 PAE / 5 PAK 72%/28% v.a 2024-2025 13 PAE / 8 PAK 62%/38%
18	Numri i studentëve:	V.a. 2022-2023, 6 studentë, V.a. 2023-2024, 8 studentë V.a. 2024-2025, 10 studentë Gjithsej 24 studentë
19	Komente / të tjera:	

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Kolegji Universitar i Bedër (KU "Bedër") ushtron aktivitetin si institucion i arsimit të lartë privat prej vitit 2011 pas licensimit me Vendim të Këshillit të Ministrave nr.286, datë 06.04.2011. KU "Bedër" ka kaluar disa procese akreditimi institucional. Procesi i parë u zhvillua nga APAAL në vitin 2013, ky proces u përmbyll me Urdhërin nr.223 datë 04.06.2013 të MAS bazuar në vendimin nr. 469 datë 03.05.2013 të Këshillit të Akreditimit për akreditimin Institucional të shkollës së lartë "Hëna e plotë" (Bedër), akreditimin periodik si Kolegji Universitar "Bedër" nga Agjencia Britanike e Sigurimit të Cilësisë dhe ASCAL me vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 101, datë 10.11.2017 me kohëzgjatje 4(katër) vite akademike. Gjatë vitit akademik 2020-2021 realizoi procesin e riakreditimit duke u finalizuar me vendim nr.57 datë 16.12.2021 të Bordit të Akreditimit me kohëzgjatje 5(pesë) vite akademike,afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të institucionit është 15.12.2026.

Programi i studimit të ciklit të parë, Bachelor në "Financë-Kontabilitet", ofrohe nga Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit, Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit, në Kolegjin Universitar "Bedër". Ky program është miratuar me urdhër Nr. 458, datë 27.07.2022, nga MAS, pas kalimit të të gjitha fazave të propozimeve dhe miratimeve brenda institucionit.

Programi është hartuar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe me nevojat e tregut për specialistë në fushën e financës dhe kontabilitetit. Ai ofrohet me 180 kredite dhe ka një kohëzgjatje prej 3 vitesh akademike (6 semestra), në gjuhën angleze dhe me formë studimi me kohë të plotë.

Në përfundim të këtij programi, studentët fitojnë diplomë Bachelor në "Financë-Kontabilitet", në Fakultetin e Teknologjisë dhe Biznesit, Kolegji Universitar "Bedër", referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Veprimtaria akademike në këtë program ka filluar në vitin akademik 2022-2023. Numri i studentëve të regjistruar është si vijon:

- Në vitin akademik 2022-2023 janë regjistruar 6 studentë.
- Në vitin akademik 2023-2024 janë regjistruar 8 studentë.
- Në vitin akademik 2024-2025 janë regjistruar 10 studentë.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Për vlerësimin e programit të ciklit të parë Bachelor në "Financë - Kontabilitet" ofruar nga Kolegji Universitar Bedër, ASCAL, mbështetur në aktet ligjore, nënligjore dhe rregullat e funksionimit të institucionit, është realizuar procesi përzgjedhës i ekspertëve të jashtëm, të cilët kanë për detyrë të: (i) analizojnë dhe vlerësojnë dokumentacionin e përcjellë nga KU "BEDËR"; (ii) të zhvillojnë vizitën në institucion, të kryejnë takime me drejtues e anëtar të stafit akademik sipas agjendës së përcaktuar dhe të kontrollojnë fizikisht dokumentacionin e ambientet që përdoren për procesin mësimdhënës e atë ndihmës; si dhe (iii) të hartojë raportin e vlerësimit të jashtëm, duke përfshirë rekomandimet për përmirësimin e mëtejshëm të programit, bazuar në analizën e kryer dhe vlerësimin e faktorëve të ndryshëm që ndikojnë në cilësinë e ofrimit të tij.

Grupi i Ekspertëve të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) përbëhet nga dy anëtarë: Prof. Dr. Valentina Sinaj dhe Prof.Asoc.Dr Lorena Bezo, i cili u asistua përgjatë të gjithë procesit nga Koordinatorja Teknike e ASCAL, Msc. Anilda Beqiraj.

Procesi i vlerësimit, filloi me shqyrtimin e dokumentacionit të përgatitur nga KU "BEDËR", nëpërmjet sistemit të menaxhimit elektronik AMS të ASCAL.

Në datat 19 dhe 20 mars 2025, GVJ vizitoi institucionin në përputhje me agjendën e dërguar nga ASCAL, duke siguruar respektimin e të gjitha afateve dhe procedurave të përcaktuara, dhe realizoi një seri takimesh dhe intervistash me:

- ✓ Dekanin e Fakultetit të Teknologjisë dhe Biznesit,
- ✓ Përgjegjësin e Departamentit të Ekonomisë dhe Biznesit,
- ✓ Grupin e Vlerësimit të Brendshëm të programit,
- ✓ Stafin akademik të angazhuar në programin e studimit,
- ✓ Studentë të programit të studimit,
- ✓ Përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore,
- ✓ Përfaqësues të Sekretarisë Mësimore,
- ✓ Përfaqësues të Zyrës së Planifikimit të Karrierës,
- ✓ Përfaqësues të Zyrës së Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë,
- ✓ Përfaqësues të Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun dhe Media.

Gjithashtu, GVJ zhvilloi vizita në Sekretarinë Mësimore, Bibliotekë, Laboratorë, dhe në ambientet ku zhvillohen leksione dhe seminare.

Pas përfundimit të takimeve në KU "BEDËR", puna e GVJ vazhdoi me përgatitjen e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm (RVJ), i cili u bazua në dokumentacionin e dorëzuar, përfshirë ato shtesë që u dërguan nga KU "BEDËR" në sistemin e ASCAL, si dhe në RVB dhe informacionin e mbledhur gjatë takimeve në institucion.

Në përfundim të procesit, GVJ dorëzoi draft-raportin e vlerësimit të jashtëm për programin e ciklit të parë Bachelor në "Financë - Kontabilitet", të ofruar nga Kolegji Universitar "BEDËR".

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Financë - Kontabilitet”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	KU “BEDËR” është një institucion i arsimit të lartë që ofron programe studimi që janë në përputhje me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen, forcimin dhe zhvillimin e vlerave akademike dhe kulturore të kombit. Këto programe studimi, dhe në veçanti programi i studimit Bachelor në “Financë –Kontabilitet”, janë hartuar duke marrë parasysh traditën dhe eksperiencën e Institucionit të Arsimit të Lartë, përcaktimin e degëve prioritare për zhvillim, nevojat e vazhdueshme të tregut të punës dhe ecurinë e proceseve zhvillimit të vendit. Kjo strategji ka si qëllim jo vetëm ofrimin e një arsimi cilësor, por edhe mbështetje të qëndrueshme për integrimin e vlerave kombëtare në një kontekst global, duke përgatitur studentët për sfidat dhe mundësitë e ardhshme në tregun e punës. Sipas Planit Strategjik të KU “Bedër”, kërkimi shkencor është një nga tre elementët kyç të funksionimit dhe aktivitetit institucional, së bashku me mësimdhënien dhe kontributin në shoqëri. <i>Evidenca 1: Statuti i KU “BEDËR”, neni 4;</i> <i>Evidenca 15: Plani strategjik Institucional 2024-2028)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit “Bachelor në Financë-Kontabilitet”, i ofruar nga Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit, është në përputhje të plotë me qëllimin, misionin dhe fushën e veprimtarisë së institucionit. Ky program ka si objektiv përgatitjen e profesionistëve të kualifikuar në fushën e financës dhe kontabilitetit, të aftë për të vepruar në tregun e punës si në nivel kombëtar, ashtu edhe ndërkombëtar. Misioni i Departamentit të Ekonomisë është t’u ofrojë studentëve të këtij programi një arsimim cilësor, duke zhvilluar njohuri themelore dhe të avancuara mbi: ✓ Strukturat ekonomike dhe funksionimin e tyre; ✓ Rolin e financës në zhvillimin ekonomik; ✓ Funksionimin e institucioneve financiare; ✓ Tregjet monetare dhe ndërveprimin e tyre në ekonomi; ✓ Standardet bashkëkohore të kontabilitetit. Programi synon të ndërthurë bazën teorike me aftësitë praktike, në mënyrë që studentët të përgatiten për sfidat reale të profesionit dhe të kontribuojnë në mënyrë aktive në sektorin financiar dhe kontabël. <i>Evidenca 1: Statuti i KU “BEDËR”; Evidenca 5;</i>

	Propozim për hapjen e programit Bachelor në "Financë Kontabilitet"
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.	Programi i studimit "Bachelor në Financë-Kontabilitet" është hartuar dhe zhvilluar në përputhje me Statutin e Kolegjit Universitar "Bedër", Rregulloren Themelore, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit të Departamentit të Ekonomisë dhe Biznesit, duke respektuar gjithashtu të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që rregullojnë arsimin e lartë në Shqipëri. Hapja e këtij programi studimi është mbështetur në një analizë të detajuar statistikore, e cila ka marrë në konsideratë: ✓ Dinamikat dhe tendencat e tregut të punës në nivel kombëtar dhe rajonal; ✓ Nevojat për specialistë të kualifikuar në fushën e financës dhe kontabilitetit; ✓ Prioritetet e zhvillimit të sektorit ekonomik dhe financiar, në përputhje me politikat e arsimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Kjo analizë ka shërbyer si bazë për të justifikuar nevojën dhe rëndësinë e ofrimit të këtij programi studimi, duke garantuar që ai i përgjigjet realisht kërkesave të tregut dhe zhvillimeve bashkëkohore në fushën përkatëse. Evidenca 1: Statuti i KU "BEDËR"; Evidenca 3: Rregullorja Themelore; Evidenca 5: Propozim për hapjen e programit Bachelor në "Financë Kontabilitet"
Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Programi i studimit "Bachelor në Financë-Kontabilitet" ofrohet nga Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit (DEB), i krijuar si rezultat i riorganizimit të njësive akademike brenda Kolegjit Universitar "Bedër", dhe që funksionon në kuadër të Fakultetit të Teknologjisë dhe Biznesit. Veprimtaria akademike e këtij departamenti ka nisur në vitin akademik 2020-2021. Përveç programit Bachelor në "Financë-Kontabilitet", DEB ofron edhe një tjetër program studimi në ciklin e parë, konkretisht Bachelor në "Informatikë Ekonomike". Në përbërjen e njësive kryesore përfshihen gjithashtu edhe Departamenti i Shkencave Kompjuterike si dhe Qendra për zhvillim të Qëndrueshëm dhe Inovacion, të cilat mbështesin veprimtarinë akademike dhe shkencore të fakultetit. Stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie për programin "Financë-Kontabilitet", si me kohë të plotë, ashtu edhe me kontratë, zotëron kualifikime dhe përvojë profesionale të përshtatshme, të cilat garantojnë një cilësi të lartë në ofrimin e procesit mësimor. Nga shqyrtimi i CV-ve të stafit rezulton se ata kanë eksperiencë të konsiderueshme si në mësimdhënie, ashtu edhe në fusha të specializuara të financës dhe kontabilitetit, duke krijuar kështu një bazë të qëndrueshme për realizimin me sukses të objektivave të programit. DEB gjatë vitit akademik 2024-2025 ka në përbërjen e tij 7(shtatë) personel akademik efektiv (PAE) nga të cilët: 3 Dr. 2 Dr. në proces

	2 Msc. Dhe 7(shtatë) personel akademik me kontratë (PAK) nga të cilët: g 1 Dr. 3 Dr. në proces 3 Msc. DEB ofron për studentët e këtij programi studimi laboratorë bashkëkohorë për orët praktike, detyrat e kursit dhe elementët e tjerë mësimorë që lidhen me përdorimin e teknologjisë, në përputhje me programin e studimit, me qëllim rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe aftësimin për tregun e punës. Institucioni ofron për studentët bibliotekën, e cila është në dispozicion për përdorimin e ambienteve, literaturës fizike dhe bibliotekës virtuale. <i>Evidenca 7: Riorganizimi i njësive kryesore në Kolegjin Universitar Bedër;</i> <i>Evidenca 54: CV-të e stafit akademik;</i> <i>Evidenca 81: Infrastruktura e auditorëve, laboratorëve dhe Bibliotekës në KU Bedër;</i> <i>Evidenca 102: Udhëzues mbi mësimdhënien inovative në KU "Bedër";</i> <i>Shtojca Tabela përmbledhëse: Tabela 1</i>
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësive kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit, si pjesë e njësive kryesore Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit, në përputhje me fushën e tij të përgjithshme dhe specifike të veprimtarisë, ofron programin e studimit "Bachelor në Financë-Kontabilitet". Ky program është i harmonizuar me profilin akademik dhe kërkimor të njësive kryesore, duke u zhvilluar në përputhje me objektivat institucionale dhe nevojat e tregut të punës. Këshilli i Departamentit të Ekonomisë dhe Biznesit, bazuar në rregulloret dhe aktet normative në fuqi, ka propozuar kodifikimin e programit të studimit sipas fushës së gjerë dhe specifike të tij, në përputhje me klasifikimin e UNESCO. Ky propozim është finalizuar me miratimin e tij nga MAS në dhjetor 2024. <i>Evidenca 14: Njoftim mbi procesin e kodifikimit të programeve të studimit; Evidenca 43: Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë; Evidenca 73: Propozime për kodifikimin e programeve të studimit në Departamentin e Ekonomisë dhe Biznesit;</i> <i>Evidenca 103: Procedurat për Kodifikimin e Programeve të Studimit</i>
Konkluzione	Programi i studimit "Bachelor në Financë-Kontabilitet" ofrohet nga Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit, si pjesë e Fakultetit të Teknologjisë dhe Biznesit, në përputhje me misionin e institucionit, fushën e veprimtarisë akademike dhe profesionale, si dhe në harmoni me prioritetet dhe interesat kombëtare.



	<i>Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit angazhon në këtë program studimi personel akademik të kualifikuar dhe me përvojë në fushat përkatëse të financës, kontabilitetit dhe disiplinave të ndërlidhura, duke garantuar një proces mësimor cilësor dhe bashkëkohor.</i> <i>Institucioni u vë në dispozicion studentëve infrastrukturën e nevojshme, duke përfshirë: Ambiente mësimore moderne; Laboratorë të pajisur me programe kompjuterike dhe software profesional; Akses në bibliotekë fizike dhe online (p.sh. JSTOR); Shërbime IT dhe mbështetje teknike për mësimin dhe kërkimin shkencor.</i> <i>Këto burime krijojnë kushte optimale për realizimin me sukses të objektivave të programit të studimit dhe për përgatitjen e studentëve si profesionistë të zotë në fushën e financës dhe kontabilitetit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Njësia bazë e Departamentit të Ekonomisë dhe Biznesit, e cila ofron programin e studimit Bachelor në Financë-Kontabilitet, mbështetet në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, në statutin dhe në rregulloret e brendshme akademike dhe administrative të institucionit. Ajo bashkëpunon me njësitë e tjera brenda institucionit KU "Bedër" për të siguruar mbarëvajtjen e realizimit me sukses të programit të studimit. GVJ, duke analizuar dokumentacionin e dorëzuar por edhe nga takimet në institucion, konstaton se Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit bën ndarjen e detyrave dhe koordinimin mes personelit akademik të departamentit, duke përcaktuar qartë përgjegjësitë, si në nivel akademik ashtu edhe nga pikëpamja administrative. Disa nga detyrat e tij janë: ✓ Ndarja e detyrave për mbarëvajtjen e procesit mësimor. ✓ Mbështetja për studentët me ndihmën e këshilltarit akademik. ✓ Përfaqësimi brenda institucionit: në zyrën e planifikimit të karrierës, marrëdhënieve ndërkombëtare dhe pranë NJSBC. ✓ Mbështetje për kërkimin shkencor të stafit akademik. ✓ Hartimi i planit vjetor të aktiviteteve dhe, në fund të çdo viti, analiza e tyre dhe hartimi i raportit vjetor. Institucioni gjithashtu analizon performancën e stafit akademik, si në procesin e mësimdhënies, ashtu edhe në atë të kërkimit shkencor, duke shqyrtuar anketat e studentëve dhe pyetësorët e vetdeklarimit të stafit akademik. Evidenca 51: Vendimi i Këshillit të Departamentit për caktimin e koordinatorit të programit të studimit;

	<i>Evidenca 61: Vendimi i Këshillit të Departamentit për caktimin e përfaqësuesit pranë Zyrës së Planifikimit të Karrierës,</i> <i>Evidenca 67: Raporti Vjetor i Departamentit të Ekonomisë dhe Biznesit 2023-2024, Evidenca 70: Plani i aktiviteteve për vitin akademik 2024-2025;</i> <i>Evidenca 74: Caktimi i këshilltarëve akademikë për programet Bachelor, viti akademik 2024-2025,</i> <i>Evidenca 82: Caktimi i asistentit pranë Zyrës së Marrëdhënieve Ndërkombëtare,</i> <i>Evidenca 85: Caktimi i asistentit të departamentit pranë NJSBC-së,</i> <i>Evidenca 87: Mbledhja e Këshillit të Departamentit për ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi.</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Kolegji Universitar “Bedër” ka krijuar marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe, brenda dhe jashtë vendit, me institucione dhe biznese, të cilat ndodhen si në Shqipëri, ashtu edhe në vende të huaja. Këto marrëdhënie mbështesin përmirësimin e procesit mësimor, realizimin e aktiviteteve kërkimore, si dhe shkëmbimin e studentëve dhe stafit akademik. Kolegji Universitar “Bedër” është anëtar i Shoqatës EUMMAS dhe, në bashkëpunim me universitete të tjera ndërkombëtare, merr pjesë në konferencën “EUMMAS A2S Conference on Global Social and Technological Development and Sustainability” për vitet 2023 dhe 2024. (https://conference.eummas.net/dubai2023/; https://conference.eummas.net/bucharest2024/) Në kuadër të këtyre marrëveshjeve, Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit, si pjesë e Fakultetit të Teknologjisë dhe Biznesit, ka organizuar aktivitete shkencore, si: ✓ Konferencën ndërkombëtare ICIBT në vitin 2022, në partneritet me universitete të ndryshme vendase, rajonale dhe ndërkombëtare, si: Universiteti Epoka, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë, Universiteti Fan S. Noli, Kolegjia AAB, dhe University of Economics and Human Sciences in Warsaw (https://icibt.beder.edu.al/) ✓ Konferencën studentore “Transformimi Digjital në Kohën e Sfidave”, në bashkëpunim me Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit Fan S. Noli. ✓ Shkollën verore “Teknologjia Financiare dhe Ligji” në bashkëpunim me Universitetin Tor Vergata në Romë. Po ashtu, është krijuar një numër i konsiderueshëm marrëveshjesh me biznese dhe institucione, me afate të përcaktuara dhe mundësi ripërtëritjeje, me qëllime kryesore: organizimin e mundësive për internship për studentët, trajnime për stafin dhe studentët, zhvillimin e praktikave mësimore, si dhe realizimin e projekteve dhe aktiviteteve të përbashkëta. <i>Evidenca 25: Marrëveshje mobiliteti Erasmus+;</i> <i>Evidenca 76: Marrëveshje bashkëpunimi me biznese dhe institucione; Shtojca Tabela përmbledhëse: Tabela 5 Institucione dhe organizata bashkëpunuese</i>

Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Për realizimin e praktikave mësimore, KU“Bedër” ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe biznese që zhvillojnë aktivitete në fushën e financës, kontabilitetit dhe ekonomisë në përgjithësi. Këto institucione përfshijnë, ndër të tjera, Deloitte Albania, Eurosig, Business Technology Solutions, Union Bank, People in Focus Albania, REMAX Albania & Kosovo, INET Shpk, Protik Albania. Për koordinimin e praktikave mësimore, puna bashkërendohet nga Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit dhe Zyra e Planifikimit dhe Karrierës. Departamenti nxit studentët të kryejnë gjithashtu internship-e ose trajnime në kuadër të marrëveshjeve që janë arritur me partnerët tanë, duke u mundësuar atyre një përvojë të vlefshme praktike në fushat përkatëse. <i>Evidenca 45: Shembull aplikimi praktike;</i> <i>Evidenca 76: Marrëveshje bashkëpunimi me biznese dhe institucione;</i> <i>Shtojca Tabela përmbledhëse: Tabela 5 Institucione dhe organizata bashkëpunuese.</i>
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit ndjek dhe analizon gjithë procesin e praktikave profesionale të studentëve të programeve të studimeve që ai ofron, në përputhje me fushat përkatëse të studimit. Pedagogu përgjegjës mban kontakte të rregullta me mentorët në institucionet pritëse dhe, në fund të procesit, realizon vlerësimin e tij për sa i përket përmbushjes së objektivave të përcaktuara. Departamenti dhe Institucioni gjithashtu kryejnë analiza vjetore për arritjet e gjithë procesit, duke siguruar përmirësimin e vazhdueshëm të programit dhe ndihmën që ofrohet studentëve. <i>GVJ ka konstatuar se, në lidhje me këtë, studentët e programit të studimeve Bachelor në Financë dhe Kontabilitet nuk kanë kryer ende praktikat profesionale deri në kohën e dorëzimit të këtij dokumentacioni.</i> <i>Në dokumentacion, raporti vjetor i institucionit është për vitin akademik 2022-2023. Do të ishte më e saktë dhe e përshtatshme nëse ky raport do të ishte për vitin akademik të fundit, 2023-2024.</i> <i>Evidenca 45: Shembull aplikimi praktike;</i> <i>Evidenca 13: Raporti vjetor institucional, për vitin akademik 2022-2023;</i> <i>Evidenca 67: Raporti Vjetor i Departamentit të Ekonomisë dhe Biznesit 2023-2024; Evidenca 111: Mbledhje e Këshillit të Departamentit për diskutim dhe analize mbi pjesëmarrjen e studentëve në internship</i>
Konkluzione	KU “Bedër” ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione arsimore, si kombëtare ashtu edhe ndërkombëtare, si dhe me biznese dhe institucione, me qëllim realizimin e praktikave mësimore, internship-eve, trajnimeve profesionale, shkëmbimeve të studentëve, si




	<i>dhe aktiviteteteve të tjera shkencore dhe profesionale. Ky bashkëpunim ka për qëllim rritjen e eksperiencave profesionale dhe akademike të studentëve, si dhe promovimin e mundësive për mobilitet ndërkombëtar.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1 Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Plani mësimor i Programit të Studimit Bachelor në "Financë-Kontabilitet" organizohet në lëndë ose module të vlerësuara me kredite, në përputhje me udhëzimet e MAS, legjislacionin vendas në fuqi dhe Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Plani mësimor i këtij programi është i strukturuar në 3 (tre) vite akademike dhe 6 (gjashtë) semestra, ku pasqyrohen lëndët e vlerësuara me kredite sipas sistemit ECTS me ngarkesë totale 180 ECTS ose 4500 në orë ku përfshihen si orët në auditor ashtu edhe orët për studim individual. <i>Evidenca 3: Rregullorja Themelore;</i> <i>Evidenca 29: Kurrikula – Bachelor në Financë-Kontabilitet;</i> <i>Evidenca 35: Rregullorja e Studimit Bachelor në "Financë-Kontabilitet", neni 16; VKM nr.185, datë 25.3.2021</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve	Programi i Studimit Bachelor në "Financë-Kontabilitet" ka për qëllim t'u ofrojë studentëve njohuritë e nevojshme themelore në fushën e financës, kontabilitetit, menaxhimit dhe ekonomisë, me qëllim formimin e specialistëve të aftë për të punuar në këto fusha. Ata do të jenë të përgatitur për t'u angazhuar si specialistë në financë dhe kontabilitet në njësitë e vogla dhe të mesme të sektorit privat dhe publik, si dhe në nivele ndërkombëtare. Në dokumentin e propozimit për hapjen e programit të studimit janë përshkruar objektivat që duhet të realizohen gjatë periudhës së studimeve, të cilat synojnë aftësimin e studentëve për ushtrimin e profesionit në të ardhmen. Kurrikula e programit të studimit u ofron studentëve jo vetëm njohuritë e nevojshme për ushtrimin e profesionit në fushën përkatëse, por edhe për vazhdimin e mëtejshëm të studimeve.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Evidenca 5: Propozim për hapjen e programit Bachelor në "Financë-Kontabilitet"; Evidenca 29: Kurrikula –Bachelor në Financë-Kontabilitet
Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Lëndët/modulet në përmbajtje të kurrikulës të programit të studimit janë të organizuara sipas kategorive (A-E) në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Ngarkesa normale është 60 kredite në vit, e ndarë në mënyrë të barabartë me nga 30 ECTS për çdo semestër përgjatë tre viteve të studimit. Studenti në përfundim të studimeve merr njohuri të: Kategoria A (lëndëve bazë) 30 ECTS ose 16.67% Kategoria B (lëndë karakterizuese) 95 ECTS ose 52.78% Kategoria C (lëndë ndërdisiplonore/integruese) 25 ECTS ose 13.89% Kategoria D (lëndëve plotësuese) 24 ECTS ose 13.33% Kategoria E (detyrime përmbyllëse) 6 ECTS ose 3.33% Një kredit është 25 orë mësimore punë e studentit ku përfshihen orët në auditor (leksion/seminar/laborator) dhe orë pune të pavarur në funksion të përthithjes së njohurive përkatëse. Evidenca 29:Kurrikula –Bachelor në Financë-Kontabilitet; Evidenca 35: Rregullorja e Studimit Bachelor në "Financë-Kontabilitet", neni 11,13,14,16; RVB Bsc në Financë-Kontabilitet
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	GVJ, mbështetur në dokumentacion e dorëzuar (DVV) dhe takimet e zhvilluara në institucion, konstaton se në Rregulloren dhe në planin mësimor të Programit të Studimit Bachelor në "Financë-Kontabilitet" janë të përcaktuara: a) Realizimi i praktikës profesionale me 4 ECTS si lëndë e detyrueshme në semestrin e gjashtë. b) Detyrimet përmbyllëse: b1) Provimi përfundimtar si lëndë e detyrueshme me 6 ECTS. b2) Mikroteza (jo e detyrueshme) për studentët me mesatare më të lartë se 8. <i>Duhet të theksojmë se për këtë program studimi ende nuk kemi të diplomuar, dhe studentët më të hershëm janë aktualisht në semestrin e gjashtë, në të cilin realizohen si praktika profesionale ashtu dhe detyrimet përmbyllëse.</i> Evidenca 29: Kurrikula –Bachelor në Financë-Kontabilitet; Evidenca 35: Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në "Financë-Kontabilitet", neni 16,19; Evidenca 6: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe	Forma e organizimit të programit të studimit Bachelor në "Financë-Kontabilitet" është me kohë të plotë, realizohet në gjuhën angleze dhe është në përputhje me ligjin për arsimin e lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim nga ministria përgjegjëse për arsimin.

financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Procedurat për pranimin dhe përzgjedhjen e studentëve të rinj, vendas dhe të huaj, janë të qarta dhe të mirëpërcaktuara në rregulloret e brendshme të institucionit, në përputhje me aktet ligjore përkatëse si për kriteret dhe afatet ligjore. Për këtë program studimi, kriteret e pranimit janë: ✓ Mesatarja aritmetike e shkollës së mesme, duke përfshirë edhe provimet e maturës, në masën 70%. ✓ Intervista nga komisioni i vlerësimit, në masën 30%. ✓ Plotësimi i kushtit të mjaftueshmërisë së gjuhës së studimit, për programet në gjuhë të huaj. Këshilli i DEB ngre komisionin për kryerjen e intervistave dhe përzgjedhjen e studentëve fitues për çdo vit akademik. Në dokumentin e propozimit për hapjen e programit të studimit janë parashikuar kuota për kandidatët nga trojet, si dhe për ata me status jetimi, romë dhe egjiptian. Për personat me aftësi të kufizuara, në nenin 38 të Rregullores së Programit të Studimit theksohet se institucioni siguron të gjitha lehtësitat infrastrukturore dhe mbështetëse për këtë kategori. Në vitin akademik 2023–2024, janë përfshirë edhe kuota specifike për këtë kategori. Financimi i studimeve për programet që aplikon KU “Bedër” realizohet në bazë të tarifës së studimit të deklaruar. Tarifa e studimit propozohet nga Senati Akademik dhe miratohet në fillim të vitit akademik nga Bordi i Administrimit. Studentëve u ofrohet mundësia e likuidimit të tarifës me katër këste. Gjithashtu, institucioni ofron forma të ndryshme për zbritje të tarifës së studimit dhe bursa studimi, të parashikuara në rregulloret e institucionit. <i>GVJ, gjatë vizitës në institucion, konstatoi se një pjesë e mirë e studentëve të këtij programi studimi janë me bursa studimi me qëllim rritjen e numrit të studentëve, por që nuk ka dhënë rezultat në këtë program studimi.</i> Stafi akademik i përfshirë në këtë program studimi është i angazhuar në mësimdhënie edhe në programe të tjera, pasi ky department ofron dy programe studimi të nivelit bachelor. <i>Evidenca 1: Statuti i Kolegjit Universitar Bedër;</i> <i>Evidenca 3: Rregullorja Themelore;</i> <i>Evidenca 5: Propozim për hapjen e programit Bachelor në "Financë Kontabilitet", Evidenca 35: Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në "Financë-Kontabilitet", neni 5;</i> <i>Evidenca 58: Vendim për ngritjen e komisionit për përzgjedhjen e studentëve fitues për programin Bachelor, Udhëzimi nr.12 datë 30.06.2023" Procedurat e Aplikimit dhe të Regjistrimit në IAL";</i> <i>Evidenca 59: Miratimi i llojeve të zbritjeve të tarifave të studimit;</i> <i>Evidenca 66: Propozim për rishpërndarjen e kuotave për pranimin e studentëve në Departamentin e Ekonomisë dhe Biznesit;</i> <i>Evidenca 72: Kontrate Studimi Bachelor</i>
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi,	Programi i studimit Bachelor në “Financë-Kontabilitet” është hartuar duke u mbështetur në eksperiencat e suksesshme të programeve të ngjashme që ofrohen në universitete brenda vendit, dhe kurrikula e tij




cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	ka përmbajtje të ngjashme me to. Për shkak se programi i studimit ofrohet në gjuhën angleze, hartimi i kurikulës është mbështetur gjithashtu në eksperiencën ndërkombëtare, veçanërisht në programin Bachelor in Business Finance and Accounting të Universitetit të Varshavës. Në RVB shpjegohet se me Universitetin e Varshavës ekziston një marrëveshje për "Double Degree". Kjo marrëveshje nuk mund të zbatohet pa u akredituar programi i studimit. Evidenca 5: Propozim për hapjen e programit Bachelor në "Financë-Kontabilitet; Evidenca 29: Kurrikula -Bachelor në "Financë-Kontabilitet"; Evidenca 75: Marrëveshje për "Double Degree".			
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Në respektim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi për kodifikimin e programeve dhe më pas për kodifikimin e lëndëve përkatëse, KU Bedër ka propozuar kodifikimin e programit të studimit Bachelor në Financë-Kontabilitet, sipas fushës së gjerë dhe specifike të mbështetur në VKM Nr.310, datë 11.05.2022 si dhe klasifikimit të UNESCO-s. Ky propozim është finalizuar me miratimin e tij nga MAS në dhjetor 2024. Evidenca 14: Njoftim mbi procesin e kodifikimit të programeve të studimit; Evidenca 43: Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë; Evidenca 73: Propozime për kodifikimin e programeve të studimit në Departamentin e Ekonomisë dhe Biznesit; Evidenca 103: Procedurat për Kodifikimin e Programeve të Studimit			
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Programi i studimit Bachelor në "Financë-Kontabilitet" nuk ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë. GJV konstaton se ekziston një marrëveshje me Universitetin e Varshavës për "Double Degree", e cila nuk mund të zbatohet në rastin e këtij programi, pasi ai nuk ka kaluar ende asnjë proces akreditimi. Evidenca 75: Marrëveshje për "Double Degree".			
Konkluzione	Kolegji Universitar "Bedër" ka të përcaktuara qartë në rregulloret e brendshme kriteret dhe procedurat për pranimin e studentëve të rinj, vendas dhe të huaj, bazuar në kriteret dhe afatet ligjore, në përputhje me kapacitetet e tij dhe kërkesat e tregut. Programi i studimit Bachelor në "Financë-Kontabilitet" është i organizuar në lëndë dhe module të vlerësuara me kredite sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Në përfundim të studimeve, studentët përfitojnë njohuritë e nevojshme për t'u punësuar si specialistë në fushën e financës dhe kontabilitetit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht




				X
--	--	--	--	---

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																																					
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në Financë-Kontabilitet ofrohet nga njësia kryesore Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit i cili është i organizuar në: a) në 2 (dy) departamente: 1. Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit (DEB), që edhe ofron programin e studimit; 2. Departamenti i Shkencave Kompjuterike (DSHK); b) Qendra për Zhvillimin e Qëndrueshëm dhe Inovacion Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit për vitin akademik 2024-2025 është i përbërë nga 26 pedagogë si Personel Akademik Efektiv(PAE)dhe 22 pedagogë si Personel Akademik me Kontratë (PAK) si dhe 1 Personel Ndihmës Akademik, të cilët kanë kualifikimin e mëposhtëm: <table><tr><th>Kualifikimi i stafit</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof. Dr</td><td>0</td><td>1</td></tr><tr><td>Prof.Asoc.Dr.</td><td>3</td><td>0</td></tr><tr><td>Dr</td><td>8</td><td>3</td></tr><tr><td>Dr. ne proces</td><td>4</td><td>3</td></tr><tr><td>Msc</td><td>11</td><td>15</td></tr><tr><td>Gjithsej</td><td>26</td><td>22</td></tr></table> Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit është DEB dhe ka lidhje të ndërsjellë me Qendrën për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Inovacion. DEB përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, ndër vite akademike paraqiten mëposhtë: <table><tr><th rowspan="2">Tituj/Grada</th><th colspan="2">2022-2023</th><th colspan="2">2023-2024</th><th colspan="2">2024-2025</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof. Dr</td><td>0</td><td>0</td><td>0</td><td>0</td><td>0</td><td>0</td></tr><tr><td>Prof.Asoc.Dr.</td><td>1</td><td>0</td><td>1</td><td>0</td><td>0</td><td>0</td></tr><tr><td>Dr</td><td>2</td><td>1</td><td>2</td><td>1</td><td>5</td><td>2</td></tr><tr><td>Msc</td><td>5</td><td>1</td><td>4</td><td>6</td><td>4</td><td>6</td></tr><tr><td>Gjithsej</td><td>8</td><td>2</td><td>7</td><td>7</td><td>9</td><td>8</td></tr></table> Sipas nevojave që ka, për çdo vit akademik angazhon edhe pedagogë me kontratë. Angazhimi i stafit akademik me kontratë miratohet nga Rektori. Angazhimi i pedagogëve efektiv/me kontratë ndërvite në programin Bachelor në “Financë-Kontabilitet” ka qenë: • Viti akademik 2022-2023, 8 PAE / 2 PAK ose në raportin 80%/20% • Viti akademik 2023-2024, 13 PAE / 5 PAK ose në raportin 72%/ 28% • Viti akademik 2024-2025, 13 PAE / 8 PAK ose në raporin 62%/ 38%	Kualifikimi i stafit	PAE	PAK	Prof. Dr	0	1	Prof.Asoc.Dr.	3	0	Dr	8	3	Dr. ne proces	4	3	Msc	11	15	Gjithsej	26	22	Tituj/Grada	2022-2023		2023-2024		2024-2025		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof. Dr	0	0	0	0	0	0	Prof.Asoc.Dr.	1	0	1	0	0	0	Dr	2	1	2	1	5	2	Msc	5	1	4	6	4	6	Gjithsej	8	2	7	7	9	8
Kualifikimi i stafit	PAE	PAK																																																																				
Prof. Dr	0	1																																																																				
Prof.Asoc.Dr.	3	0																																																																				
Dr	8	3																																																																				
Dr. ne proces	4	3																																																																				
Msc	11	15																																																																				
Gjithsej	26	22																																																																				
Tituj/Grada	2022-2023		2023-2024		2024-2025																																																																	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																																																
Prof. Dr	0	0	0	0	0	0																																																																
Prof.Asoc.Dr.	1	0	1	0	0	0																																																																
Dr	2	1	2	1	5	2																																																																
Msc	5	1	4	6	4	6																																																																
Gjithsej	8	2	7	7	9	8																																																																

	DEB për programin e studimit angazhon staf efektiv dhe me kontratë sipas raportit (PAE/PAK) për ngarkesën mësimore (orë në auditor): • Viti akademik 2022-2023, 90%, PAE dhe 10%PAK; • Viti akademik 2023-2024, 70%, PAE dhe 30%PAK; • Viti akademik 2024-2025, 85%, PAE dhe 15%.PAK; DEB, që ofron programin e studimit Bachelor në "Financë-Kontabilitet" me kohëzgjatje tre vite akademike e me 180 kredite, për vitin akademik 2024-2025 ka në përbërjen e tij shtatë pedagogë PAE, prej të cilëve tre janë me tituj/grada shkencore, duke përmbushur në këtë mënyrë detyrimin ligjor për numrin shtatë të pedagogëve në departament dhe me të paktën tre pedagogë me tituj/gradë shkencore. <i>Nga takimet e zhvilluara në institucion me stafin akademik, u konstatua se pedagogët me gradën "Doktor" po mbështeten nga institucioni për të vijuar kualifikimin e tyre të mëtejshëm. Ndërkohë, dy prej pedagogëve janë aktualisht në proces ndjekjeje të studimeve të doktoraturës. Kjo pritet të ndikojë pozitivisht në rritjen e numrit të stafit akademik me tituj dhe grada shkencore në Departamentin e Ekonomisë dhe Biznesit. Për vlerësimin dhe akreditimin e programit të studimit, me Urdhër të Rektorit u ngrit GVB, me përbërje anëtarë të departamentit dhe një student, duke respektuar kriteret ligjore.</i> <i>GVJ në dokumentacionin e dorëzuar për ngarkesën mësimore PAE/PAK nuk e ka të qartë se si ndahen orët mësimore kur lëndën e zhvillojnë dy pedagogë, megjithëse gjatë takimit në institucion u kërkuar plotësimi i tabelën së ngarkesës së plotë për të dy kategoritë. Tabelat në shtojcë 6.1-6.3 dhe tabela 7 nuk kanë të pasqyruar të njëjtën shpërndarje të stafit, ndaj kërkohet një verifikim i saktë i tyre.</i> <i>Evidenca 7: Riorganizimi i njësive kryesore në Kolegjin Univerisitar "Bedër";</i> <i>Evidenca 8: Organigrama e Kolegjit Universitar "Bedër";</i> <i>Evidenca 107: Vendim për ngritjen e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm;</i> <i>Shtojca Tabela Përmbledhëse: Tabela 1, Tabela 2, Tabela 12.1, Tabela 12.2, Tabela 12.3;</i> <i>Neni 23,25 i Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkim Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë".</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke	Departamentin e Ekonomisë dhe Biznesit si njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon një personel ndihmës akademik për realizimin praktikave mësimore dhe orëve të laboratorit me kualifikim përkatës dhe duke respektuar rregullat dhe ligjet në fuqi. <i>Evidenca 45: Shembull aplikimi praktike; Vetdeklarimi Financë-Kontabilitet</i>

angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.				
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit, si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit, cakton çdo vit akademik koordinatorin e programit. Ky i fundit, bazuar në rregulloren përkatëse, është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit të studimit, si dhe të praktikave profesionale, në përputhje me objektivat e programit dhe të praktikës. Për zhvillimin e praktikave profesionale, DEB mbështetet gjithashtu nga Zyra e Planifikimit të Karrierës. <i>Evidenca 35: Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në "Financë-Kontabilitet";</i> <i>Evidenca 51: Vendimi i Këshillit të Departamentit për caktimin e koordinatorit të programit të studimit</i>			
Konkluzione	<i>GVJ, bazuar në dokumentacionin e dorëzuar si dhe nga takimet e zhvilluara në institucion, konstaton se Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit, si njësi përgjegjëse për programin e studimit, plotëson kushtet ligjore lidhur me përbërjen e stafit akademik dhe shpërndarjen e ngarkesës mësimore. Institucioni po mbështet gjithashtu stafin aktual në procesin e kualifikimit të mëtijshëm, duke kontribuar në rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe përmbushjen e standardeve të arsimit të lartë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve		
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit pranë Fakultetit të Teknologjisë dhe Biznesit ka propozuar programin e studimit në "Financë-Kontabilitet" dhe ofron informacion të detajuar lidhur me këtë program, mbështetur në statutin dhe rregulloret e brendshme të institucionit, si dhe në rregulloren e programit të studimit Bachelor në "Financë-Kontabilitet", miratuar nga Senati Akademik. Informacioni i nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e këtij programi studimi gjendet në: ✓ faqen zyrtare të KU "Bedër" (https://www.beder.edu.al/programet/bachelor-ne-finance-kontabilitet). ✓ për studentët dhe stafin akademik/administrativ këto informacione janë të aksesueshme gjithashtu në sistemin BIS. ✓ kopje fizike të dokumenteve depozitohen tek koordinatori i departamentit dhe administratori i fakultetit nga njësia kryesore dhe njësia bazë. (Evidenca 1: Statuti i Kolegjit Universitar "Bedër"; Evidenca 3: Rregullorja Themelore, 11: Rregullorja mbi organizimin Administrativ, Evidenca 35: Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në "Financë-Kontabilitet")		
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Programi i studimit Bachelor në "Financë Kontabilitet", është hapur me Urdhër Nr. 458, datë 27.07.2022 të MAS dhe ka regjistruar studentët e parë në vitin akademik 2022-2023. Ky program është organizuar në sistemin me kohë të plotë, me 3(tri) vite akademike, 6(gjashtë) semestra dhe me 180 kredite. Në planin e tij mësimor ka të përfshirë informacionin e nevojshëm për kategoritë sipas tipologjive dhe për ndarjen e lëndëve sipas semestrave. Çdo lëndë ka të përcaktuar numrin e krediteve, orët në auditor sipas llojit të aktivitetit dhe orët e studimit individual. Programi përmban 36 lëndë gjithsej ku 34 janë me 5(pesë)ECTS secila, ndërsa në semetrin e gjashtë përfshihet praktika profesionale me 4 ECTS dhe Provimi Përfundimtar/Mikroteza me 6 ETCS si detyrime pëmbjllëse. Si në programin e studimit dhe në syllabuset e lëndëve jepet informacion i plotë në lidhje me frekuntimin, detyrimet dhe mënyrën e vlerësimit të studentëve. Syllabuset përmbajnë të gjithë elementët e nevojshëm dhe janë të hartur në përputhje me rregullat në fuqi. Studenti duhet të frekuentoj lëndën në të paktën 75% të saj, për të pasur të drejta të hyrjes në provimin final. Kontrolli i njohurive në programin e studimit bazohet në ndarjet e mëposhtme: <table border="1" data-bbox="624 1877 1461 1915"> <tr> <td>Forma e kontrollit të njohurive</td> <td>Pjesa në % ndaj totalit</td> </tr> </table>	Forma e kontrollit të njohurive	Pjesa në % ndaj totalit
Forma e kontrollit të njohurive	Pjesa në % ndaj totalit		

	Ndjekja e lëndës dhe pjesmarrje aktive	0-10%																																																			
	Plotësimi i detyrave	10-30%																																																			
	Testimet gjatë vitit	30-40%																																																			
	Provimi përfundimtar	40-60%																																																			
	Vlerësimi përfundimtar bëhet në varësi të pikëve të grumbulluara sipas tabelës së mëposhtme:																																																				
	<table><tr><th>Pikët</th><th>Nota shkronjë(Vl. Brendshëm)</th><th>GPA (Vl. brendshëm)</th><th>Nota (sistemi shqiptar)</th></tr><tr><td>90-100</td><td>A</td><td>4.00</td><td>10</td></tr><tr><td>85-89</td><td>A-</td><td>3.66</td><td>9</td></tr><tr><td>80-84</td><td>B+</td><td>3.33</td><td>9</td></tr><tr><td>75-79</td><td>B</td><td>3.00</td><td>8</td></tr><tr><td>70-74</td><td>B-</td><td>2.66</td><td>8</td></tr><tr><td>65-69</td><td>C+</td><td>2.33</td><td>7</td></tr><tr><td>60-64</td><td>C</td><td>2.00</td><td>7</td></tr><tr><td>55-59</td><td>C-</td><td>1.66</td><td>6</td></tr><tr><td>50-54</td><td>D+</td><td>1.33</td><td>6</td></tr><tr><td>45-49</td><td>D</td><td>1.00</td><td>5</td></tr><tr><td>40-44</td><td>D-</td><td>0.66</td><td>4</td></tr><tr><td>0-39</td><td>F</td><td>0</td><td>3</td></tr></table>	Pikët	Nota shkronjë(Vl. Brendshëm)	GPA (Vl. brendshëm)	Nota (sistemi shqiptar)	90-100	A	4.00	10	85-89	A-	3.66	9	80-84	B+	3.33	9	75-79	B	3.00	8	70-74	B-	2.66	8	65-69	C+	2.33	7	60-64	C	2.00	7	55-59	C-	1.66	6	50-54	D+	1.33	6	45-49	D	1.00	5	40-44	D-	0.66	4	0-39	F	0	3
Pikët	Nota shkronjë(Vl. Brendshëm)	GPA (Vl. brendshëm)	Nota (sistemi shqiptar)																																																		
90-100	A	4.00	10																																																		
85-89	A-	3.66	9																																																		
80-84	B+	3.33	9																																																		
75-79	B	3.00	8																																																		
70-74	B-	2.66	8																																																		
65-69	C+	2.33	7																																																		
60-64	C	2.00	7																																																		
55-59	C-	1.66	6																																																		
50-54	D+	1.33	6																																																		
45-49	D	1.00	5																																																		
40-44	D-	0.66	4																																																		
0-39	F	0	3																																																		
	GVJ konstaton se programin e studimit Bachelor në “Financë-Kontabilitet”, llojet e lëndëve dhe peshat e tyre janë në përputhje me VKM Nr.41 datë 24.01.2018 e ndryshuar.																																																				
	<i>Evidenca 29: Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në "Financë-Kontabilitet";</i>																																																				
	<i>Evidenca 35: Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në "Financë-Kontabilitet".</i>																																																				
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Në KU “Bedër”, studentët mund të gjejnë gjithë informacionin e nevojshëm për kriteret e pranimit, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve në: ✓ Rregulloren e Programit të Studimit, ✓ Rregulloren e Transferimit të Studimeve, dhe ✓ Guidën e Studentit. Për programin e studimit Bachelor në Financë-Kontabilitet, kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit propozohen nga DEB dhe miratohen çdo vit nga Senati Akademik, duke respektuar afatet ligjore dhe duke përmbushur kërkesat e VKM-së në lidhje me notën mesatare. Këto kritere dërgohen në MAS, QSHA dhe RASH. Kriteret e pranimit publikohen në portalin U-Albania dhe rregullisht në faqen e internetit të institucionit (https://www.beder.edu.al/pranimet/kriteret-e-pranimit)																																																				

	<i>Evidenca 10: Rregullorja mbi Organizimin Akademik;</i> <i>Evidenca 22: Vendim Senati mbi kriteret e pranimit të studentëve;</i> <i>Evidenca 28: Guida e Studentit;</i> <i>Evidenca 41: Rregullorja për transferimin e studimeve.</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programet lëndore (syllabuset) e këtij programi përmbajnë në mënyrë të detajuar të gjithë elementët dhe janë hartuar sipas rregullave në fuqi (VKM nr. 41, datë 24.01.2018). Syllabuset e lëndëve të programit të studimit përmbajnë informacion të detajuar në lidhje me tipologjinë e lëndës, organizimin e leksioneve/seminareve/laboratoreve, temat kryesore, ngarkesën mësimore brenda dhe jashtë auditorit, frekuentimin, kontrollin e dijeve dhe mënyrën e vlerësimit. Informacioni mbi lëndët e këtij programi studimi gjendet gjithashtu në faqen zyrtare të institucionit dhe është i aksesueshëm lehtësisht nga çdo i interesuar(https://www.beder.edu.al/programet/bachelor-ne-finance-kontabilitet/kurrikula). <i>Evidenca 30: Syllabusi i lëndë Hyrje në Financë;</i> <i>Evidenca 40 Syllabuset e Lëndëve</i>
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	DEB, si përgjegjës për programin e studimit Bachelor në “Financë-Kontabilitet”, duke u bazuar në rregulloret e brendshme të institucionit dhe politikën e përmirësimit të vazhdueshëm dhe sigurimit të cilësisë, realizon rishikimin dhe përditësimin e syllabuseve. Ky proces realizohet në fillim të çdo viti akademik. Sipas RVB, syllabuset e përditësuara ngarkohen në sistemin BIS dhe ruhen të firmosura nga koordinatori i Departamentit. <i>GVJ konstaton se në programin e studimit Bachelor në “Financë-Kontabilitet” nuk ka pasur ndryshime, pasi ky program studimi duhet të kalojë procesin e akreditimit të parë, i cili është një hap i domosdoshëm për të vazhduar me ndryshimet dhe përmirësimet e mëtejshme.</i> <i>Evidenca 40: Syllabuset e Lëndëve;</i> <i>Evidenca 46: Politika për Përmirësimin e programeve të studimit;</i> <i>Evidenca 52: Politika e cilësisë;</i> <i>Evidenca 112: Mbledhje e Këshillit të Departamentit për diskutimin e syllabuseve.</i>
Konkluzione	Programi i studimit Bachelor në “Financë-Kontabilitet” paraqet informacion të detajuar, informues dhe të strukturuar në lidhje me ndarjen e lëndëve sipas semestrave, tipologjinë e tyre, orët mësimore në auditor dhe punën e pavarur, dhe të shprehura në kredite. Kolegji Universitar “Bedër” ka si politikë institucionale rishikimin periodik të syllabus-eve dhe kurrikulës, me qëllim përafrimin me zhvillimet dinamike të tregut dhe teknologjisë.

	<i>Aktualisht, kurrikula e programit Bachelor në Financë-Kontabilitet nuk ka pësuar ndryshime, pasi këto mund të realizohen pas përfundimit të procesit të parë të akreditimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin e studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Programi i studimit Bachelor në “Financë-Kontabilitet” është ndërtuar dhe mbështetur mbi aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, me synimin për të siguruar aftësimin teorik dhe praktik të studentëve, për t’u bërë pjesë e tregut kombëtar të punës dhe më gjerë. Programi përfshin lëndë të nevojshme për formimin e bazës teorike, lëndë që janë të nevojshme për vazhdimin e studimeve, si dhe lëndë që përgatisin studentët për tregun e punës. Përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe gërshetimi i mësimdhënies teorike me përgatitjen praktike përmes projekteve, detyrave të kursit dhe rasteve studimore, janë një ndihmesë për studentët në zhvillimin e aftësive të tyre profesionale dhe përgatitjen e tyre për punësim. Në planin mësimor përfshihen lëndë me njohuri bazë si: Financa, Kontabiliteti, Mikroekonomia, Makroekonomia, etj; lëndë për aftësim në kërkim si: Shkrimi Akademik dhe Metodatat e Kërkimit; si dhe lëndë për njohuri të thelluara si: Menaxhimi Strategjik, Financa Ndërkombëtare, Paraja dhe Banka, etj. <i>Evidenca 29: Kurrikula –Bachelor në Financë-Kontabilitet;</i> <i>Evidenca 35: Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në "Financë-Kontabilitet";</i> <i>Evidenca 40: Syllabuset e Lëndëve.</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	Programi i studimit Bachelor në “Financë-Kontabilitet” është i organizuar me lëndë të shpërndara në vite dhe semestra, me qëllim rritjen graduale të njohurive, aftësive dhe kompetencave të arritjeve akademike të studentëve. Një grup lëndësh të organizuara në module janë të shtrira në më shumë se një semestër, me qëllim që të sigurohet një kalim nga njohuritë bazë në ato më të avancuara. Të gjitha lëndët janë të vlerësuara me kredite dhe orë mësimore, të ndara në leksione, seminare/laboratorë dhe punë individuale. <i>GVJ konstaton se në disa lëndë, si p.sh. "Hyrje në Kontabilitet", ka një përparësi në zhvillimin e njohurive, duke u zhvilluar përpara se të merren njohuritë bazë, pasi kjo lëndë zhvillohet në semestrin e parë të vitit të parë. Në disa lëndë të tjera, programi është pak më i ngarkuar</i>

	se niveli në të cilin ofrohet, si: "Hyrje në Algoritme dhe Programim", e cila zhvillohet në semestrin e parë të vitit të parë, dhe "Ekonometri", e cila zhvillohet në semestrin e 6-të të vitit të tretë. Në syllabuset e disa lëndëve të programit të studimit, vërehet një mospërputhje në kodin dhe tipin e lëndës me rregulloren e programit të studimit (si për shembull në lëndët "Hyrje në Financa", "Statistika Ekonomike", "Menaxhim"). Gjithashtu, ka syllabuse që nuk i përkasin këtij programi studimi, si: "Struktura e të Dhënave" dhe "Programim në Web". Në tërësinë e vet shpërndarja e veprimtarive formuese është përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Evidenca 29: Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në "Financë-Kontabilitet; Evidenca 35: Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në "Financë-Kontabilitet"; Evidenca 40: Syllabuset e Lëndëve.
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Programi i studimit Bachelor në "Financë-Kontabilitet" i ofruar nga KU "Bedër" është hartuar në përputhje me parimet e Kartës së Bolonjës dhe Sistemit European të Transferimit dhe Mbledhjes së Krediteve. Struktura e programit të studimit i jep rëndësi si formimit në aspektin teorik, ashtu edhe atij praktik. Në RVB shpjegohet se programi i studimit është hartuar duke u mbështetur në programe të ngjashme dhe të konsoliduara brenda vendit, si: ✓ Bachelor në Financë, i ofruar nga FEUT ✓ Bachelor në Financë, i ofruar nga UET ✓ Bachelor në Financë-Bankë, i ofruar nga Universiteti Luarasi dhe në programe të ngjashme ndërkombëtare, si: ✓ Bachelor in Business Finance and Accounting, i ofruar nga University of Warsaw. Evidenca 29: Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në "Financë-Kontabilitet; RVB Bsc Financë Kontabilitet.
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Në planin mësimor të programit të studimit jepen të dhëna për secilën lëndë, si për aktivitetet e formimit teorik, ashtu edhe për ato praktike, si dhe të dhëna totale për të gjithë programin. Nga përlllogaritja e të dhënave (ku përfshihen orët e praktikës profesionale dhe diploma), rezulton se kemi: ✓ Leksione: 1560 orë ✓ Seminare: 555 orë ✓ Laboratorë: 15 orë ✓ Punë individuale: 2370 orë ✓ Totali: 4500 orë Programi i studimit përgjithësisht ruan një raport të ekuilibruar mes formimit teorik dhe atij praktik, duke respektuar ligjet në fuqi për organizimin sipas kategorive (A-E) dhe duke mundësuar arritjen e

	objektivave të tij. Njëkohësisht, organizimi i tij në lëndë me kredite dhe të ngjashme me programe kombëtare dhe ndërkombëtare mundëson transferimin dhe mobilitetin e studimeve me ndihmën e programeve Erasmus+. Janë 5 studentë të programit të studimit që kanë kryer mobilitete në Universitetin Applied Science në Kroaci dhe University American College në Maqedonin e Veriut. <i>Evidenca 41: Rregullorja për Transferimin të studimeve;</i> <i>Evidenca 104 Shkëmbimi i Studentëve;</i> <i>Tabela 9/shtojca: Plan i mësimor sipas veprimtarive formuese.</i> <i>VKM nr.41, datë 24.1.2018.</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Bazuar në rregulloret e brendshme të institucionit, Këshilli i Departamentit të Ekonomisë dhe Biznesit që ofron programin e studimit ka përgjegjësi për rishikimin dhe përditësimin e syllabuseve të lëndëve, duke i pasuruar ato me elemente shkencore dhe praktike, për të qenë më afër kërkesave të tregut, zhvillimeve teknologjike dhe literaturës bazë dhe asaj ndihmëse me tituj të pesë viteve të fundit. Diskutimet kryhen në departament në çdo fillim semestri, dhe syllabuset e përditësuara ngarkohen në sistemin e informacionit të institucionit (BIS). Çdo pedagog, syllabuset e firmosura ia dorëzon koordinatorit të departamentit. <i>Evidenca 40: Syllabuset e lëndëve;</i> <i>Evidenca 112: Mbledhje e Këshillit të Departamentit për diskutimin e syllabuseve; Evidenca 109; Shembull syllabusi të përditësuar.</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Programi i studimit Bachelor në "Financë-Kontabilitet" është propozuar duke u bazuar në përvojat më të mira vendase dhe të huaja në fushën e kontabilitetit dhe financës. Struktura dhe përmbajtja e lëndëve të programit të studimit ofrojnë studentëve njohuri akademike, kompetenca, aftësi dhe njohuri bashkëkohore si në fushën e financës, ashtu edhe në atë të kontabilitetit. Mënyrat inovative të mësimdhënies, të cilat janë një nga shtyllat kryesore të strategjisë së institucionit, si dhe infrastruktura që është në dispozicion, sigurojnë zhvillimin e aftësive dhe kompetencave për një integrim sa më të lehtë në tregun e punës vendas dhe ndërkombëtar. Gjithashtu, ofrimi i programit në gjuhën angleze mundëson mundësi për tregun ndërkombëtar. <i>Evidenca 29: Kurrikula –Bachelor në Financë-Kontabilitet;</i> <i>Evidenca 35: Rregullorja e Studimit Bachelor në "Financë-Kontabilitet".</i>
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me	Programi i studimit Bachelor në "Financë-Kontabilitet" mundëson për studentët marrjen e njohurive bazë shkencore dhe profesionale gjatë dy viteve të para të studimit dhe njohurive më të thelluara dhe të avancuara në vitin e tretë. Lëndët Bazat të kontabilitetit dhe Kontabilitetit drejtimi, Investimet dhe Financa ndërkombëtare, Sigurimet dhe menaxhimi i riskut, u mundësojnë studentëve një integrim më të shpejtë në tregun e punës. Një element i rëndësishëm është edhe praktika profesionale, e

pritsmëritë e kërkesat e tregut e punës.	cila është e detyrueshme në semestrin e dytë të vitit të tretë. Studentët e këtij programi studimi do ta zhvillojnë për herë të parë këtë vit akademik. Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me biznese dhe institucione të ndryshme ku studentët mund të realizojnë praktikën e tyre, duke u afruar kështu më shumë me tregun e punës. Mbarëvajtja e praktikës profesionale ndiqet nga pedagogu përgjegjës dhe Zyra e Planifikimit të Karrierës. Lëndët si "Metoda kërkimi dhe shkrimi akademik", "Ekonometri" dhe lëndë të tjera të zhvilluara në vitin e tretë, i japin studentëve njohuri të nevojshme për vazhdimin e studimeve në ciklin e dytë, si Master Profesional apo Shkencor, në fushën e finances, kontabilitetit dhe jo vetëm. <i>Evidenca nr. 5: Propozim për hapjen e programit Bachelor në "Financë Kontabilitet";</i> <i>Evidenca 29: Kurrikula – Bachelor në Financë-Kontabilitet; Evidenca 76: Marrëveshje bashkëpunimi me biznese dhe institucione;</i> <i>Evidenca 55: Procedura e praktikës profesionale.</i>			
Konkluzione	Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit Bachelor në "Financë-Kontabilitet" janë në përputhje me nivelin e gjashtë të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Ky program ofron studentët me njohuri teorike dhe praktike, duke i ofruar njohuri bashkëkohore dhe mundësi për transferime dhe shkëmbime gjatë ciklit të studimeve. Gjithashtu, programi ofron mundësi për integrim në tregun e punës, si dhe për kalime në nivele të tjera të studimeve, si Master Profesional apo Shkencor, pas përfundimit të studimeve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të	Kolegji Universitar "Bedër" ka si politikë të tij vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit që ofron. Vlerësimi i çdo programi studimi realizohet nga Departamenti, Zyra e Zhvillimit të Kurrikulës, Fakulteti, Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë dhe Standardeve dhe rezultatet i përcillen Senatit Akademik. Përmirësimi i programeve realizohet nëpërmjet pikave të mëposhtme: ✓ Vlerësimi i programit të studimit, i cili realizohet përmes anketave me studentët në semestrin e fundit të studimeve. ✓ Vlerësimi i cilësisë së programit të studimit, që realizohet përmes anketimit të studentëve të diplomuar.

diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	✓ Vlerësimi i cilësisë së programit të studimit nga ekspertë të fushës dhe bashkëpunëtorë të jashtëm, i cili realizohet pas diplomimit të brezit të pare. Departamenti bashkëpunon me Zyrën e Planifikimit të Karrierës dhe këshilltarin akademik, duke organizuar takime me studentë dhe bashkëpunëtorë të ndryshëm nga tregu i punës, për te qenë më afër dinamikave të tij. <i>GVJ konstaton se programi i studimit "Bachelor në Financë-Kontabilitet", i ofruar nga Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit, ndodhet në procesin e parë të akreditimit dhe, për momentin, nuk ka rezultate të anketave nga studentët e këtij programi.</i> <i>Evidenca 4: Anketë vlerësimi i të diplomuarve për programin e studimit;</i> <i>Evidenca 38: Udhëzimi mbi Procesin e Zhvillimit të Kurrikulave;</i> <i>Evidenca 46: Politika për Përmirësimin e programeve të studimit;</i> <i>Evidenca 47: Anketë vlerësimi i studentëve për programin e studimit;</i> <i>Evidenca 61: Vendimi i Këshillit të Departamentit për caktimin e përfaqësuesit pranë Zyrës së Planifikimit të Karrierës.</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Kolegji Universitar "Bedër" mbështet studentët në shprehjen e mendimeve dhe sugjerimeve të tyre në lidhje me përmirësimin e programeve të studimit. Studentët japin mendimet e tyre në mënyrat e mëposhtme: 1. Përmes anketave që zhvillohen për: ✓ Lëndët që ndjekin, ✓ Programin e studimit, ✓ Institucionin, ✓ Stafin akademik; 2. Përmes këshilltarit akademik; 3. Nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në strukturat përkatëse, si: ✓ Senati Akademik, ✓ Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë, ✓ NJSBC (Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë), ✓ Këshilli i Departamentit të Ekonomisë dhe Biznesit. <i>Evidenca 1: Statuti i Kolegjit Universitar "Bedër"; Evidenca 16: Rregullorja e funksionimit të komisionit të përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit ; Evidenca 34: Anketa e studentit ndaj lëndës; Evidenca 47: Anketë vlerësimi i studentëve për programin e studimit; Evidenca 50: Anketë vlerësimi i studenteve për institucionin; Evidenca 71: Studentët përfaqësues në mbledhjet e Këshillit të Departamentit; Evidenca 97: Vendimi i zgjedhjes së Komisionit të përhershëm për garantimin e standardeve dhe cilesisë.</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete	Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit, si njësia që ofron programin e studimit Bachelor në Financë-Kontabilitet, ndjek në mënyrë të vazhdueshme procesin e vlerësimit, përmirësimit dhe përditësimit të programeve të studimit. Kjo bëhet me qëllim që programet të jenë të përditësuara me literaturë bashkëkohore, në përputhje me ritmin e zhvillimeve teknologjike dhe dinamikat e tregut të punës. Institucioni ka vendosur bashkëpunime të qëndrueshme me biznese dhe institucione të ndryshme, duke organizuar trajnime profesionale

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.asc.al




profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	me stafin akademik, me synim rritjen e cilësisë së mësimdhënies në të gjitha aspektet e saj. Në dokumentin e propozimit të programit konstatohet se ky program mbështetet në modelet e ndjekura nga programe të ngjashme të institucioneve të arsimit të lartë, vendase dhe të huaja, duke integruar në të edhe teknika inovative të mësimdhënies. <i>Evidenca 5: Propozim për hapjen e programit Bachelor në "Financë Kontabilitet"; Evidenca 46: Politika për Përmirësimin e programeve të studimit; Evidenca 52: Politika e cilësisë; Evidenca 76: Marrëveshje bashkëpunimi me biznese dhe institucione; Evidenca 112: Mbledhje e Këshillit të Departamentit për diskutimin e syllabuseve.</i>			
Konkluzione	Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, GVJ konstaton se Kolegji Universitar "Bedër" ka si politikë të tij vlerësimin, përditësimin dhe rishikimin e programeve të studimit, bazuar në mendimet dhe sugjerimet e studentëve dhe bashkëpunëtorëve të tij. Studentët përfaqësohen dhe kanë mundësi të shprehin mendimin e tyre në organet dhe strukturat vendimmarrëse si: Senati Akademik, Këshilli i Departamentit, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë. Mendimi i studentëve mbledhet gjithashtu përmes anketave, të cilat lidhen me: Lëndët e zhvilluara, Institucionin, Pedagogët, Cilësinë e përgjithshme të programit të studimit. Për programin e studimit "Bachelor në Financë-Kontabilitet", mendimi i studentëve për cilësinë e programit nuk është marrë ende, pasi nuk ka ende studentë të diplomuar.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijes janë të pasqyruara në syllabuset e lëndëve të programit të studimit. Kolegji Universitar “Bedër” ndjek një standard të përcaktuar të metodologjisë së mësimdhënies, të mbështetur në Rregulloren Themelore, Rregulloren e ciklit të parë të studimeve dhe Rregulloren e programit të studimit, në të cilat janë të përcaktuara aktivitetet bazë që garantojnë realizimin efektiv të lëndëve të programit. Në total, janë të planifikuara 2130 orë mësimore, të shpërndara sipas kategorive të mëposhtme: ✓ Leksione: 1530 orë ✓ Seminare: 510 orë ✓ Praktikë (në auditor): 0 orë ✓ Labororë: 15 orë ✓ Praktikë profesionale: 45 orë ✓ Mikroteza / Provim përfundimtar: 45 orë Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit organizon gjithashtu aktivitete ekstrakurrikulare për studentët, duke përfshirë leksione të hapura, workshope, konferenca studentore dhe shkolla verore. <i>Evidenca 3: Rregullorja Themelore; Evidenca 6: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë; Evidenca 35: Rregullorja e Studimit Bachelor në "Financë-Kontabilitet", Evidenca 67: Raporti Vjetor i Departamentit të Ekonomisë dhe Biznesit 2023-2024; Evidenca 70: Plan i aktiviteteve për vitin akademik 2024-2025; https://www.beder.edu.al/veprintaria-jone/aktivitete</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Stafi akademik bën përpjekje të konsiderueshme për të përmirësuar format dhe metodat e mësimdhënies, si nëpërmjet bashkëpunimit brenda departamentit, ashtu edhe përmes nxitjes së pjesëmarrjes aktive të studentëve, duke krijuar një proces gjithëpërfshirës. Gjithashtu, stafi akademik ofron orë shtesë në formën e konsultimeve me studentët, për të adresuar nevojat që lindin gjatë procesit mësimor. Institucioni e mbështet stafin akademik jo vetëm me mjetet dhe trajnimet e nevojshme, por edhe përmes strategjive të zhvillimit strategjik, si dhe me strategjinë e mësimdhënies inovative. Studentët kanë të drejtë të vlerësojnë, në fund të çdo semestri, syllabuset e lëndëve që kanë ndjekur, po ashtu dhe në vlerësimin e programit të studimit që zhvillohet në semestrin e fundit të studimeve. Si në dokumentacionin e dorëzuar, ashtu edhe nga takimet me studentët në institucion, konstatohet se përfaqësuesi i studentëve merr pjesë në mbledhjet periodike të Këshillit të Departamentit, duke përcjellë kështu shqetësimet dhe sugjerimet e studentëve.

	<i>Evidenca 15: Plani Strategjik Institucional 2024-2028; Evidenca 29: Kurrikula –Bachelor në Financë-Kontabilitet; Evidenca 34: Anketa e studentit ndaj lëndës; Evidenca 47: Anketë vlerësimi i studentëve për programin e studimit; Evidenca 71: Studentët përfaqësues në mbledhjet e Këshillit të Departamentit; Evidenca 102: Udhëzues mbi mësimdhënien inovative në KU Bedër.</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Një nga objektivat kryesore të institucionit është përfshirja e teknologjisë në mësimdhënie, diversifikimi i formave të mësimdhënies dhe implementimi i programeve të ndryshme për përmirësimin e cilësisë së mësimnxënies. Siç është theksuar në dokumentacionin e dorëzuar dhe në takimet me stafin akademik, konstatohet se institucioni mbështet stafin akademik në kërkimin shkencor dhe ofron mbështetje për pjesëmarrjen në konferenca shkencore ndërkombëtare me partnerë, pa pagesë, si dhe mbështetje financiare për botime shkencore. Stafi akademik ka përfituar gjithashtu nga programet e shkëmbimit me institucione të huaja, si programi Erasmus+, si për metodat e mësimdhënies, ashtu edhe për kërkimin shkencor. Stafi akademik çdo vit akademik plotëson formularin e vetëvlerësimit, në të cilin parashikohen objektivat, nevojat dhe planet për trajnime dhe kërkime, të cilat diskutohen në njësinë bazë dhe njësinë kryesore, duke përcaktuar gjithashtu një plan aktivitesh. Në këtë kuadër, institucioni ofron trajnime profesionale të nevojshme për zhvillimin profesional dhe avancimin në kërkim. Po ashtu, institucionin mbështet me infrastrukturën e nevojshme teknologjike, e cila është në funksion të procesit mësimor, por edhe kërkimit shkencor. Angazhimi i stafit në projekte, trajnime, leksione të hapura dhe workshope ka për qëllim përmirësimin e procesit akademik dhe promovimin e rezultateve të punës së tyre në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe pedagogjike në procesin e mësimdhënies, si dhe për të qenë më afër dinamikave të tregut e mbështetur kjo edhe marrëveshjet me biznese dhe institucione. <i>Evidenca 19: Rregullorja mbi projektet kërkimore shkencore; Evidenca 39: Formular vlerësimi për stafin akademik; Evidenca 25: Marrëveshje mobiliteti Erasmus +; Evidenca 67: Raporti Vjetor i Departamentit të Ekonomisë dhe Biznesit 2023-2024; Evidenca 69: Lista e Trajnimeve të organizuara për Stafin Akademik 2022-2024; Evidenca 70: Plani i aktiviteteve për vitin akademik 2024-2025; Evidenca 76: Marrëveshje bashkëpunimi me biznese dhe institucione; Evidenca 101: Lista e trajnimeve me qëllim përmirësimin e aftësive didaktike; Evidenca 108: Shkëmbi i stafit.</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies	Gjatë takimeve me stafin akademik, si efektivët ashtu dhe ata me kontratë të angazhuar në programin e studimit Bachelor në “Financë-Kontabilitet”, u shfaq një dëshirë dhe përkushtim i madh për të zhvilluar sa më mirë procesin e mësimdhënies. Nga ana tjetër, institucioni, përmes departamentit dhe Njesisë së Sigurimit të Cilësisë (NjSBC), ushtron kontroll mbi zbatimin e cilësisë së mësimdhënies dhe




interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	performancës së personelit të angazhuar në mësimdhënie, gjë që kontribuon në garantimin e cilësisë në procesin e mësimdhënies. Stafi akademik dhe ndihmës akademik, të përfshirë në programin e studimit, janë të qëndrueshëm dhe janë pjesë e institucionit që nga hapja e programit. Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit është përgjegjës për shpërndarjen e ngarkesës mësimore, e cila bëhet në përputhje me fushën e ekspertizës së stafit akademik. Kjo shpërndarje bazohet në angazhimin e stafit akademik të kualifikuar dhe me eksperiencë akademike, për të siguruar mësimdhënie cilësore. Institucioni ka një politikë të fortë për mësimdhënie inovative, të mbështetur nga infrastruktura e tij, me qëllim rritjen e interesit të studentëve dhe përfshirjen e tyre në diskutime aktive. Realizimi i aktiviteteve të tjera ekstrakurrikulare, si leksione të hapura me ekspertë të fushës, trajnime që zhvillohen në kuadër të bashkëpunimeve që institucioni ka me biznese dhe institucione, ka në fokus nxitjen e mendimit krijues te studentët. Stafi akademik mbështet dhe respekton studentin gjatë rrugëtimit të tij akademik, duke ndjekur udhëzimet e paraqitura në udhëzuesin e stafit. Pedagogu mbështet, këshillon dhe udhëzon studentët gjatë gjithë ciklit të studimit, deri në diplomimin e tyre. Gjithashtu, këshilltari akademik ka si detyrë të ndihmojë studentin në çdo proces që lidhet me mësimdhënien dhe zhvillimin e tij akademik. <i>Evidenca 27: Guida e Stafit; Evidenca 42: Miratimi i Udhëzuesit të Këshilltarit Akademik ; Evidenca 54: CV-të e stafit akademik; Evidenca 102: Udhëzues mbi mësimdhënien inovative në KU "Bedër".</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit, si njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson në mënyrë të vazhdueshme metodat e mësimdhënies me qëllim përmirësimin e tyre. Në këtë proces përfshihen stafi akademik, bashkëpunëtorët e jashtëm dhe në mënyrë të veçantë studentët. Studentët shprehin mendimin e tyre përmes përfaqësuesve në organet përkatëse brenda institucionit, si dhe nëpërmjet mentorëve dhe këshilltarëve akademikë. Një nga mjetet kryesore për mbledhjen e opinionit të tyre është anketa e studentit, e cila zhvillohet përpara provimit përfundimtar të lëndës. Pyetësori për vlerësimin e lëndëve përfshin katër komponentë kryesorë: ❖ Përgatitja dhe qartësia në mësimdhënie ❖ Etika profesionale dhe angazhimi i pedagogut ❖ Mbështetja dhe vlerësimi i studentit ❖ Qartësia e programit dhe mënyrës së vlerësimit Gjatë takimit në institucion u konstatua se vlerësimet e marra nga anketat e studentëve analizohen në mënyrë të detajuar. Në rastet kur vlerësimet janë të ulëta, diskutohen masat për përmirësim. <i>Në programin e studimit bachelor në "Finance-Kontabilitet", nuk janë regjistruar vlerësime nën mesataren. Kjo lidhet, ndër të tjera, me numrin e vogël të studentëve dhe komunikimin e ngushtë që ata kanë me lektorët gjatë gjithë procesit mësimor – një aspekt që u konfirmua edhe nga vetë studentët gjatë takimit me ta.</i>

	Evidenca 34: Anketa e studentit ndaj lëndës. Në bazë të dokumentacionit që shoqëron RVB-në, në Kolegjin Universitar "Bedër" funksionojnë këto struktura: ❖ Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë – një strukturë autonome dhe e përhershme, e cila ka për detyrë të vlerësojë periodikisht rezultatet dhe efikasitetin e veprimtarive mësimore, të nxisë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në nivel institucional, si dhe të mbështesë veprimtaritë formuese dhe trajnuese; ❖ Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve dhe Cilësisë Institucionale – një organ kolegjal, i cili garanton respektimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit; ❖ Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit – përgjegjës për programin e studimit, monitoron në mënyrë të vazhdueshme procesin e mësimdhënies dhe të nxënies, vlerësimin e këtij procesi nga studentët, kryen analiza periodike dhe propozon përmirësime, duke mbështetur gjithashtu stafin akademik në zhvillimin e tyre profesional; ❖ Zyra e Kërkimeve dhe Projekteve, Zyra e Burimeve Njerëzore, si edhe Qendra për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Inovacion, në bashkëpunim me NjSBC, koordinojnë trajnimet e stafit akademik për zhvillimin profesional të tyre. Të gjitha këto struktura bashkërendojnë, kontrollojnë dhe nxisin përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, me qëllim rritjen e cilësisë së saj. Në KU "Bedër", stafi akademik çdo vit plotëson formularin e vetëvlerësimit, i cili përmban pika kyçe mbi performancën profesionale. Rezultatet e vetëvlerësimeve analizohen fillimisht nga njësia bazë, më pas raportohen te njësitë kryesore dhe përmbledhen në një raport përfundimtar nga Komisioni i Kërkimeve Shkencore dhe Projekteve. Institucioni, duke respektuar rregulloret në fuqi, ka hartuar një udhëzues institucional që ndjek qasjen e mësimdhënies me në qendër studentin. Ky udhëzues përmban informacion lidhur me: ✓ Mësimdhënien: mënyrat, qasjet dhe metodat; ✓ Qasjet inovative të mësimdhënies në arsimin e lartë; ✓ Mësimdhënie dhe të nxënie të barabartë dhe gjithëpërfshirës. Evidenca 19: Rregullorja mbi projektet kërkimore shkencore; Evidenca 39: Formular vlerësimi për stafin akademik; Evidenca 47: Anketë vlerësimi i studentëve për programin e studimit; Evidenca 49: Procedura e vlerësimit të performancës së stafit akademik; Evidenca 102: Udhëzues mbi mësimdhënien inovative në KU "Bedër"; Evidenca 101: Lista e trajnimeve me qëllim përmirësimin e aftësive didaktike.
Konkluzione	Kolegji Universitar "Bedër" ka politika të brendshme të bazuara në rregullat në fuqi për vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Rregullorja e brendshme e institucionit mbështet stafin

	akademik në përmirësimin e metodave të mësimdhënies dhe të vlerësimit gjatë procesit mësimor. Në varësi të nevojave të identifikuara për trajnime, të cilat dalin nga analiza e formularëve të vetëvlerësimit të plotësuar nga stafit, institucioni ofron mbështetje për zhvillimin profesional të stafit akademik. Kjo mbështetje synon rritjen e cilësisë së mësimdhënies me qendër studentin. Studentët shprehin mendimet dhe sugjerimet e tyre lidhur me problematika të ndryshme të procesit mësimor, si përmes përfaqësuesve të tyre brenda institucionit, ashtu edhe nëpërmjet anketave të cilat lidhen me cilësinë e programeve të studimit, lëndëve të zhvilluara dhe institucionit në tërësi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregullorën e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Rregullorja e programit të studimit Bachelor në "Financë - Kontabilitet" përcakton të gjitha kërkesat e këtij kriteri, duke filluar nga pranimi i studentëve, vlerësimi i njohurive, dhe deri në diplomimin ose transferimin e tyre. Informacione të vlefshme studentët mund t'i gjejnë në: ✓ Rregulloren Themelore të institucionit ✓ Rregulloren e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Parë ✓ Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor në Financë dhe Kontabilitet ✓ Guidën e Studentit ✓ Sistemin e informacionit të institucionit ✓ Faqen zyrtare të institucionit Po ashtu, çdo syllabus ka të pasqyruar qartë mënyrën e testimit dhe vlerësimit të njohurive të studentëve. Këto rregulla u bëhen me dije studentëve gjatë javës së orientimit. Për studentët e sapo regjistruar, informacionet kryesore gjenden gjithashtu në kontratën që ata nënshkruajnë. Çdo student pajiset nga Sekretaria Mësimore me një email institucional, nëpërmjet të cilit mund të aksesojë llogarinë e tij në sistemin BIS për të marrë informacionet e nevojshme lidhur me lëndët që zhvillojnë. <i>Evidenca 3: Rregullorja Themelore; Evidenca 6: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë; Evidenca 24: Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS); Evidenca 28: Guida e Studentit; Evidenca 35: Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në "Financë-Kontabilitet"; https://www.beder.edu.al/</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët	Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të studentëve për çdo lëndë është i shpjeguar në çdo syllabus.

informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në javën e parë të çdo lënde, pedagogët informojnë studentët për metodologjinë e testimit të njohurive dhe dijeve të marra, dhe më pas e publikojnë këtë informacion në sistemin BIS, ku mund të aksesohen nga çdo student. <i>Evidenca 24: Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS);</i> <i>Evidenca 40: Syllabuset e Lëndëve.</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Testimi dhe vlerësimi i njohurive të studentëve realizohet përmes formave të ndryshme, të përcaktuara në syllabus-in e çdo lënde, me qëllim ofrimin e më shumë mundësive për studentët që të shprehin njohuritë dhe kompetencat e fituara. Të gjitha format e vlerësimit janë të parashikuara në Rregulloret e Institucionit dhe në Rregulloren e Programit të Studimit bachelor në Financë-Kontabilitet. Format e kontrollit të njohurive përfshijnë: ✓ Pjesëmarrje dhe angazhim aktiv: 0–10% ✓ Përmeshja e detyrimeve (laboratorë, detyra kursi): 10–30% ✓ Testime gjatë vitit: 30–40% ✓ Provimi përfundimtar: 40–60% Vlerësimi përfundimtar bëhet në varësi të pikëve të grumbulluara, sipas përqindjeve të përcaktuara më sipër, me një total prej 100 pikësh, duke ndjekur skemën e vlerësimit të unifikuar për të gjitha lëndët e programit të studimit. Studentët janë të informuar për çdo hap të procesit, që nga pjesëmarrja dhe vlerësimi gjatë vitit, deri te vlerësimi përfundimtar, përmes sistemit BIS. <i>Evidenca 6: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë; Evidenca 24: Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS); Evidenca 28: Guida e Studentit; Evidenca 35: Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në "Financë-Kontabilitet"; Evidenca 40: Syllabuset e Lëndëve; Shtojca Tabela 15: Forma e kontrollit të dijeve.</i>
Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar	Në KU "Bedër", Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është përgjegjëse për hartimin e politikave për vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të metodave të mësimdhënies. Ajo bashkërendon me Departamentin e Ekonomisë dhe Biznesit, i cili është përgjegjës për programin e studimit Bachelor në Financë dhe Kontabilitet. Pikat kryesore të sugjerimeve vijnë nga studentët, mendimi i të cilëve merret: ✓ Në mënyrë të drejtpërdrejtë, nga kontaktet me koordinatoren e programit të studimit, si dhe nga studentët përfaqësues në mbledhjet e Këshillit të Departamentit. ✓ Në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, përmes pyetësorëve për vlerësimin e lëndës, të cilat organizohen nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Nga takimet në institucion u konstatuan se studentët duhet të shprehin mendimet e tyre nëpërmjet anketimeve, të cilat janë të lidhura me sistemin BIS, pas plotësimit të tyre u japin të drejtën për t'u regjistruar në provimin përfundimtar.

mendimet e sugjerimet e tyre.	Çdo vit akademik, në varësi të nevojave të stafit akademik, realizohen trajnime për ta, me fokus te metodologjitë inovative të mësimdhënies. <i>Evidenca 17: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së; Evidenca 32: Rregullore e anketave dhe vlerësimeve; Evidenca 34: Anketa e studentit ndaj lëndës; 35: Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në "Financë-Kontabilitet"; Evidenca 71: Studentët përfaqësues në mbledhjet e Këshillit të Departamentit.</i>
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxëniet, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit ofron për studentët e programit të studimit Bachelor në Financë-Kontabilitet një infrastrukturë moderne për realizimin e një procesi mësimor, i cili gërsheton mësimdhënien teorike me atë praktike, me qëllim arritjen e objektivave të formimit të studentëve në përputhje me tregun dinamik të punës. Studentët kanë në dispozicion bibliotekën, sallat dhe laboratorët e pajisura me programet e nevojshme, si dhe klasa me tabela interaktive. Staf akademik ofron literaturë bazë dhe ndihmëse për studentët. Në shumë lëndë janë të planifikuara detyra kursi dhe diskutime mbi raste studimore, duke nxitur jo vetëm punën në grup, por edhe zhvillimin e interesit, aftësive të komunikimit dhe bashkëpunimit, si dhe përgatitjen për një punë të pavarur. Institucioni, përmes bashkëpunimeve të tij, mbështet stafin akademik me trajnime profesionale në biznese dhe institucione, duke mundësuar ngritjen e kapaciteteve profesionale të tyre, ku përfituesit janë studentët. Pjesëmarrja e studentëve në aktivitete të tjera të organizuara në DEB krijon një ambient mbështetës dhe inkurajues për studentët, gjë që u konfirmua edhe në takimet me studentët në institucion. <i>Evidenca 29: Kurrikula - Bachelor në Financë Kontabilitet; Evidenca 69: Lista e Trajnimeve të organizuara për Stafin Akademik 2022-2024; Evidenca 76: Marrëveshje bashkëpunimi me biznese dhe institucione; Evidenca 101: Lista e trajnimeve me qëllim përmirësimit të aftësive didaktike; Evidenca 102 : Udhëzues mbi mësimdhënien inovative në KU "Bedër".</i>
Konkluzione	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, GVJ konstaton se në Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor në Financë-Kontabilitet dhe në syllabuset e secilës lëndë, përcaktohen qartë mënyrat e testimit dhe vlerësimit të njohurive dhe aftësive të fituara nga studentët gjatë procesit mësimor, në përputhje me objektivat e programit të studimit.




Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Informacioni mbi format e testimit dhe mënyrat e vlerësimit të njohurive përcaktohet në dokumentet themelore të Kolegjit Universitar "Bedër", përfshirë: ✓ Rregulloren Themelore të KU "Bedër"; ✓ Rregulloren e Ciklit të Parë të Studimeve (Bachelor); ✓ Rregulloren e programit të studimit "Bachelor në Financë-Kontabilitet". Vlerësimi përfundimtar i studentit është një rezultat i kombinuar i vlerësimeve të kryera gjatë vitit akademik dhe të provimit përfundimtar, bazuar në peshën specifike që ka secili komponent ka në strukturën e vlerësimit. Sipas dokumenteve të sipërpërmendura, komponentët e vlerësimit dhe përqindjet përkatëse janë si më poshtë: ✓ 0–10% – Pjesëmarrja aktive në leksione dhe seminare; ✓ 10–30% – Plotësimi i detyrimeve akademike (punë laboratorike, detyra kursi, esse, projekte etj.); ✓ 30–40% – Testimet dhe vlerësimet ndërmjetëse gjatë vitit; ✓ 40–60% – Provimi përfundimtar. Këto përqindje mund të ndryshojnë lehtësisht nga një lëndë në tjetrën, në varësi të natyrës së lëndës, por gjithmonë mbeten brenda kufijve të përcaktuar më sipër. Transparenca për studentin: Studenti njihet me strukturën e vlerësimit për çdo lëndë në mënyrat e mëposhtme: ✓ Gjatë javës së parë të mësimi, ku pedagogu prezanton programin e lëndës, mënyrën e vlerësimit dhe objektivat mësimore; ✓ Përmes sistemit të brendshëm të informacionit të institucionit (BIS); ✓ Në Guidën e Studentit, e cila përmban informacion të detajuar mbi organizimin e studimeve; ✓ Në faqen zyrtare të fakultetit, ku publikohen informacione mbi programet, kurrikulat dhe praktikat e vlerësimit. <i>Evidenca 3: Rregullorja Themelore; Evidenca 6: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë; Evidenca 24: Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS); Evidenca 28: Guida e Studentit; Evidenca 29: Kurrikula - Bachelor në Financë Kontabilitet; Evidenca</i>

	35: Rregullorja e Studimit Bachelor në "Financë-Kontabilitet"; Evidenca 40: Sylabuset e Lëndëve <u>https://www.beder.edu.al/programet/bachelor-ne-finance-kontabilitet/kurrikula</u>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Testimi përfundimtar i studentëve realizohet në auditor përmes kopjeve fizike të provimeve, të cilat janë të sekretuara me kod të personalizuar nga student (ID), për të shmangur forma të ndryshme abuzimi. Megjithatë, në Kolegjin Universitar "Bedër", me ndihmën e sistemit të informacionit BIS, studenti është i informuar në profilin e tij personal për frekuentimin e lëndëve dhe për vlerësimet e mundshme që janë në dispozicion gjatë vitit. Kjo mundëson që procesi i vlerësimit të jetë sa më transparent dhe i qartë për të gjithë studentët. Në dokumentet shoqëruese të programit, përfshihet edhe një model testimi elektronik, i cili është përdorur për lëndën E-commerce dhe realizohet përmes platformës "Testportal". Ky model i testimit elektronik ofron mundësi për vlerësim të avancuar dhe ndihmon në përmirësimin e proceseve të vlerësimit për studentët, duke siguruar më shumë fleksibilitet dhe qasje të drejtpërdrejtë në rezultatet e tyre. Evidenca 6: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë; Evidenca 24: Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS); Evidenca 93: Shembull Provimi me Testim elektronik e-Commerce Final Exam.
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Vlerësimi përfundimtar i njohurive të lëndës është një mesatare e ponderuar e komponenteve përbërës të saj, të cilat përfshijnë: aktivizimin e studentëve, plotësimin e detyrimeve akademike, testimet dhe vlerësimet ndërmjetëse gjatë vitit (të cilat zhvillohen në javën e tetë të semestrit), dhe provimin përfundimtar. Peshat për secilën lëndë janë të shpjeguara në syllabusin e lëndës dhe studentët njihen me to gjatë javës së parë të mësimit. Pas kësaj, informacioni është i disponueshëm në sistemin BIS dhe në faqen zyrtare të institucionit. Evidenca 6: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë; Evidenca 24: Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS); Evidenca 29: Kurrikula - Bachelor në Financë Kontabilitet; Evidenca 35: Rregullorja e Studimit Bachelor në "Financë-Kontabilitet"; Evidenca 40: Sylabuset e Lëndëve <u>https://www.beder.edu.al/programet/bachelor-ne-finance-kontabilitet/kurrikula</u>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar	Tezat janë të paraqitura qartë, duke përcaktuar pikëzimin dhe vlerësimin për çdo kërkesë. Çdo provim ka gjithashtu çelësin e zgjidhjeve, i cili është i disponueshëm për studentët. Në çdo rast që studentët kanë nevojë për konsultime, sqarime ose këshillime, pedagogët janë të gatshëm të ofrojnë mbështetje dhe këshillim të vazhdueshëm, edhe jashtë orarit mësimor. Kjo mundëson që të sqarohet ecuria aktuale e studentëve dhe mundësitë për përmirësimin e mëtejshëm në procesin mësimor.

studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Duke pasur parasysh se lëndët në këtë program studimi zhvillohen në grupe jo masive, pedagogët kanë mundësinë të kontaktojnë dhe të diskutojnë me studentët në grupe të vogla për ecurinë e provimeve dhe për çdo pyetje ose shqetësim që mund të kenë ata gjatë procesit mësimor. Në rast se studenti ka ankesa ndaj rezultatit përfundimtar të një provimi semestral, ai ka të drejtë që brenda një jave nga dita e publikimit të rezultateve të paraqesë një ankesë me shkrim tek Zyra e Sekretarisë Mësimore. Ankimi shqyrtohet mbi gabimet materiale, nga një komision i cili ngrihet me vendim të Këshillit të Departamentit përkatës dhe përbëhet prej tre vetash. Pedagogu i lëndës nuk mund të jetë pjesë e këtij komisioni. Vendimi i bëhet i ditur studentit jo më shumë se 15 ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës për rishikim. <i>Evidenca 3: Rregullorja Themelore; Evidenca 35: Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në "Financë-Kontabilitet"; Evidenca 56: Shembull, organizimi i provimeve finale; Evidenca 92: Shembull Provimi me Celesin e Zgjidhjeve.</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Studenti në KU "Bedër" është i informuar mbi ndalimin e përdorimit të mjeteve të palejuara gjatë provimeve dhe mbi ndëshkimin e plagjiaturës, përmes: ✓ Rregullores së studimeve dhe provimeve të ciklit të parë; ✓ Rregullores së disiplinës së studentëve; ✓ Guidës së studentit. Në këto dokumente theksohet se shkeljet në provime përfshijnë: mbajtjen e materialeve të paautorizuara (si telefonat), shqetësimet në klasë, kopjimin nga një student tjetër, si dhe gjetjen e pyetjeve të provimit para zhvillimit të tij. Për këto shkelje, merren masa disiplinore që mund të variojnë nga paralajmërimi deri në pezullimin përfundimtar të studentit. Institucioni ka vënë në dispozicion të stafit akademik platformën softuerike "Beder Plagiarism Checker System", për të parandaluar plagjiaturën në detyrat e kursit, projekte, dhe çdo material tjetër që është pjesë e përmbushjes së detyrimeve ndaj lëndës. Stafi akademik është përgjegjës për kontrollimin e fenomeneve të kopjimit gjatë provimeve. Këto provime zhvillohen në auditorë të mëdhenj, por është e rëndësishme të theksohet se programi i studimit Bachelor në "Financë-Kontabilitet" ka një numër të vogël studentësh, çka e bën këtë fenomen më të kontrolluar. <i>Evidenca 3: Rregullorja Themelore; Evidenca 6: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë; Evidenca 33: Rregullorja e disiplinës së studentëve; Evidenca 35: Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në "Financë-Kontabilitet"; Evidenca 56: Shembull, organizimi i provimeve finale.</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen	Rezultatet e dhëna nga pedagogu për kontrollin e dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve bazohen në meritë, duke respektuar afatet e shpallura në kalendarin akademik. Ky kalendar është i disponueshëm në




në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	faqen zyrtare të institucionit dhe gjithashtu në formë elektronike, përmes email-ëve zyrtarë të studentëve, në fillim të vitit akademik. Gjendja e suksesit të çdo lënde u dorëzohet organeve administrative përkatëse brenda afatit të përcaktuar në kalendarin akademik, dhe rezultatet publikohen në faqen personale të studentëve në sistemin BIS. Evidenca 35: Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Financë Kontabilitet; https://www.beder.edu.al/kalendari-akademik/2024-2025-bachelor
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Në Rregulloren e Programit të Studimit, në nenin 20 "Notat, provimet dhe kalueshmëria", institucioni u garanton studentëve të drejtën e njohjes me vlerësimin e provimeve, dhe në nenin 28 ,u garanton gjithashtu të drejtën për "Ankimimin ndaj rezultateve të provimeve". Studenti ka të drejtën e ballafaqimit me pedagogun për çdo paqartësi ose mosmarrëveshje në lidhje me vlerësimin. Nëse kjo nuk sjell zgjidhje, studenti ka të drejtë të paraqesë një ankesë me shkrim tek Zyra e Sekretarisë Mësimore brenda një jave nga dita e publikimit të rezultateve. Përgjegjësi i departamentit ngre një komision rivlerësimi për shqyrtimin e ankesës. Vendimi i komisionit është përfundimtar dhe bëhet i ditur studentit jo më vonë se 15 ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës. Kjo procedure dokumentohet dhe arkivohet pranë departamentit. Në dokumentacionin e dorëzuar, nuk ka ndonjë procedurë të detajuar për ankimimin e notës. Nga takimet në institucion është konfirmuar se në programin e studimit Bachelor në "Financë-Kontabilitet" nuk ka pasur raste ankimesh për nota deri tani. Evidenca 35: Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Financë Kontabilitet;
Konkluzione	Në Rregulloren e Programit të Studimit, KU "Bedër" ka përcaktuar qartë mënyrën e testimit dhe vlerësimit të fituar nga studentët për secilën lëndë, duke siguruar një vlerësim të drejtë, transparent dhe të bazuar në meritë. Po ashtu, studentët kanë të garantuar të drejtën e ankimimit në rast mosdakordësie për vlerësimin e njohurive të provimit, kolekiumit, detyrave të kursit, etj. Studentët janë të njohur gjithashtu me detyrimet e tyre përmes Rregullores së Disiplinës së Studentëve, ku është sqaruar qartë se nuk lejohet kopjimi në provime dhe plagjiatura. Për shmangien e këtyre shkeljeve, përgjegjës është staf i akademik. Institucioni ka vënë në dispozicion të stafit një software për kontrollin e plagjiaturës. GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në "Financë-Kontabilitet" ka një numër të vogël studentësh, dhe kjo është një lehtësi për të mundësuar komunikim më të lehtë dhe për të garantuar një kontroll më të mirë të procesit mësimor, si dhe për të trajtuar dhe kontrolluar problemet e mundshme si kopjimi dhe plagjiatura.




Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit Bachelor në “Financë-Kontabilitet” synon t’u ofrojë studentëve njohuri teorike dhe praktike në fushën e financës dhe kontabilitetit, si dhe mundësi për të zhvilluar aftësitë e tyre profesionale, në përputhje me nivelin e njohurive të ciklit të parë të studimeve. Gjatë studimeve, studentët marrin pjesë në leksione për çdo lëndë, të cilat shoqërohen edhe me seminare, projekte, detyra kursi dhe diskutime mbi raste studimore – veçanërisht në vitin e dytë dhe të tretë të studimeve. Këto aktivitete synojnë të nxisin punën në grup, mendimin kritik dhe zhvillimin profesional të studentëve. Përveç elementëve të përfshirë në kurrikul, institucioni i kushton rëndësi përfshirjes së studentëve në aktivitete të tjera akademike dhe praktike, të tilla si: ✓ Leksione të hapura ✓ Trajnime profesionale ✓ Konferenca shkencore ✓ Shkolla verore ✓ Internship-e në biznese dhe institucione publike apo private, me të cilat institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi Disa nga aktivitetet e realizuara janë: ✓ Shkolla Verore “FinTech” ✓ Investime në bursa (në kuadër të moduleve praktike) ✓ Simulimi i sistemit “Enterprise Resource Planning (ERP)” ✓ Konkursi “SUSILO” – të mësuarit dhe të nxëniet përmes sfidave. Gjithashtu, në kurrikulën e programit është parashikuar edhe praktika profesionale, e cila zhvillohet gjatë semestrit të fundit të studimeve. Megjithatë, deri në momentin e shqyrtimit të këtij dokumentacioni, studentët e këtij programi nuk e kanë realizuar ende praktikën mësimore. Për pasojë, nuk ekziston një dokument referues zyrtar që të përshkruajë mënyrën e organizimit, zhvillimit dhe vlerësimit të praktikës profesionale për këtë program studimi. <i>Evidenca 29: Kurrikula - Bachelor në Financë Kontabilitet; Evidenca 45: Shembull aplikimi praktike; Evidenca 76: Marrëveshje bashkëpunimi me biznese dhe institucione.</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Kurrikula e programit të studimit “Bachelor në Financë-Kontabilitet” ka si qëllim kryesor formimin profesional të studentëve me njohuri të thelluara në fushat e financës dhe kontabilitetit. Gjatë ciklit të studimeve, studentët fitojnë gjithashtu njohuri dhe kompetenca edhe në fusha të tjera ndërdisiplinore, të cilat kontribuojnë në zhvillimin e aftësive të tyre të përgjithshme dhe profesionale. Këto fusha përfshijnë:

	✓ Shkencat humane, përmes lëndëve si <i>Gjuha e huaj dhe E drejta e biznesit</i>; ✓ Komunikimin, me lëndë si <i>Komunikimi organizativ</i>; ✓ Teknologjinë e informacionit, përmes lëndëve si <i>Sistemet e informacionit dhe të komunikimit, E-commerce, Hyrje në algoritme dhe programim</i>, si dhe <i>Siguria e të dhënave</i>. Si në përmbajtjen e kurrikulës, ashtu edhe në praktikat institucionale të mësimdhënies, është vërejtur se përdorimi i teknologjisë është gjithnjë e më i pranishëm në procesin mësimor. Për shembull, në lëndën <i>Ekonometri</i> përdoret programi Stata për analiza statistikore, çka dëshmon për integrimin e mjeteve teknologjike moderne në arsimimin universitar. Evidenca 29: Kurrikula - Bachelor në Financë Kontabilitet.
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	Në syllabuset e lëndëve të programit të studimit Bachelor në "Financë-Kontabilitet" është parashikuar që ora e parë e mësimit t'i kushtohet prezantimit të programit të lëndës. Gjatë kësaj ore, studentët njihen me qëllimet e lëndës, aftësitë dhe kompetencat që pritet të fitojnë, si dhe me detyrimet e tyre akademike dhe mënyrën e vlerësimit, të cilat më pas pasqyrohen edhe në sistemin BIS. Në orën e fundit të mësimit parashikohet prezantimi i projekteve, detyrave të kursit dhe përsëritja e njohurive, me qëllim përmbledhjen e koncepteve thelbësore dhe realizimin e ushtrimeve përmbledhëse, përmes të cilave studentët kanë mundësi të testojnë njohuritë e tyre përpara zhvillimit të provimit përfundimtar. Në KU Bedër, pas përfundimit të çdo lënde, studentët realizojnë një vlerësim të cilësisë së mësimdhënies, me qëllim identifikimin e aspekteve për përmirësim dhe rritjen e cilësisë së procesit mësimor në të ardhmen. Evidenca 34: Anketa e studentit ndaj lëndës; Evidenca 40: Syllabuset e Lëndëve.
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e	Syllabuset e lëndëve të programit të studimit "Bachelor në Financë-Kontabilitet" janë hartuar duke kombinuar orët teorike në auditor me orë praktike si seminare dhe laboratorë, me qëllim zhvillimin e kompetencave profesionale të studentëve. Kompetencat që synohen në çdo lëndë janë të paraqitura qartë në secilin syllabus. Në shumë lëndë, studentët përgatitin projekte apo detyra kursi në grup, për të nxitur punën në ekip, shkëmbimin e ideve dhe diskutimin kritik të tyre. Stafi akademik i përfshirë në programin e studimit, siç u konfirmua edhe gjatë takimeve në institucion, inkurajon dhe mbështet studentët që të përfshihen në projekte kërkimore dhe praktike, në të cilat janë të angazhuar edhe vetë anëtarët e stafit. Studentët janë gjithashtu të nxitur të marrin pjesë në konferenca shkencore studentore, si dhe në mobilitete me institucione partnere, në kuadër të programit Erasmus+. Kjo shërben si një mënyrë për të rritur kapacitetet kërkimore dhe për të nxitur ide inovative tek studentët. Institucioni ofron mbështetjen e nevojshme infrastrukturore për zhvillimin efektiv të procesit mësimor dhe kërkimit, duke përfshirë:

mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	• Akses në laboratorë kompjuterikë; • Akses në bibliotekën e universitetit; • Akses në databazën akademike JSTOR për kërkime shkencore; Marrëveshjet bashkëpunimi me institucione dhe biznese që lidhen me fushën e programit, mundësojnë aktivitete të përbashkëta dhe realizimin e praktikave mësimore nga studentët. <i>GVJ në dokumentacionin e dorëzuar, nuk gjen informacion në lidhje me përfshirjen e studentëve të këtij programi studimi në konferenca shkencore studentore.</i> <i>Evidenca 40: Sylabuset e Lëndëve; Evidenca 76: Marrëveshje bashkëpunimi me biznese dhe institucione, Evidenca 81: Infrastruktura e auditorëve, laboratorëve dhe Bibliotekës në KU Bedër; Evidenca 104: Shkëmbi i studentëve;</i> <i>https://ecobus.beder.edu.al/sh/news/activities/transformimi-dixhital-ne-kohen-e-sfidave-3/1967.</i>
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit, bazuar në analizën e pyetësorëve të vetëvlerësimit në fillim të çdo viti akademik, në kuadër të përmirësimit të procesit mësimor dhe mbështetjes së stafit akademik për zhvillim profesional dhe kualifikim shkencor, harton një plan aktiviteteesh, i cili përfshin: ✓ Leksione të hapura; ✓ Seminare trajnuese; ✓ Workshope, konferenca dhe aktivitete të ngjashme akademike. Në këto aktivitete marrin pjesë stafi akademik me kohë të plotë dhe me kontratë, si dhe specialistë të ftuar nga fusha përkatëse, përfshirë pedagogë e kërkues shkencorë nga universitete brenda dhe jashtë vendit. Nga takimi i zhvilluar në institucion, u konstatua se stafi akademik vlerëson mbështetjen që po ofron institucioni për të përmirësuar cilësinë e kërkimit shkencor. Kjo mbështetje përfshin orientimin e stafit drejt botimeve në revista të indeksuara në Scopus apo Web of Science, me qëllim rritjen e cilësisë dhe ndikimit të punës kërkimore. <i>Evidenca 67: Raporti Vjetor i Departamentit të Ekonomisë dhe Biznesit 2023-2024; Evidenca 70: Plani i aktiviteteve për vitin akademik 2024-2025</i> <i>https://ecobus.beder.edu.al/sh/news/activities_list/.</i>
Konkluzione	<i>Programi i studimit “Bachelor në Financë-Kontabilitet” synon t’u ofrojë studentëve njohuri teorike dhe praktike në fushat e financës dhe kontabilitetit, si dhe njohuri ndërdisiplinore që kontribuojnë në zhvillimin e aftësive të tyre profesionale, në përputhje me nivelin e parashikuar për ciklin e parë të studimeve.</i> <i>Syllabuset përmbajnë të detajuara kompetencat që studentët pritet të fitojnë, si dhe gjithë informacionin e nevojshëm për ndjekjen e suksesshme të lëndëve.</i> <i>Institucioni ofron infrastrukurën e nevojshme, jo vetëm për zhvillimin e një procesi mësimor cilësor, por edhe për mbështetjen e kërkimit shkencor dhe nxitjen e ideve inovative.</i> <i>Stafi akademik mbështetet nga institucioni në drejtim të zhvillimit profesional dhe akademik, çka reflektohet edhe në mbështetjen që u</i>





	ofrohet studentëve për të zhvilluar më tej aftësitë e tyre profesionale dhe mendimin kritik. Kjo realizohet përmes përfshirjes së tyre në aktivitete akademike dhe programe shkëmbimi brenda dhe jashtë vendit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	Në Universitetin "Bedër", procesi i diplomimit rregullohet përmes një grupi dokumentesh zyrtare që përfshijnë: ✓ Rregulloren Themelore të institucionit; ✓ Rregulloren e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë; ✓ Rregulloren e programit të studimit "Bachelor në Financë-Kontabilitet"; ✓ Manualin për përgatitjen e tezës së diplomës dhe kriteret e vlerësimit të saj për studentët e ciklit të parë; ✓ Syllabusin e lëndës "Punim diplome". Studenti ka mundësi të përmbyllë detyrimet e tij akademike në një nga dy mënyra: ✓ Me provim përfundimtar të përgjithshëm, ose ✓ Me tezë diplome, nëse ka përmbushur kriterin minimal të mesatares së akumuluar (≥ 3.00). Punimi i diplomës është i parashikuar si lëndë e semestrit të gjashtë në programin mësimor të ciklit të parë. Manuali për përgatitjen e tezës është i aksesueshëm në faqen zyrtare të institucionit, duke mundësuar informimin e studentëve mbi strukturën, kërkesat, afatet dhe kriteret e vlerësimit të punimit të diplomës. <i>GVJ konstaton se manuali për përgatitjen e tezës së diplomës dhe kriteret e vlerësimit të tezës për studentët e ciklit të parë, në listën e dokumentacionit të përcjellë ishte në gjuhën angleze dhe duhet të paraqitet edhe në gjuhën shqipe.</i> <i>Evidenca 3: Rregullorja Themelore; Evidenca 6: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë; Evidenca 35: Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në "Financë-Kontabilitet; Evidenca 60: Manuali për përgatitjen e tezës së diplomës dhe kriteret e vlerësimit të tezës për studentët e ciklit të parë.</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe	Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit është përgjegjës për përcaktimin e mënyrës së përmbylljes së detyrimeve përfundimtare nga ana e studentëve, si dhe për organizimin dhe bashkërendimin e të gjithë procesit të diplomimit. Në rast se studenti zgjedh të përmbyllë studimet me tezë diplome, atij i caktohet një pedagog udhëheqës, i cili e mbështet gjatë gjithë fazës së

materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	punimit përmes asistencës akademike, ofrimit të materialeve ndihmëse dhe udhëzimeve për realizimin e një punimi cilësor. Në përfundim, pedagogu udhëheqës jep konfirmimin për mbrojtjen e tezës përpara jurisë. Juria vepron si një komision vlerësues që shqyrton dhe vlerëson punimin në përputhje me kriteret e përcaktuara. Në rastin kur studenti zgjedh të përmbyllë studimet me provim përfundimtar, Departamenti ka përcaktuar lëndët që do të përfshihen në këtë provim, si dhe u vë në dispozicion studentëve materiale ndihmëse dhe modele testesh, për të lehtësuar përgatitjen e tyre. Evidenca 6: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë; Evidenca 35: Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në "Financë-Kontabilitet; Evidenca 60: Manuali për përgatitjen e tezës së diplomës dhe kriteret e vlerësimit të tezës për studentët e ciklit të parë; Evidenca 105: Lëndët që do të përfshihen në provimin përfundimtar, Programi Bachelor në "Financë Kontabilitet".
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Këshilli i Departamentit të Ekonomisë dhe Biznesit, para fillimit të semestrit të gjashtë, ngre një komision të posaçëm për administrimin e provimit përfundimtar. Kjo veprimtari reflektohet në ngarkesën mësimore të stafit dhe më pas miratohet në nivel fakulteti dhe senati. Në dokumentacionin e dorëzuar për programin e studimit "Bachelor në Financë-Kontabilitet", janë të pasqyruara lëndët që përfshihen në provimin përfundimtar: ✓ Hyrje në Financë ✓ Hyrje në Kontabilitet ✓ Drejtim Financiar <i>Megjithatë, GVJ konstaton se në dokumentacionin e dorëzuar nuk është e qartë ndarja e peshës specifike që mban secila lëndë në strukturën e provimit përfundimtar, dhe gjithashtu mungon një dokument zyrtar që të përshkruajë në mënyrë të detajuar temat apo përmbajtjen që do të përfshihet në testim, ndonëse kjo u kërkuar gjatë takimit në institucion.</i> Evidenca 105: Lëndët që do të përfshihen në provimin përfundimtar, Programi Bachelor në "Financë Kontabilitet".
Kriteri 4. Personeli akademik/Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse	Në KU "Bedër" përzgjedhja e temës së diplomës është një proces që trajtohet me seriozitet dhe zhvillohet në bashkëpunim të ngushtë mes departamentit dhe studentëve. Diskutimi përfshin si përzgjedhjen e temës, ashtu edhe caktimin e pedagogut udhëheqës. Departamenti shqyrton kërkesat e studentëve lidhur me temat e propozuara, me qëllim që ato të jenë në përputhje me fushën e programit të studimit si dhe me profilin akademik dhe profesional të udhëheqësit të propozuar. Pedagogu udhëheqës luan një rol kyç gjatë gjithë procesit të përgatitjes së temës së diplomës. Ai orienton studentin jo vetëm për zgjedhjen dhe përmbajtjen e temës, por edhe për përdorimin e literaturës së përshtatshme dhe formës së punimit në përputhje me manualin institucional. Studenti dhe udhëheqësi i temës bashkëpunojnë ngushtësisht në të gjitha fazat e punës, duke përfshirë: ✓ Përcaktimin e objektivit dhe hipotezës së punimit;




punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	✓ Hartimin e instrumenteve të kërkimit (si p.sh. pyetësorët për mbledhjen e të dhënave sasiorë); ✓ Përzgjedhjen dhe analizën e literaturës relevante; ✓ Ndërtimin e strukturës së punimit, sipas udhëzimeve të manualit për përgatitjen e tezës; ✓ Analizën dhe interpretimin e rezultateve. Pedagogu udhëheqës është gjithashtu përgjegjës për të vlerësuar përgatitjen përfundimtare të temës dhe për të dhënë konfirmimin zyrtar që punimi është gati për t'u paraqitur përpara komisionit të diplomimit. Evidenca 60: Manuali për përgatitjen e tezës së diplomës dhe kriteret e vlerësimit të tezës për studentët e ciklit të parë; Evidenca 90: Formulari i vlerësimit të tezës.
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit asiston studentët gjatë gjithë procesit të përgatitjes së diplomës, duke ofruar mbështetje në disa drejtime të rëndësishme: ❖ Mbështetje akademike dhe shkencore nga pedagogu udhëheqës; ❖ Mbështetje infrastrukturore, përmes: ✓ Përdorimit të laboratorëve të pajisur me programe softuerike të nevojshme; ✓ Aksesit në bibliotekën fizike dhe online, përfshirë databazën JSTOR dhe burime të tjera të literaturës shkencore; ✓ Shërbimeve të IT-së për asistencë teknike dhe akses në platforma digjitale; ✓ Akses në revista shkencore dhe materiale të specializuara. Gjatë periudhës së provimeve dhe sezonit të diplomimeve, laboratorët dhe biblioteka e fakultetit janë të hapura edhe gjatë fundjavave, për të garantuar që studentët të kenë mundësi të plota për përgatitje dhe hulumtim. Evidenca 81: Infrastruktura e auditorëve, laboratorëve dhe Bibliotekës në KU Bedër.
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Komisioni i vlerësimit të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të punimit të diplomës miratohet nga Këshilli i Departamentit që ofron programin e studimit. Komisioni përbëhet nga jo më pak se tre anëtarë, të cilët janë specialistë të fushës përkatëse. ✓ Provimi përfundimtar i përgjithshëm realizohet me shkrim dhe vlerësohet me notë, njësoj si lëndët e tjera të programit. ✓ Punimi i diplomës prezantohet dhe mbrohet gojarisht përpara komisionit, i cili gjithashtu e vlerëson atë me notë përfundimtare. Të gjitha notat përfundimtare arkivohen pranë koordinatores së departamentit dhe regjistrohen në sistemin BIS, në profilin personal të secilit student, si pjesë e listës së notave. Evidenca 6: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë




Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve, studenti që ka përmbyshur të gjitha detyrimet e parashikuara në programin e studimit, në përputhje me Niveli 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, pajiset me diplomën “Bachelor në Financë-Kontabilitet”, lëshuar nga Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit në Kolegjin Universitar “Bedër”. Programi i zhvilluar, së bashku me strukturën mësimore dhe përmbajtjen akademike, është i aksesueshëm për studentët në çdo moment përmes sistemit interaktiv BIS, gjatë gjithë kohës që ata janë të regjistruar në institucion. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën përfundimtare dhe listën zyrtare të notave. Me kërkesë të studentit, institucioni lëshon gjithashtu një kopje zyrtare, të vulosur, të programit të plotë të studimit të ndjekur, përfshirë syllabuset dhe dokumentacion tjetër mbështetës, të nevojshëm për aplikime të mëtejshme akademike ose profesionale. <i>(Evidenca 6: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të pare)</i>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, si edhe nga vizita në institucion, GVJ konstaton se Kolegji Universitar “Bedër”, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe duke respektuar rregulloret e brendshme institucionale, ruan dhe përpunon të dhënat personale të studentëve në mënyrë të sigurt dhe të strukturuar. Zyra e Regjistrimit dhe Arkiva e KU “Bedër” ruan për një kohë të pacaktuar dokumentacionin që lidhet me performancën akademike dhe diplomimin e studentëve, duke përfshirë: ✓ Dosjen personale të studentit; ✓ Regjistrin themeltar të studentëve; ✓ Regjistrin e arritjeve akademike; ✓ Regjistrin e diplomave të lëshuara. Në raste të kërkesave specifike nga ana e studentëve, institucioni lëshon vërtetime zyrtare që dëshmojnë ecurinë e tyre në programin e studimit, në përputhje me Rregulloren e Arkivës. Evidenca 3: Rregullorja Themelore; Evidenca 9: Rregullorja e Arkivës; Evidenca 18: Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore
Konkluzione	<i>Kolegji Universitar “Bedër” e ka të përcaktuar në Rregulloren e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Parë procedurën për përmbyshjen e detyrimeve përfundimtare të studentëve. Këto detyrime mund të realizohen ose përmes një provimi përfundimtar, ose përmes mbrojtjes së tezës së diplomës, nëse studenti plotëson kriterin minimal të notës mesatare të parashikuar nga rregullorja. Në të dyja rastet, vlerësimi përfundimtar bëhet me notë, njësoj si për të gjitha lëndët e tjera të programit.</i> <i>Stafi akademik mbështet studentët gjatë gjithë procesit të përgatitjes së temave të diplomës, duke i asistuar në çdo komponent të punimit. Institucioni, gjithashtu, u vë në dispozicion studentëve gjithë infrastrukturën e nevojshme, për të siguruar një realizim cilësor të procesit të diplomimit.</i>

	Në përfundim të studimeve dhe pasi studenti të ketë përmbushur të gjitha detyrimet akademike, ai pajiset me diplomën "Bachelor në Financë-Kontabilitet". Institucioni ruan të dhënat që lidhen me ecurinë e studentëve, duke respektuar legjislacionin në fuqi dhe rregulloret e brendshme institucionale, në veçanti ato që lidhen me mbrojtjen e të dhënave personale dhe arkivimin e dokumentacionit akademik. GVJ konstaton se, në lidhje me programin e studimit "Bachelor në Financë-Kontabilitet", Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit nuk disponon dokumentacion të plotë për: ✓ Shpërndarjen e pikëve për secilën nga tre lëndët që përfshihen në provimin përfundimtar; ✓ Një dokument udhëzues zyrtar për temat e mundshme të provimit apo të diplomës; ✓ Model testi apo strukturë orientuese për përgatitjen e studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën	GVJ pasi shqyrtoi dhe analizoi dokumentacionin e Dosjes së Vetëvlerësimit (DVV) për Programin e studimit, të ciklit të parë Bachelor në "Financë Kontabilitet" në Kolegjin Universitar "Bedër", konstaton se ky program studimi realizohet nga personel akademik i kualifikuar, i cili përmbush kriteret e LAL 80/2015. Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit , pjesë e Fakultetit të Teknologjisë dhe Biznesit . Struktura e personelit akademik në Departamentin që ofrohet ky program studimi për vitet akademike 2022-2023; 2023-2024; 2024-2025 përfshin pedagogë në kategorinë e Profesorit të Asociuar, pedagogë me gradën "Doktor i Shkencave" dhe pedagogë me gradën "Master i Shkencave". Ky personel përfshin akademikë të punësuar me kohë të plotë dhe të pjesshme, të cilët janë zgjedhur bazuar në nivelin e tyre të kualifikimit akademik dhe specializimin në fushat përkatëse. Ngarkesa mësimore e

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@ascal.al

praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

shpërndarë në këtë program është kryer në përputhje me fushat kërkimore dhe te specialitetit të secilit anëtar të stafit akademik. GVJ konstaton se për personelin akademik pranë Kolegjit Universitar Bedër, ndiqen praktika punësimi në përputhje me kategorizimin e tyre akademik, siç përcaktohet nga LAL 80/2015 dhe rregulloret e tjera të posacme.

Pas takimit që GVJ pati në Kolegjin Universitar Bedër, u konstatua se stafi akademik gëzonte qëndrueshmëri të lartë përgjatë viteve. Pjesa dominuese e lektorëve në këtë program për të tre vitet akademike ishin Msc.

Kualifikimi i stafit akademik për Departamentin e Ekonomisë dhe Biznesit	2022-2023		2023-2024		2024-2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	0	0	0	0	0	0
Prof. Asoc.	1	0	1	0	0	0
Dr./PhD.	2	1	2	1	5	2
Msc.	5	1	4	6	4	6
Totali	8	2	7	7	9	8

Për sa i përket kualifikimeve të Personelit Akademik:

1. Për viti akademik 2022-2023, 40% e stafit akademik (PAE&PAK) kanë gradë shkencore/tituj akademik, 60% janë me Msc;
2. Për vitin akademik 2023-2024, 29% e stafit akademik (PAE&PAK) kanë gradë shkencore/tituj akademik, 71% janë me Msc;
3. Për vitin akademik 2024-2025, 41% e stafit akademik (PAE&PAK) kanë gradë shkencore/tituj akademik, 59% janë me Msc;

Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit, për programin e studimit angazhon staf efektiv dhe me kontratë sipas raportit (PAE/PAK) për ngarkesën mësimore (orë në auditor):

- Viti akademik 2022-2023, 90%, PAE dhe 10%PAK;
- Viti akademik 2023-2024, 70%, PAE dhe 30%PAK;
- Viti akademik 2024-2025, 85%, PAE dhe 15%.PAK;

GVJ në dokumentacionin e dorëzuar për ngarkesën mësimore PAE/PAK nuk e ka të qartë se si ndahen orët mësimore kur lëndën e zhvillojnë dy pedagogë, megjithëse gjatë takimin në institucion u kërkuar plotësimi i tabelën së ngarkesës së plotë për të dy kategoritë. Tabelat në shtojcë

	6.1-6.3 dhe tabela 7 nuk kanë të pasqyruar të njëjtën shpërndarje të stafit, ndaj kërkohet një verifikim i saktë i tyre. Shtojca: Tabela nr. 7: Të dhënat përmbledhëse të stafit akademik për programin e studimit, sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre Evidenca 54: CV-të e stafit akademik Shtojca: Tabela nr.1 dhe nr. 2: Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë: Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat; Personeli Akademik dhe Administrativ (PNA dhe PA)
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Nga takimi i realizuar që GVJ realizoi me përgjegjësin e Departamentit të Ekonomisë dhe Biznesit dhe Personelin Akademik, rezulton se i gjithë stafi akademik i angazhuar në programin e studimit Bachelor në "Financë Kontabilitet" ka përputhje me fushat akademike-kërkimore të përgjithshme dhe specifike dhe me objektivat e programit të studimit. Ngarkesa mësimore e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit është e balancuar duke përmbytur në mënyrë efektive kornizën ligjore në fuqi. Personeli akademik efektiv mbulon ngarkesën mësimore për programin e studimit Bachelor në "Financë Kontabilitet" në më shumë se 70% të orëve në auditor duke plotësuar kornizën ligjore në fuqi. Mbështetur në kurrikën e programit të studimit, GVJ sugjeron se lëndët si Hyrje në Kontabilitet, Kontabilitet Financiar dhe Financa Publike, të cilat zhvillohen përgjatë vitit të parë të shpërndahen në vitet e tjera të programit të studimit. Gjithashtu, lënda e Financës Ndërkombëtare e cila zhvillohet në semestrin e parë të vitit të dytë të zhvillohet pas lëndës Drejtim Financiar e cila zhvillohet në semestrin e dytë të vitit të dytë, në mënyrë që formimi cilësor i dijeve të ndjekë një rrjedhë përplotësuese në lëndët përkatëse. Shtojca: Tabela nr.4: Ngarkesa totale e personelit akademik të programit Financë Kontabilitet për një vit akademik Shtojca: Tabela nr. 12: Plani mësimor i lidhur me personelin akademi përkatës Evidenca 29. Kurrikula - Bachelor në Financë Kontabilitet.pdf
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Referuar shqyrtimit të dokumentacionit, takimeve me stafin akademik, departamentin e Ekonomisë dhe Biznesit dhe zyrën e Burimeve Njerëzore, GVJ konstaton se personeli akademik në këtë program studimi ka qëndrueshmëri e jetëgjatësi në angazhimin e tij në procesin mësimor në KU "Bedër". Disa pjestarë të stafit akademik efektiv kishin gati 10 vite punësimi në këtë institucion. U konstatua se kontratat e punës janë "pa afat" dhe "afat 1 vjeçar". Ky diferencim lidhet me kohëzgjatjen e angazhimit të stafit në institucion dhe gradës/titullit akademik. Afati paralajmërues përpara largimit nga vendi i punës ishte 1 muaj përpara për stafin efektiv Msc. dhe 3 muaj përpara për stafin efektiv me gradë/titull akademik.

	Gjatë vizitës në institucion, stafi akademik konfirmoi mbështetjen e institucionit për të nxitur dhe inkurajuar stafin akademik në pjesëmarrje në projekte dhe analiza me karakter kërkimor shkencor. <i>Shtojca: Tabela nr. 12: Plani mësimor me personelin akademik përkatës</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Nga vizita në institucion dhe takimi me Zyrën e Burimeve Njerëzore, dokumentacionin e GVB, dokumentat rregullative dhe Statutin e Kolegjit Universitar Bedër, dosjet e stafit akademik në zyrën e burimeve njerëzore dhe Rregulloren e Themelore për procedurat e rekrutimit të stafit akademik, GVJ konstaton se procedura e rekrutimit të stafit akademik është në përputhje me synimet e institucionit dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit. Bazuar në Nenin 61, të Statutit të Kolegjit Universitar Bedër, kriteret e punësimit të personelit akademik me kohë të plotë përcaktohen nga njësia bazë bazuar në nevojat e kësaj të fundit, pas pëlqimit nga dekani dhe miratimit nga rektori. Përzgjedhja e kandidatëve bëhet nga një komision ad-hoc, i cili bën renditjen e kandidatëve dhe ia propozon rektorit për emërimin me kohë të plotë të punonjësve. GVJ verifikoi dy dosje në mënyrë rastësore të personelit akademik (një staf efektiv dhe një staf me kontratë) në zyrën e Burimeve Njerëzore, ku rezultoi se në brendësi ndodhej i gjithë dokumentacioni përkatës (përmbajtja e dosjes, CV, fotokopja e kartës ID, dëshmi penaliteti, fotokopje e diplomave, lista notave, gradave, titujve të noterizuar, fotokopje të certifikatave, fotokopja e librezës sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, leja nga punëdhënësi për personelin akademik me kontratë, kontrata e punës, kualifikime të tjera etj.) <i>Evidenca nr.1: Statuti i Kolegjit Universitar Bedër</i> <i>Evidenca nr.3: Rregullorja Themelore</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	GVJ, referuar dosjes së programit të studimit Bachelor në “Financë Kontabilitet”, konstaton se Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit, si njësi kryesore ka në përbërjen e tij personel ndihmës akademik me karakter mësimor dhe administrativ. Kjo specifikohet qartësisht në nenin 63 të Statutit të Kolegjit Universitar “Bedër” dhe në nenin 9 të Rregullores mbi Organizimin Administrativ. Ky personel ndihmës ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe/ose kërkimit shkencor, në realizimin e praktikave mësimore si dhe kujdeset për mirëmbajtjen e bibliotekës dhe pajisjeve të tjera. Këtu përfshihen laborantët, teknikët etj., sipas përcaktimeve të bëra në aktet e brendshme të institucionit të cilët bëjnë pjesë në stafin e njësisë bazë. Referuar Evidenca ve të vëna në dispozicion, kontatohet se përgjatë vitit akademik 2022-2023 nuk evidentohet asnjë personel ndihmës akademik, ndërsa në dy vitet e tjera 2023-2024 dhe 2024-2025 evidentohet një personel. <i>Evidenca nr.1: Statuti i Kolegjit Universitar Bedër</i> <i>Evidenca 11. Rregullorja mbi Organizimin Administrativ</i>

	<i>Shtojca: Tabela nr.1 dhe nr. 2: Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë: Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat; Personeli Akademik dhe Administrativ (PNA dhe PA)</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	GVJ pas konsultimit me Rregulloren e Institucionit, Formatin e Dosjes personale të Stafit Akademik, si dhe vizitës së kryer në Zyrën e Burimeve Njerëzore, konstaton se kjo zyrë disponon dosjet e plota për të gjithë stafin akademik dhe personelit administrativ të institucionit. Nga vizita që GVJ bëri në Zyrën e Burimeve Njerëzore u verifikua që pas përzgjedhjes rastësore të dy dosjeve të stafit akademik dokumentacioni shoqëruar në këto dosje ishte i plotë. <i>Shtojca: Tabela nr.1 dhe nr. 2: Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë: Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat; Personeli Akademik dhe Administrativ (PNA dhe PA)</i> <i>Evidenca 29. Kurrikula - Bachelor në Financë Kontabilitet.pdf</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	GVJ nga verifikimi i dokumentacionit konstaton se, Kolegji Universitar Bedër ka realizuar një sërë bashkëpunimesh me IAL brenda vendit por dhe me partner të huaj më kryesisht në kuadër të marrëveshjeve të mobilitetit Erasmus +. Në kuadër të mbështetjes së programit dhe mundësimin e kryerjes së praktikës mësimore apo përgatitjen e mikrotezës, KU "Bedër" ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike dhe biznese private të cilat janë pothuajse të gjitha brenda vendit. Nëpërmjet këtyre marrëveshjeve, KU "Bedër" siguron personelin e kualifikuar për të udhëhequr dhe mbikëqyrur praktikat profesionale dhe punimet e diplomave për studentët e këtij program studimi. Praktikrat profesionale zhvillohen në institucion/kompani sipas profilit të përgatitjes së studentit dhe nën drejtimin e stafit akademik të caktuar nga Departamenti. <i>Evidenca 25. Marrëveshje mobiliteti Erasmus +</i> <i>Shtojca: Tabela nr.5: Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese në rang Programi/esh studimi për Praktikrat profesionale me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë</i> <i>Evidenca 35. Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Financë Kontabilitet</i> <i>Evidenca 55. Procedura e praktikës profesionale</i> <i>Evidenca 76. Marrëveshje bashkëpunimi me biznese dhe institucione</i>

Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Referuar programit mësimor Bachelor në “Financë Kontabilitet”, praktika profesionale është pjesë përbërëse e planit mësimor e kategorizuar si lëndë e formimit plotësues që zhvillohet në përfundim të të gjitha lëndëve mësimore për tre vitet e studimit dhe vlerësohet me notë prej 4 ECT dhe me një ngarkesë prej 100 orësh. KU “Bedër” në kuadër të planifikimit të karrierës pranë cdo departamenti cakton një përfaqësues i cili orienton studentët në gjetjen dhe përcaktimin e një vendi të përshtatshëm për realizimin e praktikës profesionale. Departamenti bën ndarjen e studentëve në institucionet/bizneset pritëse për kryerjen e praktikave mësimore dhe realizimi i saj është i detyrueshëm nga ana e studentëve. Kryesisht kryerja bëhet në institucionet/bizneset publike/private që Kolegji Universitar Bedër ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi nën ndjekjen e një pedagogu të përcaktuar nga Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit. Në përfundim të praktikës, përfaqësuesi i zgjedhur kooperon me mbikëqyrësin në ambientin pritës ku zhvillohet praktika dhe përgatit me shkrim vlerësimin e Raportit të Praktikës Profesionale. <i>Evidenca 29. Kurrikula - Bachelor në Financë Kontabilitet.</i> <i>Evidenca 61. Vendimi i Këshillit të Departamentit për caktimin e përfaqësuesit pranë Zyrës së Planifikimit të Karrierës</i> <i>Evidenca 55. Procedura e praktikës profesionale</i> <i>Evidenca 76. Marrëveshje bashkëpunimi me biznese dhe institucione</i> <i>Evidenca 45. Shembull aplikimi praktike</i>			
Konkluzione	GVJ pas verifikimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe vizitës në institucion së bashku dhe me takimet me stafin akademik të angazhuar në programin e aplikuar për akreditim, konkludon se: - Fusha akademike-kërkimore e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit Bachelor në “Financë Kontabilitet”, janë në përputhje me natyrën dhe specifikat e programit të studimit. - Stafi akademik gëzonte qëndrueshmëri të lartë duke patur lëvizje të ulta brenda një viti akademik. - Procedura e rekrutimit të stafit akademik, është në përputhje me objektivat e institucionit dhe programin e studimit aplikuar për akreditim. - Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike dhe biznese private që sigurojnë mbarëvajtjen e zhvillimit të praktikës profesionale.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të	Mbështetur në të dhënat e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm Periodik, të dhënave për infrastrukturën dhe vizitën në institucion, GVJ

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43123

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	konstaton se KU “Bedër” disponon hapësira të përshtatshme dhe të mjaftueshme për zhvillimin e procesit mësimor të programit të studimit Bachelor në “Financë Kontabilitet”. KU “Bedër” disponon një sipërfaqe të shfrytëzueshme për stafin akademik prej 861,5 m2 dhe sipërfaqe për fakultetin përgjegjës për programin e studimit prej 2732,5 m2. Organizimi i brendshëm i hapësirës është i shpërndarë në dy godina: Në godinën A, e pozicionuar në hyrje të institucionit, përqendrohen ambientet e administratës, biblioteka, holli etj., dhe në godinën B janë të përqëndruara salat e mësimit dhe laboratorët. Ambientet përbëhen nga 17 klasa mësimi, 1 sallë konferencash, 4 laboratorë, 1 bibliotekë etj. Vlen të theksohet dhe prezenca e ambiente të tjera mbështetëse për aktivitetet argëtuese të studentëve si kafeteria, fusha e kalcetos dhe e volejbollit. Dy godinat e vendosur në funksion për zhvillimin e procesit mësimor është marrë me qera deri në Gusht 2025. Nga vizita në institucion, GVJ konstatoi se zyrat e stafit akademik dhe administrativ janë të pajisura me PC, dhe infrastrukturën e nevojshme. Sallat e mesimit (të leksioneve, seminareve, laboratorit informatikës, biblioteka), janë të pajisura me teknologjinë e mjaftueshme (PC, projektorë) që të garantohet zhvillimi i procesit mësimor sipas kërkesave. Shtojca: Tabela .16: Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Mbështetur në dokumentacionin e përcjellë nga GVB dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se Kolegji Universitar Bedër disponon infrastrukturën e nevojshme (klasa, laboratorë informatike, bibliotekë, zyra) të pajisura me mjete teknologjike për t’i shërbyer sa më mirë procesit mësimor dhe nevojave të studentëve. Sallat e leksioneve dhe laboratorit i informatikës janë të pajisur me kompjuter (PC) dhe projektorë. Të gjitha mjediset janë të pajisura me sistem ngrohje kondicioner dhe Wi-Fi i aksesueshëm për stafin dhe studentët. Një hapësirë e vecantë në KU “Bedër”, e emërtuar si News Room pjesë e Departamentit të Shkencave të Komunikimit, përbëhet nga kompjutera dhe tavolina leximi dhe mund të përdoret sipas nevojave nga departamentet e tjera. Evidenca 81. Infrastruktura e auditorëve, laboratorëve dhe Bibliotekës në KU Bedër
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, ateliët apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Mbështetur në informacionin e Dosjes së Vetëvlerësimit dhe RVB, gjithashtu dhe nga vizita e realizuar në mjediset e KU “Bedër”, rezultoi se në funksion të të gjithë programeve të studimit ishin në dispozicion 4 laborator të pajisur me kompjutera si dhe një bibliotekë bashkëkohore për studentët për realizuar nevojat e tyre arsimore. Në total institucioni vendos në dispozicion të të gjithë programeve të studimit 128 kompjutera për studentët në të cilët janë të instaluar të gjithë programet e nevojshme softwerike të shoqëruar me internet për stafin dhe studentët. Evidenca 81. Infrastruktura e auditorëve, laboratorëve dhe Bibliotekës në KU Bedër




Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Nga vizita e realizuar në ambientet e Kolegjit Universitar “Bedër”, rezulton se mjediset disponojnë katër laborator të pajisur me kompjutera dhe me programe softwerike të instaluar për të përmbushur nevojat e programit të studimit. <i>Shtojca: Tabela n.16: Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se KU “Bedër” nga pikëpamja infrastrukturore disponon mjedise të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor. - Zyrat e stafit akademik dhe administrativ janë të pajisura me kompjutera dhe mjetet e nevojshme për t’i shërbyer procesit mësimor. - Ambientet për zhvillimin e procesit mësimor (sallat e leksioneve, seminareve, laboratorit, etj.), janë të pajisura me kompjuter (PC), video-projektorë, internet, smart board. - Kolegji Universitar Bedër disponon katër laborator informatike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Bazuar në rregulloren e programit të studimit, GVJ konfirmon se, literatura bazë e përdorur në modulet e këtij programi studimi është gjuha angleze. Nga shqyrtimi i syllabuseve të këtij program studimi, konstatohet se literatura kryesore është gjuha angleze dhe ajo mbështetëse është gjuha shqipe dhe e huaj në funksion të marrjes së dijeve të nevojshme për studentët e këtij program studimi. Baza mësimore që u ofrohet studentëve në varësi të modulit, përfshin: tekste mësimore, cikle leksionesh, leksione në ppt, etj. Biblioteka e KU “Bedër” është njësi ndihmëse e institucionit dhe misioni i saj është të ofrojë mbështetje për procesin mësimor, edukativ, formimit profesional dhe veprimtarisë shkencore të përdoruesve të saj. GVJ pas vizitës në ambientet e KU “Bedër” verifikoi se biblioteka ishte në shërbim të studentëve dhe stafit akademik sipas rregullores së saj libra si në gjuhën shqipe dhe në atë angleze. Përzgjedhja e librave bëhet në bazë të kërkesave të cdo programi studimi që ofrohet në KU “Bedër” duke patur përputhshmëri me planet përkatëse mësimore. Gjithashtu, në kuadër të garantimit të marrjes së njohurive të duhura, biblioteka ofron dhe formën digjitale nëpërmjet platformës JSTOR. <i>Evidenca 40. Syllabuset e Lëndëve</i> <i>Evidenca 26. Marrëveshja për akses në JSTOR</i>

	Evidenca 37. Udhëzimi mbi funksionimin e Bibliotekës
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Nga verifikimi i dokumentacionit të projekt buxhetit për Kolegjin Universitar Bedër, GVJ konfirmon se në funksion të procesit të kërkimit shkencor dhe mësimdhënies parashikohen për secilin fakultet fonde të veçanta për pasurimin e bibliotekës me literaturë shtesë. <i>GVJ konstatoi mungesë në Evidenca lidhur me raportimin që njësia përgjegjëse duhet të bëjë për përditësime të literaturës sipas nevojave të departamentit.</i>
	Evidenca 79. Projekt buxheti i departamentit të Ekonomisë dhe Biznesit
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Nga vizita e GVJ në ambientet e KU "Bedër", konstatohet se institucioni disponon bibliotekën mësimore në shërbim të plotësimit të nevojave të studentëve dhe stafit akademik në funksion të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Mundësinë për të përfutur nga fondet e bibliotekës e kanë vetëm studentët dhe stafi akademik dhe administrative i KU "Bedër" duke paraqitur kartën e studentit apo kartën e personelit.
	Evidenca 37. Udhëzimi mbi funksionimin e Bibliotekës Shtojca: Tabela n.17: Të dhëna të plota për platformat on-line/ Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Nga vizita e GVJ në mjediset e KU "Bedër", konstatohet se biblioteka ishte funksionale në funksion të kërkimeve të studentëve, stafit akademik dhe administrativ. Bazuar në Rregulloren e Programit të Studimit, literatura bazë e përdorur në modulet e këtij programi studimi ofrohet në gjuhën angleze. Baza mësimore që u ofrohet studentëve, në vartësi të modulit, përfshin: tekste mësimore, cikle leksionesh, leksione në ppt, materiale në ëeb, etj. Referuar dokumentacionit shoqërues, biblioteka fizike ka një sipërfaqe prej 119 m2, disponon 22600 tituj shkencor, 26000 libra shkencorë, 166 monografi shkencore dhe 48 revista shkencore, si dhe shtatë PC dhe 24 poste leximi nga ku studentët mund të aksesojnë bibliotekën online për të gjitha programet e studimit. Nga verifikimi i dokumentacionit të projekt buxhetit për Departamentin e Ekonomisë dhe Biznesit në Kolegjin Universitar Bedër, u konfirmua se në funksion të procesit të kërkimit shkencor dhe mësimdhënies parashikohen për secilin fakultet fonde të veçanta për pasurimin e bibliotekës me literaturë shtesë. <i>GVJ, konstatoi se vlerat e parashikuara në rang departamenti për dy programe studimi për literaturë ishin relativisht të kufizuara.</i>
	Evidenca 37. Udhëzimi mbi funksionimin e Bibliotekës Shtojca: Tabela n.17: Të dhëna të plota për platformat on-line/ Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për	Të gjithë studentët dhe stafi akademik i KU "Bedër" ka akses të plotë dhe pa pagesë në bibliotekën dixhitale JSTOR. Aksesimi në këtë

studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	bibliotekë bëhet përmes emailit institucional për të gjithë pjestarët e KU "Bedër". Në rastin e programit të studimit Bachelor në "Financë Kontabilitet" i cili zhvillohet në gjuhën angleze, aksesit në këtë platformë ndihmon në përditësimin e vazhdueshëm të materialeve dhe informacioneve të vlefshme për procesin mësimor. Evidenca 26. Marrëveshja për akses në JSTOR Nga vizita e GVJ në mjediset e KU "Bedër", si dhe nga materialet e vendosura në dispozicion në DVV, u konstatua se në mjediset e bibliotekës fizike gjenden shtatë kompjutera të pajisur me programet softwerike që mundësojnë aksesimin e plotë online nga studentët, stafi akademik dhe administrativ sipas nevojave të tyre. Evidenca 37. Udhëzimi mbi funksionimin e Bibliotekës GVJ pas realizimit të takimit me studentët, stafet akademike dhe administrative, konfirmon që mësimi në programin Bachelor në "Financë Kontabilitet" zhvillohet nga ora 9.00 deri në orën 18:00, kjo në varësi të vitit akademik në këtë program. Në funksion të procesit mësimor shërben dhe biblioteka e cila qëndron e hapur nga ora 8:30 deri në orën 19:30 duke i dhënë mundësi studentëve të kenë akses të hapur në përputhje me nevojat e tyre. Ndërkohë në periudhë sezoni provimesh qëndron e hapur edhe gjatë fundjavës. GVJ, vlerëson edhe procesin e automatizimit të brendshëm institucional, i cili ofron ndihmë edhe në aspektin e kërkesave për literaturë apo regjistrim të studentëve. https://tt.beder.edu.al/
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët. Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Nga verifikimi i dokumentacionit të projekt buxhetit për Kolegjin Universitar Bedër, GVJ konfirmon se në funksion të procesit të kërkimit shkencor dhe mësimdhënies parashikohen për secilin fakultet fonde të veçanta për pasurimin e bibliotekës me literaturë shtesë. <i>Në dokumentacionin e përcjellë në DVV nuk ka informacion për shkallën e informatizimit të bibliotekës në raport me shfrytëzimin e fondit fizik dhe fondit online nga stafi akademik dhe studentët, performancës së përdoruesve të fondit të Bibliotekës dhe kërkesat për tituj.</i>
Konkluzione	GVJ pas vizitës në mjediset e KU "Bedër" dhe mbështetur në dokumentacionin e përcjellë konkludon se:

	- Projekt buxheti i Departamentit të Ekonomisë dhe Biznesit parashikon fonde për literaturë vendase dhe të huaj në funksion të procesit të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, por vlerat e parashikuara në rang departamenti për dy programe studimi ishin relativisht të kufizuara. - Orari i shfrytëzimit të bibliotekës është i përshtatshëm për studentët dhe pedagogët. - Biblioteka ka në fondin e saj mbi 22600 tituj shkencor për të dy fakultetet e KU "Bedër". - Studentëve dhe stafit akademik u ofrohet akses online në bibliotekën virtuale JSTOR. - Ka mungesë informacioni për shkallën e informatizimit të bibliotekës në raport me shfrytëzimin e fondit fizik dhe fondit online nga stafi akademik dhe studentët, performancës së përdoruesve të fondit të Bibliotekës dhe kërkesat për tituj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	GVJ pas verifikimeve gjatë vizitës në institucion dhe dokumentacionit shoqërues në DVV, konstaton se në KU "Bedër" funksionon Bedër Information System (BIS), një platformë elektronike e cila mundëson menaxhimin e brendshëm të informacionit i nevojshëm sipas kërkesave të institucionit. Cdo studenti në KU "Bedër" i jepet një email zyrtar i institucionit, përmes së cilit sigurohet aksesimi në BIS dhe sigurimi i nevojshëm i informacionit personal, për lëndët, vlerësimet, pjesëmarrjen në mësim etj. Gjithashtu në mbështetje të mbajtjes së informacionit janë funksional zyrat që lidhen me studentët që nga momenti i regjistrimit dhe deri në diplomim. Zyrat që u verifikuan ishin sekretaria mësimore, zyra e burimeve njerëzore, zyra e karrierës dhe jetës studentore etj. GVJ gjatë vizitës pranë sekretarisë mësimore në KU "Bedër" evidentoi regjistrat themeltar që mbahen për studentët e programit dhe verifikoi dy studentë rastësor të programit Bachelor "Financë Kontabilitet" nga viti i parë dhe i tretë i studimit. <i>Evidenca 24. Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS)</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit	GVJ nga vizita e realizuar në ambientet e KU "Bedër" si dhe mbështetje të DVV, konstatoi se sistemi informatik BIS ofron një menaxhim dhe qarkullim të mirë të informacionit brenda institucionit lidhur me gjurmimin e aktivitetit të personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në programin e studimit. Njësitë të cilat shkëmbejnë informacion brenda sistemit BIS përfshijnë: Zyrën e Sekretarisë

ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Mesimore, Zyrën e Financës, koordinatorët e departamenteve dhe fakulteteve, Zyrën e Burimeve Njerëzore, stafi akademik etj. Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi specifikisht se në Zyrën e Burimeve Njerëzore ndodhen të depozituara dosjet e plota të personelit akademik (me kohë të plotë dhe të pjesshme), personelit ndihmës akademik dhe personelit administrative. Në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore mbajtja e këtij informacioni është manualisht dhe elektronikisht. Evidenca 24. Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS)
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Nga vizita e GVJ në institucion dhe mbështetja në RVB, kontatohet se sistemi informatik BIS siguron një menaxhim cilësor të informacionit të brendshëm për të gjithë personelin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, si dhe studentët e programit të studimit. Stafi akademik dhe studentët mund të logohen me kredencialet e tyre për të patur një komunikim interaktiv. Vlen të theksohet që administrimi i informacionit në sistemin BIS ishte i vazhduar, ku studentëve u mundësohej regjistrimi në lëndët përkatëse për frekuentim dhe dhënie provimi, aksesimi në informacionin mbi aktivitetin e tyre akademik si: mungesat, projektet e kursit apo notat për cdo lëndë të programit të studimit. Për të rritur efikasitetin në kontrollin dhe drejtimin e studentëve, që në vitin e parë të studimeve secilit prej tyre u caktohet një këshilltar akademik, pjestar i stafit akademik në KU "Bedër". Evidenca 24. Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS)
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Pas vizitës së kryer dhe konsultimin me RVB, GVJ konstatoi se sistemi informatik BIS mundëson transferimin e përditësuar të të dhënave në cdo kohë midis njësive me njëra tjetren si dhe nga njësitë të studentët. Në shkëmbimin e informacionit interaktiv midis pedagogëve dhe studentëve përveç BIS, janë gjithashtu adresat e emaileve personale të hapura nga KU "Bedër", si dhe platforma Google Classroom. Evidenca 24. Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS) https://www.beder.edu.al/
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	GVJ konstatoi se një pikë e fortë manaxhimit të brendshëm të informacionit në mënyrë të integruar është funksionimi i sistemit informatik BIS. Ky sistem siguron raportimin dhe monitorimin në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrative, ku informacioni mbahet në një bazë të dhënash të centralizuar. BIS krijon mundësi raportimi të vazhdueshëm të informacionit personal të stafit akademik, të vijueshmërisë së aktivitetit akademik duke raportuar për frekuentimin e secilit student, detyrimet etj. Për të rritur efikasitetin e orientimit dhe kontrollit të studentëve, KU "Bedër" përcakton për secilin student një këshilltar akademik i cili ka akses në informacionin personal dhe akademik të studentëve të tyre. Evidenca 35. Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Financë Kontabilitet

Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Faqja zyrtare e KU "Bedër" është https://www.beder.edu.al/ dhe gjuha zyrtare e përdorur është shqip dhe anglisht. Në brendësi të faqes gjenden informacione për institucionin, për programet e studimit, konferencat, projektet, stafin akademik dhe administrative, për orarin mësimor, për bibliotekën, kërkimin shkencor etj. Informacioni bazik për Kolegjin Universitar Bedër përcillet edhe në social media si Facebook, Instagram etj. https://www.beder.edu.al/			
Konkluzione	GVJ pas vizitës në mjediset e KU "Bedër" dhe mbështetur në dokumentacionin e përcjellë konkludon se: - Funksionimi i sistemit informatik integral të informacionit BIS, është mjaft i rëndësishëm në sigurimin e një menaxhim cilësor të informacionit që mbahet në një bazë të dhënash të centralizuar. - Platforma teknologjike e KU "Bedër", ofron mbështetje në informacion dhe bashkëveprim interaktiv me studentët dhe stafin akademik. - Gjuha zyrtare e përdorur në faqen zyrtare të KU "Bedër" është shqip dhe anglisht. Informacioni i publikuar është i përditësuar dhe mbulon aspekte të rëndësishme të jetës akademike, studentore, kërkimore shkencore, sportive etj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	KU "Bedër" është një institucion i arsimit të lartë jofitimprurës dhe ku mbështetjen më të madhe e siguron nga fondacioni "Hafiz Ali Korca". GVJ duke u mbështetur në informacionet e përcjella në DVV, dhe më konkretisht në Raportin vjetor institucional, për vitin akademik 2022-2023, konstaton se performanca financiare e KU "Bedër" paraqitet e qëndrueshme dhe me rezultat pozitiv. Evidentohet që pjesa më e madhe e flukseve hyrëse sigurohet nga donacionet dhe tarifat e shkollimit. Pra, vlen të theksohet rëndësia e mbështetjes financiare nga fondacioni "Hafiz Ali Korca". Në kontekstin operativ të KU "Bedër" si institucion jofitimprurës, justifikohet edhe qëndrueshmëria financiare e saj. <i>Shtojca: Tabela n.18: Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit</i> <i>Evidenca 13. Raporti vjetor institucional, për vitin akademik 2022-2023</i>

Kriteri 2. Plani i financimit të njësishë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Duke u mbështetur në të dhënat e projekt buxhtit për vitin 2024-2025 për Departamentin e Ekonomisë dhe Biznesit, RVJ konstatoi se vlera monetare e zërave të parashikuar si shpenzime është disi e ulët. Shumë shpenzime të cilat janë në funksion të të gjithë institucionit, por që janë determinante në përcaktimin e qëndrueshmërisë së programit të studimit nuk rezultojnë në asnjë evidence, përveç se në raportin vjetor institucional 2022-2023. Ndërkohë pjesa e të ardhurave dominohet nga të ardhurat e tarifave të studentëve dhe donacionet. <i>Në funksion të mbështetjes financiare për mbarëvajtjen e programit të studimit, GVJ sugjeron se duhen vendosur objektiva nga KU "Bedër" për të shtuar mundësitë për të ardhura shtesë nga projektet dhe trajnimet.</i> <i>Evidenca 79. Projekt buxheti i departamentit të Ekonomisë dhe Biznesit.</i> <i>Shtojca: Tabela n.18: Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	GVJ duke kontrolluar të gjithë dokumentacionin e vendosur në ASCAL dhe në RVB, nuk gjeti asnjë dokument në plotësimin e këtij kriteri.
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësishë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	GVJ nuk evidentoi raportim të realizimit të buxhetit të miratuar të vitit paraardhës si rezultat i mungesave të lart përmendura.
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësishë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	GVJ mbështetur nga fakti se KU "Bedër" gëzon statusin e institucionit arsimor jofitimprurës dhe ka një mbështetje të kënaqshme financiare nga fondacioni "Hafiz Alli Korca, siguron premisa që të ketë qëndrueshmëri financiare në mbështetje të programit.




Konkluzione	GVJ konstaton se: - GVJ sugjeron se duhet një plan më i detajuar dhe real i kostove të programit, si dhe një plan strategjik më i mirë për të mbështetur financiarisht programin. - Në funksion të mbështetjes financiare për mbarëvajtjen e programit të studimit GVJ sugjeron se duhen vendosur objektiva nga KU "Bedër" për të shtuar mundësitë për të ardhura shtesë nga projektet dhe trajnimet.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Duke u konsultuar me informacionin në brendësi të dokumentave të DVV, GVJ konstaton se Kolegji Universitar Bedër ka të përcaktuara politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin e plotë të studentëve, që nga hyrja deri në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi. Mbështetur në Rregulloren e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë, parashirohen të gjitha çështjet që lidhen me ciklin e plotë akademik të studentëve, që nga hyrja deri në dalje. Sipas nenit 5 të kesaj rregulloreje dhe mbi reflektimet e kryera gjatë takimit me stafin drejtues, akademik dhe studentëve, u verifikua se pranimi i studentëve në KU "Bedër" mbështetej në kriterin e mesatares 70% dhe në kriterin e intervistës 30%. Gjithashtu kandidatët që aplikojnë në programet në gjuhë të huaj duhet të dorëzojnë certifikatën përkatëse të zotërimit të gjuhës së huaj të programit. Në nenin 9 të kesaj rregullore specifikohen transferimet ndërsa në nenin 11 sqarohet kohëzgjatja e arsimimit, forma dhe gjuha. Në nenin 28 specifikohet përfundimi i studimeve dhe diploma. Në funksion të implementimit të procedurave të mësipërme, KU Bedër ka hartuar Rregulloren Themelore dhe Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor në Financë Kontabilitet.
	Evidenca 6. Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë Evidenca 35. Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Financë Kontabilitet Evidenca 3. Rregullorja Themelore

Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Mbështetur në Statutin e Bedër në nenin 98, GVJ konstaton se institucioni garanton barazinë dhe mos diskriminim për të gjithë kandidatët për studentë dhe ata që ndjekin programin. Kriteret e pranimit për student të rinj zbatohen në mënyrë unanime dhe publikohen në faqen zyrtare të institucionit si dhe mund të aksesohen ne portalin U-Albania. KU "Bedër" ndjek politika favorizuese për studentët me rezultate të shkëlqyera të cilët mund të përfitojnë mbështetje financiare të studimeve të tyre deri në 100%. Gjithashtu ndiqen politika lehtësuese edhe për studentët me aftësi ndryshe e specifikuar në nenin 33 të Rregullores së studimeve dhe provimeve të ciklit të parë. <i>Evidenca 1. Statuti i Kolegjit Universitar Bedër</i> <i>Evidenca 6. Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë</i> <i>Evidenca 35. Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Financë Kontabilitet</i> <i>Evidenca 59. Miratimi i llojeve të zbritjeve të tarifave të studimit</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm duke u konsultuar me faqen zyrtare të internetit të Kolegjit Universitar "Bedër", konstatoi afishimin e kriterëve specifike të pranimit për secilin program të studimit. Këto kriteret janë të miratuara nga Senati sipas ligjit në fuqi të Arsimit të Lartë dhe udhëzimeve të MAS. Më konkretisht, ✓ Mesatarja aritmetike e shkollës së mesme (VKM), e cila përfshin edhe provimet e maturës, në vlerësimin për nxjerrjen e aplikantëve fitues zë masën 70 %. ✓ Intervista nga komisioni i vlerësimit, i formuar nga departamenti përkatës, zë masën 30 %. Gjithashtu, kriteret specifikojnë qartësisht edhe kriteret për studentët e huaj. Këshilli i Departamentit të Ekonomisë dhe Biznesit ngre komisione për kryerjen e intervistave dhe përzgjedhjen e kandidatëve fitues. <u>https://www.beder.edu.al/pranimet/kriteret-e-pranimit</u> <i>Evidenca 58. Vendim për ngritjen e komisionit për përzgjedhjen e studentëve fitues për programin Bachelor.</i>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	KU Bedër i ka të përcaktuara kriteret dhe procedurat e pranimit dhe transferimit të studentëve në rregulloret e brendshme të institucionit. Në faqen zyrtare të internetit të KU "Bedër", në rubrikën e kriterëve të pranimit gjendet i afishuar ky informacion për publikun e gjerë. Në përputhje me legjislacionin në fuqi, kuotat dhe procedurat e pranimit për çdo program studimi publikohen edhe ne U-Albania i aksesueshëm për të gjithë kandidatët për student. GVJ verifikoi si nga takimet në institucion bashkë me dokumentacionin e përcjellë në DVV se që në momentin e parë që kandidatët shpallen fitues në një nga programet e studimit në KU "Bedër" pajisen me një llogari personale për të aksesuar sistemin BIS. Informacioni i vazhduar i përfshirë në këtë platformë i vjen në ndihmë studentëve për të vlerësuar progresin e tyre akademik, detyrimeve dhe notave për çdo lëndë deri në fund të studimeve. Në mbështetje të këtij informacioni, funksionon edhe zyra e Sekretarisë Mësimore.

	Mbështetur në Rregulloren për Transferimin e Studimeve gjendet i specifikuar procedura e kryerjes së transferimeve. Specifikisht për transferimet horizontale, njohjes së krediteve të programeve universitare të certifikuara, transferimet nga Institucionet e tjera të Arsimit të Lartë, transferimet nga KU "Bedër" etj. <i>Evidenca 57. Performanca e studentëve nga Zyra e Sekretarisë Mësimore</i> <i>Evidenca 41. Rregullorja për transferimin e studimeve</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	KU "Bedër" përcakton procedurat e pranimit të studentëve të shprehura dhe në rregulloret e brendshme të institucionit. Kriteret e pranimit dhe kuotat përkatëse për secilin program studimi dërgohen në MAS dhe publikohen në faqen zyrtare të KU "Bedër" i aksesueshëm për publikun e gjerë. <u>https://www.beder.edu.al/pranimet/kriteret-e-pranimit</u>
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	GVJ konsultoi vendimin e Këshillit të Departamentit të Ekonomisë dhe Biznesit për miratimin e kuotave për programin e studimit Bachelor në Financë-Kontabilitet dhe Bachelor në Informatikë-Ekonomike për vitin akademik 2023-2024. Në këtë vendim u konstatua se KU "Bedër" përcakton kuota për kandidatët me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara. <i>Evidenca 66. Propozim për rishpërndarjen e kuotave për pranimin e studentëve në Departamentin e Ekonomisë dhe Biznesit.</i>
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Në vendimin për miratimin e kuotave për programin e studimit Bachelor në "Financë Kontabilitet" për vitin akademik 2024-2025 në dokumentat e përcjella në ASCAL, u konstatuan kuota për student të huaj apo të ardhur nga trevat shqiptare jashtë Shqipërisë. <i>Evidenca 66. Propozim për rishpërndarjen e kuotave për pranimin e studentëve në Departamentin e Ekonomisë dhe Biznesit.</i>
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	GVJ pasi konsultoi dokumentacionin në DVV dhe informacionin në website zyrtar të KU "Bedër", konstatoi se ofrohen bursa ekselente sipas kategorive: mesatarja 9.0- 10 (80% bursë); 9.0- 9.45 (60% bursë); 8.5- 8.99 (40% bursë); 8.0- 8.45 (20% bursë). Ofrohet bursa sociale deri në 100% për studentët që vijnë nga familjet në nevojë, për studentë me status jetimi, për persona me fatkeqësi familjare, për fëmijët e dëshmorëve, si dhe për kategori të tjera. Gjithashtu ofrohet bursa e talentit dhe bursa institucionale për kategoritë e tjera. <i>Evidenca 59. Miratimi i llojeve të zbritjeve të tarifave të studimit</i> <u>https://www.beder.edu.al/pranimet/apliko-per-burse</u>
Konkluzione	GVJ konkludon se: - Institucioni garanton barazi dhe mos diskriminim për të gjithë kandidatët për studentë dhe ata që ndjekin programin.

	- Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. - KU "Bedër" harton politika të përcaktuara qartë ndaj ndihmës/bursave për shtresa në nevojë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga KU "Bedër" në DVV në ASCAL, nga takimet e bëra me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstaton se informimi i studentëve bëhet që në vitin e parë të studimeve me procedurat e përparimit akademik. Aksesimi i këtij informacioni realizohet drejtëpërdrejtë nga pedagogët që në javën e parë të nisjes të mësimit, nga Sekretaria Mësimore, nga Guida e studentit dhe nga këshilltarët akademik. GVJ konstaton se në faqen e webit të KU "Bedër" afishohet Guida Studentore si instrumenti kryesor i marrjes së informacionit nga i gjithë publiku i interesuar. Gjithashtu, studentët mund të ndjekin progresin e tyre akademik në mënyrë dinamike duke u konsultuar me informacionin në sistemin BIS. Informacionet e kriterëve dhe procedurave të përparimit akademik të studentëve janë të paraqitura dhe në rregulloret e brendshme të institucionit, si në Rregulloren e ciklit të parë të studimeve dhe provimeve, Rregulloren e programit të studimit, Rregulloren Themelore si dhe në kontratën e studentit. <i>Evidenca 28. Guida e Studentit</i> <i>Evidenca 57. Performanca e studentëve nga Zyra e Sekretarisë Mësimore.</i> <i>Evidenca 3. Rregullorja Themelore</i> <i>Evidenca 6. Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë</i> <i>Evidenca 35. Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Financë Kontabilitet.</i> <i>Evidenca 24. Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS)</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Duke u konsultuar me DVV dhe Rregulloren e programit të studimit, GVJ konkludon se kriteret dhe procedurat për transferimet janë të përfshira në rregulloret e brendshme. Mbështetur në Rregulloren për Transferimin e Studimeve gjendet i specifikuar procedura e kryerjes së transferimeve. Specifikisht për transferimet horizontale, njohjes së krediteve të programeve universitare të certifikuara, transferimet nga Institucionet e tjera të Arsimit të Lartë, transferimet nga KU "Bedër" etj.

	Evidenca 41. Rregullorja për transferimin e studimeve.			
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Referuar DVV dhe takimeve me studentët e programit, GVJ konstaton se që në javën e parë të informimit kur nis mësimi, studentët informohen për procedurat dhe kriteret e vlerësimit të dijeve. Në këtë prezantim ata informohen për secilën lëndë nga pedagogu respektiv përmes prezantimit të syllabuseve, detyrimeve të lëndës, kriterëve të vlerësimit etj. Përmes llogarisë të krijuar nga institucioni, studentët informohen në kohë reale përmes sistemit BIS për vlerësimet, pjesëmarrjen në leksione dhe seminare, nota mesatare etj.			
	Evidenca 40. Syllabuset e Lëndëve Evidenca 24. Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS)			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Mbështetur në RVB dhe në dokumentacionet shoqëruese, për GVJ rezultojnë se kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës janë të paraqitura në Rregulloren e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Parë, Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Financë Kontabilitet (nenet 19,32) si dhe në Manualin e Përgatitjes së Tezës.			
	Evidenca 35. Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Financë Kontabilitet Evidenca 6. Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë Evidenca 60. Manuali për përgatitjen e tezës së diplomës dhe kriteret e vlerësimit të tezës për studentët e ciklit të parë			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Sipas DVV dhe takimeve në institucion me stafin akademik rezultojnë se pjesa më e rëndësishme e informimit të studentëve në programin e studimit realizohet përmes guides studentore ne website, përmes pjesëmarrjes në panairë të ndryshme, shpërndarjen e broshurave, vizitave të drejtëpërdrejta në institucion etj.			
	Evidenca 99. Broshura Bachelor në "Financë Kontabilitet"			
Konkluzione	GVJ konkludon se: - Institucioni ofron informim për studentët lidhur me kriteret e pranimit, detyrimet, detyrimet lëndore, kriteret e hyrjeve dhe transferimeve, punimin e diplomës - Informimi i studentëve me procedurat e përparimit akademik bëhet që në javën e parë të studimeve drejtëpërdrejtë nga pedagogët, nga Sekretaria Mësimore, nga Guida e studentit, nga këshilltarët akademik dhe sistemi BIS.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk	Përmbushet	Përmbushet	Përmbushet
	përmbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi V.3

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Bazuar në DVV, nga takimet e bëra me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstaton se informacioni kryesor u vihet në dispozicion studentëve gjatës javës e orientimit, syllabuseve, faqes zyrtare të insitucionit, zyrës së sekretarisë mësimore dhe broshurave. Gjatë ditëve të orientimit studentët marrin të gjithë informacionin e domosdoshëm për stafin akademik dhe administrativ, këshilltarët akademik, strukturën mësimore, syllabuset, kohëzgjatjen e programit, orarin mësimor etj. <i>Evidenca 68. Programi i ditëve të Orientimit të studentëve 2024-2025.</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	GVJ konstaton se informacioni kryesor që u vihet në dispozicion studentëve bëhet nga pedagogët e lëndëve gjatë javës së parë të informimit duke shpjeguar syllabusin, detyrimet, skemën e vlerësimit etj. Gjithashtu informimi vijon i vazhduar dhe i përditësuar në sistemin informatik BIS ku secili student logohet përmes adresës zyrtare të institucionit. Mbarëvajtja e komunikimit me studentët zhvillohet edhe përmes këshilltarëve akademik dhe zyrës së sekretarisë mësimore. <i>Evidenca 18. Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore</i> <i>Evidenca 68. Programi i ditëve të Orientimit të studentëve 2024-2025</i> <i>Evidenca 24. Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS)</i> <i>Evidenca 42. Miratimi i Udhëzuesit të Këshilltarit Akademik</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	GVJ pas takimit me studentët, RVB dhe Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe konstaton se institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit duke i ndihmuar për një aplikim pune apo orientimin drejt tregut të punës. Secili department cakton një këshilltar për planifikimin e karrierës, cili ndihmon studentët rreth procesit të njohjes dhe kërkimit të tregut të punës. Në ndihmë të kësaj vijnë dhe marrëveshjet dhe bashkëpunimet që KU "Bedër" ka lidhur me institucione dhe aktorë të ndryshëm të jetës së biznesit. <i>Evidenca 61. Vendimi i Këshillit të Departamentit për caktimin e përfaqësuesit pranë Zyrës së Planifikimit të Karrierës</i> <i>Evidenca 76. Marrëveshje bashkëpunimi me biznese dhe institucione</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Pas takimit me studentët, GVJ konstaton se studentët rezultojnë të informuar rreth procesit mësimor në programin studimit Bachelor në "Financë Kontabilitet", kurrikulës, lëndëve brendaj tij, formave të vlerësimit, logjistikës dhe infrastrukturës, orari mësimor etj. Orari mësimor dhe kalendari mësimor i vihen në dispozicion studentëve drejtëpërdrejtë në institucion, në faqen zyrtare të KU "Bedër" si dhe në sistemin informatik BIS. Me qëllim që të shtohet efikasiteti i komunikimit midis studentëve dhe institucionit, cdo student që në momentin e parë të regjistrimit në një nga programet e studimit i

	caktohet një këshilltarë akademik i cili e shoqëron gjatë gjithë rrugëtimit të tij akademik. GVJ gjithashtu konstatoi gjatë takimeve në institucion se KU “Bedër” disponon logjistikën dhe infrastrukturën e nevojshme për t’iu përgjigjur kërkesave në realizimin e programit të studimit Bachelor në “Financë Kontabilitet”. https://tt.beder.edu.al/ Shtojca: Tabela n.16: Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Gjatë vizitave të GVJ në institucion u verifikua funksionimi i sistemit informatik për menaxhimin e brendshëm të informacionit BIS. Që në momentin e regjistrimit të studentëve në KU “Bedër”, studentët pajisen me një llogari personale zyrtare që i mundëson aksesin e plotë në platformën BIS ku dhe marrin informacionin e vazhduar për njoftimet, zhvillimin e tyre akademik dhe detyrimet përkatëse. Ky sistem është funksional edhe në distancë. Gjithashtu, në kuadër të informimit përdoren dhe kanalet e tjera të komunikimit përmes faqes zyrtare të KU “Bedër”, rrjeteve sociale, Zyrës së Protokollit dhe Korrespondencës etj. https://www.beder.edu.al/ Evidenca 24. Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS)			
Konkluzione	GVJ konkludon se: - Sistemi informatik për menaxhimin e brendshëm të informacionit BIS është një platformë që i vjen në ndihmë informimit dhe koordinimit të brendshëm institucional dhe informimit të përditësuar të studentëve. - Funksionimi i këshilltarëve akademik rrit efikasitetin e komunikimit midis studentëve dhe institucionit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Mbështetur në RVB dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion, si dhe gjatë takimit në institucion me zyrën e Sekretarisë Mësimore, GVJ konstatoi se KU “Bedër” dispononte statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar duke krijuar dosjet e tyre personale. Evidenca 18. Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për	GVJ duke u mbështetur në verifikimet që realizoi gjatë vizitës në institucion, më konkretisht në Sekretarinë Mësimore, konstatoi se për programin e studimit Bachelor në Financë Kontabilitet, KU “Bedër”

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Pranë gjim. “Q. Stafa”, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.beder.edu.al

E-mail: info@ascal.al




numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	mbante në regjistrat themeltarë të dhënat e studentëve të regjistruar duke ndjekur vlerësimin e tyre sipas secilës lëndë deri në diplomim. Bashkëlidhur ishin dhe procesverbalet për secilën lëndë për këtë program studimi. Pas inspektimit rastëror, për dy student të këtij program studimi, një i vitit të parë dhe një i vitit të tretë, u verifikuan rregullësi në mbajtjen e të dhënave. Pas verifikimit në Sekretarinë Mësimore, rezultoi se: Për vitin akademik 2024-2025 janë të regjistruar 10 studentë; Për vitin akademik 2023-2024 janë të regjistruar 8 studentë; Për vitin akademik 2022-2023 janë të regjistruar 6 studentë. Nga informacioni që GVJ mori gjatë vizitës në Sekretarinë Mësimore, rezultonin katër studentë të çregjistruar në këtë program studimi. <i>Shtojca: Tabela n.21: Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve</i>
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	GVJ pas vizitës në insitucion, konstatoi se të dhënat e studentëve menaxhohen përmes sistemit të informacionit BIS. Më tej, Zyra e Sekretarisë Mësimore gjeneron informacione nga sistemi BIS, sikurse këshlltari akademik apo persona të tjerë të autorizuar. Në nenin 18 të Rregullores të Zyrës së Sekretarisë Mësimore, specifikohet se KU “Bedër” mbron, ruan, siguron dhe administrin të dhënat personale në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Më gjerësisht kjo trajtohet në Rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale. <i>Evidenca 18. Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore</i> <i>Evidenca 89. Rregullorja për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale</i>
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	GVJ sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion në DVV, konstatoi se KU “Bedër” kryen auditim periodik të brendshëm për të verifikuar rregullaritetin e informacionit të dokumentuar për veprimtarinë institucionale, akademike dhe atë që lidhet me studentët. Për këtë harton një raport përmbledhës që i shpërndahet njësive menaxhuese të informacionit bashkë me rekomandimet përkatëse. <i>Evidenca 80. Raporti për auditimin periodik</i>
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të	Duke qenë se programi i studimit Bachelor në “Financë Kontabilitet” po i nënshtrohet për herë të parë akreditimit, nuk ka të dhëna të disponueshme lidhur me këtë kriter. Por mbi bazën e RVB, cilësohet se Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit ka një përfaqësues pranë Zyrës së Panifikimit të Karrierës, i cili meret me praktikën e studentëve, bashkëpunimin me aktorët e biznesit dhe potencialisht deri në punësimin e studentëve.




përmirësimi të këtyre treguesve.	<i>Evidenca 61. Vendimi i Këshillit të Departamentit për caktimin e përfaqësuesit pranë Zyrës së Planifikimit të Karrierës</i>			
Konkluzione	- GVJ konstatoi, - KU "Bedër" ruan, administron dhe përditëson me rregullaritet informacionin e për studentët që ndjekin programin e studimit Bachelor në "Financë Kontabilitet" - Në kuadër të verifikimit të informacionit të mbajtur nga njësitë e administrimit të brendshëm të informacionit, kryen kontrolle periodike të cilat përmbledhen në raporte bashkë me rekomandimet përkatëse.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Pas vizitës në KU "Bedër", nga RVB dhe dokumentacionit në DVV, u konstatua nga GVJ se studentët kishin përfaqësuesit e tyre në Senatin Akademik, Këshillin e Departamentit, Komisionin e Përhershëm të Garantimit të Cilësisë dhe NJSCB. E drejta e angazhimit të studentëve në organet vendimmarrëse dhe këshilluese është e sanksionuar në LAL 80/2015, në Statutin e KU "Bedër" neni 10 (për përfaqësinë në Senatin Akademik) dhe neni 28 (për përfaqësinë në NJSBC), në Rregulloren për funksionimin e komisionit të përhershëm për garantimin e standardeve neni 10. Gjithashtu studentët e KU "Bedër" gjejnë veten të përfshirë dhe të përfaqësuar edhe në Këshillin Studentor, ku kryetari i këtij këshilli merr pjesë në organet vendimmarrëse të institucionit. Gjithashtu funksionon dhe një njësi tjetër përfaqësuese e studentëve, Dekanati i Studentëve që i ndihmon në mbrojtjen e të drejtave të studentëve dhe orientimit drejt tregut të punës. <i>Evidenca 1. Statuti i Kolegjit Universitar Bedër</i> <i>Evidenca 16. Rregullorja e funksionimit të komisionit të përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit</i> <i>Evidenca 97. Vendimi i zgjedhjes së Komisionit të përhershëm për garantimin e standardeve dhe cilësisë</i> <i>Evidenca 71. Studentët përfaqësues në mbledhjet e Këshillit të Departamentit</i> <i>Evidenca 11. Rregullorja mbi Organizimin Administrativ</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e	Bazuar në RVB, dokumentacionin në DVV dhe takimin me studentët e KU "Bedër", nga GVJ konkludohet se studentët e gjejnë veten të

studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	përfshirë dhe të përfaqësuar në Senatin Akademik, Këshillin e Departamentit, Komisionin e Përhershëm të Garantimit të Cilësisë dhe NJSCB, Këshillin studentor dhe në Dekanatin e Studentëve. Gjithashtu studentët në takim evidentuan plotësimin e pyetësorëve nga ana e tyre për vlerësimin e insitucionit dhe cilësisë së mësimdhënies në mënyrë anonime. <i>Evidenca 71. Studentët përfaqësues në mbledhjet e Këshillit të Departamentit</i> <i>Evidenca 34. Anketa e studentit ndaj lëndës.</i> <i>Evidenca 50. Anketë vlerësimi i studenteve për institucionin.</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Mbështetur në DVV dhe nga takimet me grupet e punës në institucion, GVJ konstaton se në mbështetje të politikës që KU “Bedër” ka për përmirësimin e programit të studimit, realizohen anketa për vlerësimin cilësor të programit nga studentët e regjistruar. Anketa orientohet kryesisht në vlerësimin e kurrikulës dhe syllabuseve të programit të studimit Bachelor në “Financë Kontabilitet” dhe administrohet nga Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit. Për të rritur numrin e të anketuarve, sipas takimit që GVJ pati në institucion, u konfirmua që shpërndarja e anketave bëhej përpara kryerjes të provimit nga ana e studentëve të programit të studimit. <i>Evidenca 46. Politika për Përmirësimin e programeve të studimit.</i> <i>Evidenca 47. Anketë vlerësimi i studentëve për programin e studimit</i>
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.	GVJ konstaton se të drejtën e ankimit të rezultateve të provimeve studentët e kanë të saksionuar në Nenin 28 të Rregullores të Programit të Studimit Bachelor në Financë Kontabilitet, Nenin 102 të Rregullores Themelore, Nenin 24 të Rregullores të studimeve dhe provimeve të ciklit të parë, gjithashtu dhe në Guidën e Studentit. Kjo gjë u konfirmua edhe gjatë takimit që GVJ zhvilloi me studentët e programit të studimit Bachelor në “Financë Kontabilitet” gjatë vizitës në Kolegjin Universitar “Bedër”. Studenti ka të drejtë të bëjë kërkesë me shkrim për rishikimin e rezultatit përfundimtar në një provim semestral Brenda një jave tek Zyra e Sekretarisë Mësimore. Nota e rishikuar i bëhet me dije studentit brenda 15 ditëve. <i>Evidenca 35. Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Financë Kontabilitet</i> <i>Evidenca 3. Rregullorja Themelore</i> <i>Evidenca 6. Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë</i>
Konkluzione	GVJ konkludon se, - Studentët e programit të studimit kanë përfaqësuesit e tyre në Senatin Akademik, Këshillin e Departamentit, Komisionin e Përhershëm të Garantimit të Cilësisë dhe NJSCB. - Në kuadër të vlerësimit të brendshëm cilësor dhe përmirësimit të programit të studimit, realizohen anketime të vazhdueshme nga studentët e regjistruar në program.

	- E drejta e ankimimit të rezultateve të provimeve nga ana e studentëve është e sanksionuar në shumë rregullore të brendshme të institucionit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	GVJ duke u konsultuar me dokumentacionin në DVV, takimit me zyrat e institucionit dhe me studentët, konstaton se KU “Bedër” zhvillon procedura të posaçme përmes strukturave të brendshme për të informuar studentët. Zyra e Sekretarisë Mësimore, Zyra e Regjistrimeve, Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Zyra e të Diplomuarve janë në funksion të informimit të studentëve lidhur me vlerësimet dhe detyrimet e secilës lëndë në program, procedurat e regjistrimit të studentëve, për tregun e punes, praktikat mësimore, mundësive për mobilitete dhe cdo informacion tjetër i vlefshëm për jetën studentore. Informimi i vazhdueshëm i studentëve bëhet përmes website zyrtare të institucionit ku jepet informacion i detajuar për të gjitha programet e studimit. Gjithashtu informimi bëhet edhe përmes Guidës Studentore, sistemit informatik BIS dhe e-maileve zyrtare që ka secili student në programin e studimit. <i>Evidenca 11. Rregullorja mbi Organizimin Administrativ</i> <i>Evidenca 18. Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore</i> https://www.beder.edu.al/pranimet/programet?type=bachelor <i>Evidenca 28. Guida e Studentit</i> <i>Evidenca 24. Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS)</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	GVJ pas vizitës në institucion, takimit me zyrat dhe studentët, konstaton se KU “Bedër” ka funksionale struktura të posaçme në drejtim të informimit, këshillimit, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe përfshirjen e tyre në çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. Kjo realizohet duke patur në përbërje të strukturës së institucionit Zyrën e Planifikimit të Karrierës, Zyrën e Sekretarinë Mësimore dhe Dekanatin e Studentëve. Gjithashtu në kuadër të informimit për studentët e KU “Bedër” shërben edhe faja zyrtare e institucionit me rubrikat respektive, “Ditët e orientimit”, Koordinator i Programit, Këshilltari Akademik në mbarrëvajtjen e të gjithë çështjeve të brendshme me karakter akademik dhe administrative, Këshilltari i Karrierës në ndjekje të studentëve deri në punësimin e tyre, si dhe përmes Asistentit pranë Zyrës së Marrëdhënieve Ndërkombëtare. <i>Evidenca 68. Programi i ditëve të Orientimit të studentëve 2024-2025</i>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

	<i>Evidenca 18. Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore</i> <i>Evidenca 51. Vendimi i Këshillit të Departamentit për caktimin e koordinatorit të programit të studimit</i> <i>Evidenca 74. Caktimi i këshilltarëve akademikë për programet Bachelor, viti akademik 2024-2025</i> <i>Evidenca 61. Vendimi i Këshillit të Departamentit për caktimin e përfaqësuesit pranë Zyrës së Planifikimit të Karrierës.</i> <i>Evidenca 82. Caktimi i asistentit pranë Zyrës së Marrëdhënieve Ndërkombëtare</i>			
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Nga vizita në institucion, takimet me studentët e programit të studimit si dhe përfaqësues të Zyrës për Planifikimit të Karrierës, rezultoi se studentët informohen për procesin mësimor, mundësitë e zhvillimit të praktikës profesionale si dhe mundësitë për hapësira punësimi. Cdo departament emëron një këshilltar karriere pranë zyrës së karrierës i cili ka funksionin e koordinatorit në ndërlidhjen e studentëve me praktikën mësimore, mbi mundësitë e trajnimeve apo aktiviteteve të tjera profesionale. <i>Evidenca 61. Vendimi i Këshillit të Departamentit për caktimin e përfaqësuesit pranë Zyrës së Planifikimit të Karrierës</i> <i>Evidenca 55. Procedura e praktikës profesionale</i>			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Në rastin e programit të studimit Bachelor në "Financë Kontabilitet" i cili zhvillon procesin e akreditimit për herë të parë, nuk ka evidencë statistikore për këtë kriter as në dokumentacionet e DVV dhe as në takimin që GVJ zhvilloi në institucion.			
Konkluzione	GVJ konkludon se, - KU "Bedër" përmes Zyrës së Planifikimit të Karrierës, Zyrës së Sekretarisë Mësimore, Koordinatorit të Programit, Këshilltarit Akademik, Këshilltarit të Karrierës, si dhe Asistentit pranë Zyrës së Marrëdhënieve Ndërkombëtare zhvillon procesin e informimit të studentëve në të gjitha hallkat e formimit akademik, për mundësitë e praktikave apo mundësitë për punësim të studentëve. Ndërkohë gjurmimi pas diplomimit nuk ka evidencë statistikore sepse programi akreditohet për herë të parë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht




				X
--	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit të përfshirë në DVV dhe takimeve me stafin akademik gjatë vizitës në institucion, GVJ kontaton se KU "Bedër" ka hartuar udhëzuesin strategjik në nivel institucional për përdorimin e metodave inovatore të mësimdhënies. Kjo vjen në përputhje me misionin e institucionit për përgatitjen e individëve të kualifikuar, si dhe zhvillimin e dijeve, përmes mësimdhënies e kërkimit shkencor me standarde të larta. <i>GVJ sugjeron hartimin e një udhëzuesi për një periudhë të paktën 3-5 vjetare në të cilën të parqiten drejtimit kryesore të zhvillimit didaktik të stafit akademik me në fokus përdorimin e metodave innovative të mësimdhënies.</i> <i>Evidenca 102. Udhëzues mbi mësimdhënien inovative në KU Bedër.</i> <i>Evidenca 36. Udhëzim mbi mësimdhënien në distancë</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	GVJ duke u mbështetur në DVV dhe në takimet në institucion, konstaton se strukturat e njësisë bazë si dhe NJSBC, zbatojnë aplikimin në cdo semestër të anketave për studentët si instrument i vlerësimit të stafit akademik, formularë vetëvlerësimi nga stafi akademik dhe raporte të brendshme vlerësimi të stafit akademik nga njësia bazë që drejton programin e studimit. Në website zyrtare të institucionit gjendet dhe Rregullorja e anketave dhe vlerësimeve të KU "Bedër", për marrjen e informacionit nga anketat e plotësuara nga ana e stafit akademik, administrativ dhe studentët. <i>GVJ sugjeron se përveç strukturave të brendshme të kontrollit të cilësisë në KU "Bedër", të përfshihen mekanizma dhe struktura të jashtme për të vlerësuar cilësinë e stafit akademik dhe cilësinë e mësimdhënies në kuadër të rritjes së cilësisë në programet e studimit.</i> <i>Evidenca 39. Formular vlerësimi për stafin akademik</i> <i>Evidenca 48. Formular i vlerësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies</i> <i>Evidenca 49. Procedura e vlerësimit të performancës së stafit akademik</i> <i>Evidenca 84. Raporti përmbledhës i vetëvlerësimit për stafin akademik.</i>

	https://dev.admin.beder.edu.al/documents/1666353606_rregullore-e-anketave-dhe-vleresimeve.pdf
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	GVJ pas takimit në institucion me studentët e programit si dhe me stafin e zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, konstaton se realizohet një anketë nga studentët me synimin e vlerësimit të stafit akademik, cilësinë e metodave të mësimdhënies etj. GVJ konstaton se të drejtën e ankimimit të rezultateve të provimeve studentët e kanë të saksionuar në Nenin 28 të Rregullores të Programit të Studimit Bachelor në Financë Kontabilitet, Nenin 102 të Rregullores Themelore, Nenin 24 të Rregullores të studimeve dhe provimeve të ciklit të parë, gjithashtu dhe në Guidën e Studentit. Kjo u konfirmua edhe gjatë takimit që GVJ zhvilloi me studentët e programit Bachelor në “Financë Kontabilitet” gjatë vizitës në KU “Bedër”. <i>Evidenca 39. Formular vlerësimi për stafin akademik</i> <i>Evidenca 35. Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Financë Kontabilitet</i> <i>Evidenca 3. Rregullorja Themelore</i> <i>Evidenca 6. Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Pas takimit me përfaqësues të Njesisë së Sigurimit të Cilësisë dhe mbështetur në Nenin 18 të Rregullores së NJSBC të KU “Bedër”, raportet vjetore të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm publikohen në faqen e internetit. Më konkretisht, në rubrikën e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në faqen zyrtare të internetit të KU “Bedër” janë bërë publike: - Anketat e stafit akademik për institucionin 2022-2023 - Anketa e stafit administrativ për institucionin-2022-2023 - Anketa e studenteve për institucionin-2022-2023 - Relacion i Anketës Vlerësimi e Studentëve për Institucionin 2023-2024 - Relacion i Anketës së Stafit Administrativ 2023-2024 - Relacion i Anketës Vlerësimi i Stafit Akademik për Institucionin 2023-2024 Analiza e rezultateve të anketave përfshihet në raportet vjetore të NJSBC të publikuara në faqen zyrtare të internetit të KU “Bedër” e aksesueshme për të gjithë publikun. Më konkretisht, përfshihen rezultatet e anketave: për vlerësimin e studentit për pedagogun dhe lëndët semestrale; për vlerësimin e studentit për institucion dhe shërbimet që ai ofron; për vlerësimin e stafit akademik për institucionin; për vlerësimin e stafit administrativ për institucionin; formular vetëvlerësimi i stafit akademik. <i>Evidenca 17. Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së</i> https://www.beder.edu.al/rreth-nesh/njesia-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise/anketat https://www.beder.edu.al/rreth-nesh/njesia-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise/raportet




Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	GVJ mbështetur në RVB, konstaton se në Kolegjin Universitar Bedër promovohen praktikat më të mira duke shpallur listën e stafit me performancën më të mirë. Në mbështetje të kësaj nuk pati asnjë evidencë në DVV-në e dorëzuar në ASCAL.			
Konkluzione	GVJ konkludon se: - Strukturat e njësive bazë dhe NJSBC, zbatojnë aplikimin e anketave për vlerësim të studentit për pedagogun dhe lëndët semestrale; Anketë vlerësimi e studentit për institucion dhe shërbimet që ai ofron; Anketë vlerësimi e stafit akademik për institucionin; Anketë vlerësimi e stafit administrativ për institucionin; Formular vetëvlerësimi i stafit akademik. - Rezultatet e anketave përfshihen në raportet e NJSBC dhe janë të afishuara në faqen zyrtare të internetit të institucionit të aksesueshme për të gjithë. - Sugjerohet një udhëzues për një periudhë të paktën 3-5 vjetecare në të cilën të parqiten drejtimet kryesore të zhvillimit didaktik të stafit akademik me në fokus përdorimin e metodave innovative të mësimdhënies.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë, mbështetur në kreun VIII të Statutit të KU "Bedër", rezulton se KU "Bedër" ka ngritur Njësine e Sigurimit të Cilësisë në nivel IAL. Kjo njësi i zgjedh anëtarët e saj një herë në dy vjet me miratimin e Senatit Akademik. NJSBC kryen detyra të ndryshme administrative për kontrollin e cilësisë si dhe procedura të cilat ndjekin monitorimin e vazhdueshëm të ecurisë së programit të studimit Bachelor në "Financë Kontabilitet". Mbështetur në RVB dhe takimit në institucion, GVJ konstaton se sigurimi i brendshëm i cilësisë në KU "Bedër" kryhet edhe nëpërmjet strukturave të tjera si: Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standarteve dhe Cilësisë, Zyra e Zhvillimit të Kurrikulës si dhe Komisioni i Përhershëm për Kërkimin Shkencor, Projektet dhe Inovacionin. <i>Evidenca 1. Statuti i Kolegjit Universitar Bedër.</i>

	<i>Evidenca 17. Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së</i> <i>Evidenca 16. Rregullorja e funksionimit të komisionit të përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit.</i> <i>Evidenca 19. Rregullorja mbi projektet kërkimore shkencore</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Në Kolegjin Universitar “Bedër” funksionon si njësi organizative Zyra e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm e Cilësisë, e cila është garantuar nga Statuti i KU “Bedër” (neni 28) dhe Rregullorja e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Detyra kryesore e NJSBC-së është hartimi i politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Referuar dokumentacionin në RVB, kjo strukturë përbëhet nga tre anëtarë staf i brendshëm i KU “Bedër”, 1 ekspert i jashtëm (pjestar që nga nëntori 2022), 1 përfaqësues i Këshillit Studentor. <i>Evidenca 1. Statuti i Kolegjit Universitar Bedër.</i> <i>Evidenca 17. Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së</i> <i>Shtojca: Tabela nr.24: Të dhëna për anëtarët e NJSBC</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Në kuadër të vlerësimit të jashtëm, KU “Bedër” rezulton të ketë përfunduar tre akreditime institucionale, ku i fundit nga ASCAL u krye në 2021 (5 vjet) dhe ka vlefshmëri deri në 2026. Përveç akreditimit institucional, institucioni realizon procesin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë nga NJSBC. Mekanizmat e brendshëm të përdorur në kuadër të sigurimit të cilësisë nga NJSBC janë: anketat e studentëve, anketat e stafit akademik dhe anketat e stafit administrative. Të gjithë mekanizmat e përdorur janë përfshirë në mënyrë integrale në raportin vjetor të NJSBC-së i bërë publik dhe aksesueshëm në faqen zyrtare të institucionit. <i>GVJ sugjeron përfshirjen edhe të formave të tjera të vlerësimit të cilësisë nga aktorë të jashtëm.</i> https://dev.admin.beder.edu.al/assets/beder_quality_assurance/raporti-i-njsbc-2023-2024-1.docx.pdf
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të	GVJ mbështetur në dosjen e DVV dhe vizitës në institucion, konstaton se në KU “Bedër” përdoren mekanizma të brendshëm me qëllim rritjen e cilësisë si: formularët e vetëvlerësimit për stafin akademik i cili përmban dhe vlerësimin e mësimdhënies dhe kërkimin shkencor. Gjithashtu në fund të çdo semestri realizohen dhe anketat e studentëve për pedagogun dhe lëndët përkatëse. Informacioni i mbledhur bëhet pjesë e diskutimeve në departament ku merren masa për përmirësime të mëtejshme.


mira ne programin e studimit.				
Konkluzione	<i>GVJ konkludon se:</i> - KU "Bedër" është e angazhuar për sigurinë dhe përmirësimin e cilësisë përmes strukturës organizative NJSBC. - NJSBC përdor mekanizmat e brendshëm në sigurimit e cilësisë si: anketat e studentëve, anketat e stafit akademik dhe anketat e stafit administrative.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	GVJ pas vizitës në institucion dhe konsultimit me informacionin në dosjen e DVV, konstaton se KU "Bedër" përdor mekanizma formal dhe i dokumenton ato në raportin e vjetor të sigurimit të cilësisë. Në kuadër të akreditimit, institucioni ka ngritur GVB, i cili ka përgatitur dokumentacionin shoqërues të DVV dhe ka hartuar Raportin e Vlerësimit të Brendshëm. Propozimet për ndryshimin e programeve mësimore propozohen nga njësia bazë, më pas kalojnë në njësinë kryesore dhe në fund në Senatin Akademik. Procesi i përmirësimit dhe ndryshimit të kurrikulave bëhet nën koordinimin e zyrës së zhvillimit të kurrikulave. Sikurse u përmend më sipër, <i>GVJ sugjeron të bëhet një analizë më e thelluar e disa prej mekanizmave të brendshëm të përdorur me qëllim rritjen e cilësisë.</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra	Referuar DVV dhe më konkretisht në Raportin Vjetor të Sigurimit të Cilësisë, rezulton se në brendësi raporti përmban informacion të detajuar për disa fusha vlerësimi për të gjitha programet e studimi në KU "Bedër". Në kuadër të informimit të brendshëm dhe të jashtëm, këto raporte janë të aksesueshme pasi gjenden të publikuara në faqen zyrtare të institucionit. Përsa i përket rezultateve të pritshme dhe motivimit drejt praktikave më të mira, KU "Bedër" ka publikuar planin strategjik për 2024-2028. Fushat kryesore janë të orientuara drejt rritjes së cilësisë së programeve të

për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	studimit, infrastrukturës akademike, përparësive strategjike të kërkimit shkencor dhe mbështetjes së inovacionit, rritja e cilësisë së studentëve, mbështetja për zhvillim profesional të stafit akademik e administrative etj. Në kuadër të rritjes së cilësisë së programeve të studimit, realizohen anketat e përmendura më sipër, rezultatet dhe analiza e të cilave nga NJSBC përcillen deri në Senatën Akademik. Gjithashtu përfshihen dhe në raportet vjetore të NJSBC të bëra publike. <i>GVJ sugjeron që në raportin vjetor të Sigurimit të Cilësisë të përfshihet një analizë me e detajuar për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, të kurrikulës, mbarëvajtjes didaktike, pjesëmarrjes, kalueshmërisë, notës mesatare etj. Gjithashtu sugjerohet që kjo të bëhet sipas secilit program studimi pasi në raport janë të përmbledhura për të gjitha programet.</i> <i>Evidenca 15. Plani Strategjik Institucional 2024-2028.</i> <i>https://dev.admin.beder.edu.al/assets/beder_quality_assurance/raporti-i-njsbc-2023-2024-1.docx.pdf</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	GVJ konstatoi mbështetur në dokumentacionin e DVV dhe takimit në institucion se KU “Bedër” përdor metoda të drejtpërdrejta në kuadër të vlerësimit të të mësuarit dhe mësimdhënies sic janë vlerësimi me notë, me pikë, me detyra dhe projekte, vlerësime testime të ndërmjetme, vlerësime testimi final, vëzhgime të ushtrimit të praktikës etj. <i>Evidenca 40. Syllabuset e Lëndëve.</i>
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të	GVJ referuar RVB konstaton se, në Kolegjin Universitar “Bedër” funksionon NJSBC e cila përdor metoda dhe instrumenta të tërthorta në formën anketateve për vlerësimin e programit të studimit si: anketa për vlerësimin e pedagogut të lëndës, anketa vjetore e studentëve për vlerësim të institucionit, anketa vjetore e stafit akademik dhe administrative ndaj institucionit, anketa e vlerësimit të studentëve për programin e studimit dhe anketa e të diplomuarve për programin e studimit.




atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	GVJ konstatoi se në raportin vjetor të Sigurimit të Cilësisë mungojnë Evidenca t nga anketat të specifikuar për cdo program studimi dhe për cdo anketë të kryer, sidomos raporti i periudhës 2023-2024.			
Konkluzione	GVJ konkludon se, - KU "Bedër" përdor instrumenta të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë në kuadër të mbarëvajtjes së cilësisë së programit, por sugjerohet një analizë më e thelluar të disa prej mekanizmave të brendshëm të përdorur me qëllim rritjen e cilësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Në Kolegjin Universitar "Bedër" funksionon si njësi organizative Zyra e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm e Cilësisë, e cila është garantuar nga Statuti i KU "Bedër" (neni 28) dhe Rregullorja e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Detyra kryesore e NJSBC-së është hartimi i politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Senati akademik zgjedh anëtarët e NJSBC e cila përbëhet nga tre anëtarë staf i brendshëm i KU "Bedër", 1 ekspert i jashtëm (pjestar që nga nëntori 2022), 1 përfaqësues i Këshillit Studentor. Gjithashtu ngre Komisionin e Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë, i cili është organ kolegjal që kryen funksione në lidhje me garantimin e standarteve të cilësisë institucionale dhe programeve të studimit. Të dy strukturat kanë përgjegjësi në sigurimin e brendshëm të cilësisë në KU "Bedër." <i>Evidenca 1. Statuti i Kolegjit Universitar Bedër.</i> <i>Evidenca 16. Rregullorja e funksionimit të komisionit të përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit.</i> <i>Evidenca 17. Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së.</i>

Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Të gjitha strukturat përgjegjëse për ruajtjen e cilësisë në KU "Bedër" si: NJSBC, Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë, GVB, njësia kryesore, njësia bazë, stafi akademik dhe studentët i kanë të sanksionuara të drejtat dhe detyrimet në rregulloren e KU "Bedër", në rregulloren e NJSBC, rregulloren e funksionimit të komisionit të përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimeve. Të gjithë përgjegjësit kanë detyrat të qarta dhe marrin pjesë aktivisht në zhvillimin e modeleve vlerësuese. <i>Evidenca 16. Rregullorja e funksionimit të komisionit të përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit.</i> <i>Evidenca 17. Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së.</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	GVJ duke u konsultuar me Raportin Vjetor të Sigurimit të Cilësisë dhe gjatë vizitës në institucion me grupin e NJSBC, konstaton se në përbërje të tij janë pesë anëtarë. Sipas statutit të KU "Bedër" (neni 28), anëtarët e NJSBC miratohen nga Senati Akademik me propozim të rektorit. Anëtarët janë: një kryetar, dy përfaqësues të personelit akademik të njësisë kryesore për cdo fakultet, një përfaqësues i Këshillit Studentor dhe një ekspert i jashtëm. <i>Evidenca 1. Statuti i Kolegjit Universitar Bedër</i> <i>Shtojca: Tabela nr. 24: Të dhëna për anëtarët e NJSBC</i>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Në të gjithë procesin lidhur me vlerësimin dhe analizën e ecures së programit të studimit, respektohet integriteti akademik i pedagogëve, dënohet shkelja e të drejtave të njeriut dhe nuk lejohet diskriminimi apo pabarazia kundrejt personelit dhe studentëve. Në mbështetje të saj, KU "Bedër" ka miratuar "Politikën për Barazinë Gjinore, Mundësi të Barabarta dhe Diversitet". Në përfundim të shpërndarjes së anketave bëhet përpunimi i tyre, i cili është në mbrojtje të integritetit akademik dhe synon të shmangë çdo lloj pabarazie kundrejt personelit akademik që vlerësohet dhe studentëve që vlerësojnë. Mbështetur në informacionin që GVJ mori gjatë vizitës në institucion, konfirmoi se në përfundim të përpunimit të përgjigjeve të anketave ato i dërgohen njësisë bazë dhe njësisë kryesore. <i>Evidenca 77. Politika e KU "Bedër" për barazi gjinore, mundësi të barabarta dhe diversitet</i>
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit	GVJ konstaton se në përbërje të NJSBC dhe Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë ka në përbërjen e tyre ekspert të jashtëm. Gjithashtu për të përfshirë ekspertizat më të mira të tregut me qëllim përcjelljen e tyre në programin e studimit, KU "Bedër" organizon takime të vazhdueshme me profesionistë të fushave të tregut.




apo mund të japin ekspertizë e mendime të vjera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.				
Konkluzione	GVJ konkludon se, - KU "Bedër" në kuadër të sigurimit të cilësisë së institucionit, përfshin të gjithë aktorët e brendshëm si: njësinë kryesore, njësitë bazë, stafin akademik, përfaqësues të studentëve në përbërje të NJSBC dhe Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	GVJ duke u konsultuar me webin zyrtar të KU "Bedër", konstaton se në këtë faqe janë të afishuara: - Rregulloret për funksionimin e Komisionit për Sigurimin e Cilësisë; - Rregullore e anketave dhe vlerësimeve; - Procedura e vlerësimit të performancës së stafit akademik; - Rregullore për funksionimin dhe organizmin e NJSBC; - Udhezim mbi nxitjen e publikimeve dhe kerkimit shkencor; - Anketat e ndryshme; - Raportet vjetore të NJSBC; - Vendime të Bordit të Administrimit. Informacioni është publik dhe i aksesueshëm për të gjithë të interesuarit dhe studentët. https://www.beder.edu.al/rreth-nesh/njesia-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise/raportet
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Duke u konsultuar me faqen zyrtare të institucionit, GVJ konstatoi se KU "Bedër" bën publike të gjitha rezultatet e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të programit të studimit, si dhe vendimet e Bordit të Administrimit. Kjo gjë realizohet duke ruajtur lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin në fuqi për të dhënat personale. https://www.beder.edu.al/rreth-nesh/njesia-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise/vendime-te-bordit-te-akreditimit https://www.beder.edu.al/rreth-nesh/njesia-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise/raportet
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë	GVJ gjatë shqyrtimit të informacionit në DVV dhe në RVB, konstatoi se KU "Bedër" rishikon vlerësimet e jashtme duke ndërmarrë vendime të brendshme nga Senati Akademik për miratimin e planveprimin për përmbushjen e rekomandimeve për akreditim institucional.

përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	<i>Evidenca 78. Plani i masave për plotësimin e rekomandimeve të BA për institucionin.</i>			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	GVJ duke u mbështetur në informacionin e marrë në RVB konstaton se, KU “Bedër” vlerësimet e përfituara nga veprimtaritë e ndryshme të vlerësimit të cilësisë, i bën pjesë të raportimeve të ndryshme të cilat i shpërndahen stafit akademik për diskutime në kuadër të përmirësimit të mëtejshëm të programeve të studimit. Kjo u konfirmua edhe gjatë vizitës që GVJ zhvilloi me stafin akademik në institucion.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	GVJ gjatë konsultimit me faqen zyrtare të internetit dhe takimeve të zhvilluara në institucion, konstaton se KU “Bedër” zhvillon aktivitete të vazhdueshme me stafin akademik dhe studentët në kuadër të informimit me rolin e NJSBC-së. Kjo njësi harton standardet për sigurimin e cilësisë së brendshme në përputhje me Kodin e Cilësisë. <i>https://www.beder.edu.al/rreth-nesh/njesia-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise</i>			
Konkluzione	GVJ konkludon se: <i>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë publike dhe transparente për të gjithë të interesuarit dhe studentët. Informacioni shfaqet i plotë në raportet përkatëse të NJSBC në faqen zyrtare të institucionit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në
"Financë - Kontabilitet", Kolegji Universitar "Bedër"**

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Qëndrueshmëria e stafit akademik të brendshëm, i cili është i angazhuar në mënyrë të vazhdueshme në programin e studimit.
2. Marrëdhënie bashkëpunimi të qëndrueshme me aktorë të jashtëm, të cilat ndihmojnë në përfitimin e studentëve përmes praktikave profesionale, intershipeve dhe trajnimeve që mbështesin formimin e tyre profesional.
3. Infrastrukturë moderne dhe pajisje laboratorike bashkëkohore, të vëna në dispozicion të programit të studimit Bachelor në Financë-Kontabilitet, që mbështesin zhvillimin e procesit mësimor dhe të aftësive të studentëve në përputhje me nevojat e tregut të punës.
4. Mbështetje e vazhdueshme e marrëdhënies pedagog-student, që ndihmon në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe motivimin e studentëve.
5. Përfshirja aktive e studentëve në klube studentore, e cila nxit angazhimin dhe bashkëpunimin ndërmjet tyre.
6. Klimë pozitive institucionale, që promovon dhe mbështet pjesëmarrjen e studentëve në programe të mobilitetit ndërkombëtar.
7. Nxitja e pjesëmarrjes së studentëve në aktivitete akademike, si konferenca dhe shkolla verore, me qëllim rritjen e interesit për kërkimin shkencor.
8. Integrimi i teknologjisë në mësimdhënie, i cili rrit interesin dhe ndihmon përshtatjen e studentëve me zhvillimet teknologjike bashkëkohore.
9. Stafi akademik është në progres të vazhdueshëm profesional, nëpërmjet përpjekjeve për marrjen e titujve dhe gradave shkencore, duke rritur kështu kapacitetin dhe cilësinë e departamentit.
10. Institucioni angazhohet në mënyrë të vazhdueshme për sigurimin e cilësisë, përmes përfshirjes së aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në këtë proces.
11. Sistemi i brendshëm i informacionit (BIS) ndihmon në lehtësimin e procesit mësimor dhe krijon interaktivitet midis studentëve dhe stafit akademik.
12. Bashkëpunimi me departamentet e tjera të Universitetit "Beder" ka kontribuar në realizimin me sukses të procesit mësimor dhe atij kërkimor.

Pika të dobta:

1. Mungesa e dokumentacionit të plotë për provimin përfundimtar në programin "Bachelor në Financë-Kontabilitet", përfshirë shpërndarjen e pikëve, udhëzuesin për temat e mundshme dhe modelin orientues të testit [Standardi III.5/ kriteri 3]
2. Mungesa e një udhëzuesi afatmesëm (3–5 vjeçar) për zhvillimin didaktik të stafit akademik dhe përqendrimin në metodat inovative të mësimdhënies, si dhe mungesa e evidencave të detajuara nga anketat për secilin program studimi në raportin vjetor të Sigurimit të Cilësisë (2023–2024) [Standardi VI.1/ kriteri 3]
3. Mungesa e dokumentacionit mbi kryerjen e raportit të auditimit periodik në mënyrë që të vlerësohet efektiviteti financiar i institucionit. Gjithashtu, mungesa e informacionit për raportimin e brendshëm në institucion mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. [Standardi IV.5/ kriteri 3 dhe 4]

Rekomandime:

1. Përforsimi i mbështetjes financiare për programin e studimit:

Universiteti "Bedër" duhet të vendosë objektiva të qarta në funksion të gjenerimit të të ardhurave shtesë përmes projekteve kërkimore, trajnimeve dhe bashkëpunimeve me aktorë të jashtëm. Këto të ardhura do të ndihmojnë në qëndrueshmërinë dhe zhvillimin e mëtejshëm të programit.

2. Hartimi i një udhëzuesi zhvillimor për stafin akademik:
Rekomandohet përgatitja e një plani afatmesëm (3–5 vjeçar) që të përcaktojë drejtimet strategjike për zhvillimin profesional dhe didaktik të stafit akademik, me fokus në përvetësimin dhe përdorimin e metodave bashkëkohore dhe inovative të mësimdhënies.
 3. Përfshirja e strukturave të jashtme në sigurimin e cilësisë:
Krahas mekanizmave të brendshëm të kontrollit të cilësisë, rekomandohet përfshirja e strukturave apo ekspertëve të jashtëm për vlerësimin periodik të cilësisë së stafit akademik dhe të procesit mësimor, me synim rritjen e transparencës dhe përmirësimin e vazhdueshëm të standardeve akademike.
 4. Përmirësimi i raportimit mbi sigurimin e cilësisë:
Në raportin vjetor të Sigurimit të Cilësisë, rekomandohet të përfshihet një analizë më e thelluar dhe e detajuar për secilin program studimi, duke përfshirë tregues si: cilësia e mësimdhënies, përmbajtja e kurrikulës, pjesëmarrja e studentëve, kalueshmëria, nota mesatare, përfundimi në kohë i studimeve etj. Kjo do të ndihmojë në identifikimin e më saktë të problematikave dhe përcaktimin e masave përkatëse për përmirësim.
1. . Të merren masa për të rritur numrin e studentëve të regjistruar në program, me qëllim përmirësimin e dinamizmit të veprimtarive akademike dhe rritjen e eficiencës së përgjithshme të programit të studimit.

Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "Finance - Accounting" provided by the Higher Education Institution "Bedër" University College.

Strengths and affirmations

1. Sustainability of internal academic staff, who are continuously engaged in the study program.
2. Sustainable collaborative relationships with external actors, which help to benefit students through professional practices, internships and trainings that support their professional formation.
3. Modern infrastructure and contemporary laboratory equipment, made available to the Bachelor's degree program in Finance-Accounting, which support the development of the learning process and students' skills in accordance with the needs of the labor market.
4. Continuous support of the teacher-student relationship, which helps improve the quality of teaching and student motivation.
5. Active involvement of students in student clubs, which encourages engagement and cooperation between them.
6. Positive institutional climate, which promotes and supports student participation in international mobility programs.
7. Encouraging student participation in academic activities, such as conferences and summer schools, in order to increase interest in scientific research.

8. Integrating technology into the teaching process, which increases interest and helps students adapt to contemporary technological developments.
9. The academic staff is in continuous professional progress, through efforts to obtain scientific titles and degrees, thus increasing the capacity and quality of the department.
10. The institution is continuously committed to quality assurance, through the involvement of internal and external stakeholders in this process.
11. The internal information system helps facilitate the learning process and creates interactivity between students and academic staff.
12. Cooperation with other departments of "Bedër" University has contributed to the successful implementation of the learning and research process.

Weaknesses


1. Lack of complete documentation for the final examination in the "Bachelor in Finance-Accounting" program, including the distribution of points, a guide to possible topics, and a sample or indicative test structure [Standard III.5 / Criterion 3].
2. The absence of a medium-term (3–5 year) guideline for the didactic development of academic staff and a focus on innovative teaching methods, as well as the lack of detailed evidence from surveys for each study program in the Annual Quality Assurance Report (2023–2024). [Standard VI.1 / Criterion 3]
3. The absence of documentation regarding the periodic audit report to assess the financial effectiveness of the institution. Additionally, the lack of information on internal reporting within the institution regarding the implementation of the approved budget of the previous year. [Standard IV.5 / Criteria 3 and 4]

Recommendation

1. Strengthening financial support for the study program:
"Bedër" University should set clear objectives in order to generate additional income through research projects, training and collaborations with external stakeholders. This income will help in the sustainability and further development of the program.
2. Drafting a development guide for academic staff:
It is recommended to prepare a medium-term plan (3–5 years) that defines strategic directions for the professional and didactic development of academic staff, with a focus on the acquisition and use of contemporary and innovative teaching methods.
3. Involvement of external structures in quality assurance:
In addition to internal quality control mechanisms, it is recommended to involve external structures or experts for periodic assessment of the quality of academic staff and the teaching process, with the aim of increasing transparency and continuous improvement of academic standards.
4. Improving reporting on quality assurance:
In the annual Quality Assurance report, it is recommended to include a more in-depth and detailed analysis for each study program, including indicators such as: quality of teaching, curriculum content, student participation, pass rate, average grade, timely completion of studies, etc. This will help in more accurately identifying problems and determining relevant measures for improvement.



5. Measures should be taken to increase the number of students enrolled in the program, with the aim of enhancing the dynamism of academic activities and improving the overall efficiency of the study program.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X